



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SPORTIT

KURRIKULA BËRTHAMË
PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

Tiranë, 2014



PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
HYRJE	4
KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT	6
2.1 Veçoritë e arsimit të mesëm të ulët	6
2.2 Struktura e kurrikulës bërthamë	6
2.3 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe për shkallë	11
FUSHAT E TË NXËNIT TË ARSIMIT TË MESËM TË ULËT	26
3.1 Fusha e të nxënit: “Gjuhët dhe komunikimi”	28
3.2 Fusha e të nxënit: Matematika	43
3.3 Fusha e të nxënit: Shkencat e natyrës.....	58
3.4 Fusha e të nxënit: Shoqëria dhe mjedisi.....	74
3.5 Fusha e të nxënit: Arte	91
3.6 Fusha e të nxënit: Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti	108
3.7 Fusha e të nxënit:Teknologji dhe TIK-u	120
PLANI MËSIMOR	133
4.1 Përshkrimi i planit mësimor	133
4.2 Menaxhimi dhe zbatimi i planit mësimor nga shkolla	136
4.3 Autonomia e shkollës	136
KURRIKULA ME ZGJEDHJE.....	137
5.1 Qëllimi.....	137
5.2 Përmbajtja.....	137
5.3 Realizimi i kurrikulësme zgjedhje.....	138
UDHËZIME METODOLOGJIKE	140
6.1 Hyrje.....	140
6.2 Lidhja e rezultateve të të nxënit të kompetencave kyçe me rezultatet e të nxënit të	



kompetencave për fushë	140
6.3 Mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca.....	141
6.4 Mësimdhënia dhe të nxënit me në qendër nxënësin.....	142
6.5 Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar	142
6.6 Zhvillimi i temave ndërkurrikulare	143
6.7 Zhvillimi i veprimtarive ndërkurrikulare	144
6.8 Zhvillimi i veprimtarive ekstrakurrikulare	145
UDHËZIME PËR VLERËSIMIN	146
8 Vlerësimi	146
8.1 Kuptimi për vlerësimin. Parimet themelore	146
8.2 Llojet e vlerësimit.....	147
FJALORTH I TERMINOLOGJISË KURRIKULARE.....	150
REFERENCA	157



HYRJE

Dokumenti i kurrikulës bërthamë është dokumenti bazë i cili rregullon ecurinë e procesit mësimor bazuar në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë. Brenda tij përshkruhen rezultatet e nxënit për çdo kompetencë kyçe dhe fushë të nxëni sipas shkallëve të kurrikulës, metodologjitë e zbatimit të kurrikulës, vlerësimi i nxënësve, shpërndarja kohore (plani mësimor) për secilën fushë.

Dokumenti i kurrikulës bërthamë u paraprin dhe ndihmon në hartimin e dokumentave të tjerë të paketës kurrikulare si: programet lëndore, udhëzuesit kurrikularë etj, të cilët janë në themel të procesit mësimor të të nxënit dhe mësimdhënies.

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit, në mënyrë që ata të përballojnë sfidat e jetës dhe të punës dhe integrohen në shoqërinë e së ardhmes.
- **Mësuesit** për planifikimin dhe realizimin e veprimtarive mësimore në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen me kriteret e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme të arritjeve të fëmijëve.

Kurrikulat bërthamë hartohen për të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar:

- Kurrikula bërthamë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme (3– 6 vjeç);
- Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor;
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët;
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë.

Secila kurrikulë bërthamë zbaton dhe respekton qëllimet e përgjithshme të arsimit si dhe parimet themelore të përcaktuara në kornizën kurrikulare.

Kurrikulat bërthamë të tre niveleve kanë të përbashkëta:

- Kompetencat kyçe
- Fushat e të nxënit



Kompetencat kyçe në kurrikulat bërthamë janë:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
2. Kompetenca e të menduarit
3. Kompetenca e të mësuarit
4. Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis
5. Kompetenca personale
6. Kompetenca qytetare
7. Kompetenca digjitale

Fushate të nxënimit në kurrikulat bërthamë janë:

1. Gjuhët dhe komunikimi
2. Matematika
3. Shkencat e natyrës
4. Shoqëria dhe mjedisi
5. Artet
6. Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti
7. Teknologjia dhe TIK-u

Rezultatete të nxënimit për shkallë dhe rezultatet e të nxënimit për fusha, i bëjnë të dallueshme kompetencat dhe fushat e të nxënimit të secilit nivel formal të arsimit dhe secilës shkallë kurrikulare.



KURRIKULA BËRTHAMË PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

(Shkalla 3 – 4, Klasa VI – IX)

2.1 Veçoritë e arsimit të mesëm të ulët

Arsimi i mesëm i ulët u afron nxënësve sfida të reja për zhvillimin e tyre intelektual, shoqëror, etik, fizik, shpirtëror etj. Kërshëria e natyrshme e nxënësve nxitet më tej, për të siguruar njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera të qëndrueshme, si bazë për nivelet më të larta të arsimit.

Në këtë nivel, bazuar në arritjet e siguruar në nivelin paraprak arsimor, nxënësit ndihmohen të përforcojnë hap pas hapi arritjet e tyre për të lexuar dhe shkruar, duke bërë funksionale dhe të qëndrueshme aspekte të ndryshme të informacionit, kulturës, shkencës dhe teknologjisë. Kjo, në thelb, nënkupton të nxënit për t'iu qasur informacionit në mënyrë efektive dhe efektive, për ta vlerësuar atë në mënyrë kritike e me kompetencë dhe për ta shfrytëzuar në mënyrë të saktë dhe krijuese.

Në këtë nivel i kushtohet rëndësi aftësimin të nxënësve për të deshifruar, për të interpretuar dhe për të zbuluar llojet dhe modelet e dijes, si dhe për të shfrytëzuar imagjinatën pamore për komunikimin e ideve. Po kështu, nxënësi i këtij niveli aftësohet për të shfrytëzuar me efikasitet kohën dhe për të komunikuar idetë, për të gjetur dhe shfrytëzuar burimet e shumta të informacionit gjatë procesit mësimor (bibliotekat elektronike, mediet, motorët e kërkimit etj.), për sistemimin dhe ruajtjen e materialeve dhe të detyrave mësimore në formën elektronike, për llogaritje të shpejta dhe të sakta etj.

Në këtë nivel, kurrikula pasurohet me përvoja të larmishme të të nxënit (p.sh. kombinimi i qasjeve teorike me praktikën; të menduarit abstrakt dhe veprimet e kontekstualizuara, kontakti me realitetin konkret dhe virtual etj.), që ata të identifikojnë atë që u pëlqen dhe fushat e interesit.

2.2 Struktura e kurrikulës bërthamë

Në dokumentin e kurrikulës bërthamë të arsimit të mesëm të ulët paraqiten rezultatet e të



nxënit për kompetencat kyçe dhe për fushat e të nxënit sipas shkallëve, për këtë nivel, të cilat janë të detyrueshme për të gjitha shkollat e Republikës së Shqipërisë (publike dhe private).

2.2.1 Kompetencat kyçe

Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit.

Zhvillimet e sipërpërmendura dhe nevojat për ndryshime arsimore, e bëjnë të qartë domosdoshmërinë për të nxënë gjatë gjithë jetës. Qytetarëve të shoqërisë së dijes u nevojitet të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet vetjake, shoqërore dhe ato që lidhen me botën e punës dhe tregun e lirë. Procesi i arsimit do t'i mundësojë çdo nxënësi zotërimin e kompetencave kyçe, të nevojshme për jetëndhe punën. Rrugët dhe mënyrat, me të cilat njerëzit i qasen sot informacionit dhe shërbimeve, ndryshojnë vazhdimisht. Për këtë arsye, të gjitha moshat kanë nevojë të pajisen me kompetenca të reja, që i ndihmojnë të përshtaten në botën e sotme digjitale, jo vetëm nëpërmjet fitimit të njohurive dhe aftësive teknike, por edhe nëpërmjet të kuptuarit të thellë të mundësive, sfidave dhe çështjeve etike, ligjore dhe shoqërore, që lindin ose shoqërojnë zhvillimet e reja ekonomike, shoqërore dhe teknologjike. Këto ndryshime shtrojnë domosdoshmërinë e zotërimit të kompetencave, që i aftësojnë individët të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja.

Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.
2. Kompetenca e të menduarit.
3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.
4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.
5. Kompetenca personale.
6. Kompetenca qytetare.
7. Kompetenca digjitale.

Kompetencat komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të menduarit dhe kompetenca për të mësuar kanë natyrë instrumentale. Ato janë bazë për kompetenca të tjera, që janë më tepër të lidhura me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën personale, publike dhe profesionale.



Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

Me qëllim që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillojnë personalitetin, të nxënë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë mesazhet që u drejtohen dhe të shprehën në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për t'u bërë komunikues efektivë, nxënësit ndihmohen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

Marrja dhe përpunimi i njohurive në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, por edhe për të marrë vendime dhe për të zgjidhur probleme. Duke mbajtur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë thelbësore për shekullin XXI. Nxënësit kanë nevojë jo vetëm të marrin informacion, por edhe të zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

Në zhvillimet bashkëkohore në shoqëri, në shkencë, në teknologji e në ekonomi nuk mund të kërkohet që të gjitha njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme të arrihen nëpërmjet shkollimit. Prandaj, shkolla u krijon nxënësve të gjitha kushtet dhe mundësitë për t'u arsimuar dhe përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Shkolla i ndihmon fëmijët dhe të rinjtë të kultivojnë kureshtjen dhe interesin për dije dhe të zhvillojnë kompetencën për të nxënë. Në funksion të kësaj kompetence, shkolla duhet të ndërjegjësohet për rëndësinë e stileve dhe strategjive efektive të të nxënit.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

Shkollat përgatitin nxënësit për të jetuar, për të punuar në një botë të ndërlikuar dhe për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI, kërkon kompetenca për t'u përballur me rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitete për të shfrytëzuar mundësitë, që ofrohen për zhvillimin vetjak, përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisit.



Për të zhvilluar këtë kompetencë, shkolla iu krijon nxënësve kushte që të kuptojnë tërësisht ndërvarësinë ndërmjet dukurive ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë vendore dhe globale. Ajo mundëson që nxënësit të orientohen drejt së ardhmes, të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat. Njëkohësisht, shkolla i ballafaqon nxënësit me problemet ekologjike, për t'i ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit.

Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)

Për të zhvilluar kompetencën personale, shkollat përgatisin nxënësit të përfshihen në mënyrë efektive në jetën familjare, shoqërore dhe në punë. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen të ndërgjegjësohen për veten dhe të kenë vetëbesim, si dhe të jenë të hapur dhe të kenë besim tek të tjerët.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)

Të mësuarit për të jetuar së bashku trajtohet si sfida kryesore e botës së sotme dhe së nesërme. Qytetaria shtetërore sot plotësohet me aspektin shumë të rëndësishëm të “qytetarisë globale”. Kjo kompetencë siguron që nxënësit të jenë në gjendje të veprojnë si qytetarë të përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë.

Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)

Kompetenca digjitale nënkupton përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në punë, gjatë kohës së lirë dhe gjatë komunikimit. Ajo mbështetet në shkathtësitë themelore të përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet.

2.2.2 Shkallët e kurrikulës dhe përshkrimi i tyre

Kurrikula e Arsimit Parauniversitar e Republikës së Shqipërisë është e organizuar në gjashtë shkallë. Koncepti i shkallëve të kurrikulës bazohet në veçoritë përbashkëta që kanë të bëjnë me karakteristikat e zhvillimit moshor të nxënësve.

Strukturimi dhe organizimi i kurrikulës sipas shkallëve të kurrikulës mundëson:



- respektimin e karakteristikave të periudhave të ndryshme të zhvillimit të fëmijëve për caktimin e qëllimeve specifike dhe të kompetencave që duhen zotëruar nga fëmijët;
- respektimin e ritmeve individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës;
- lidhjen e qartë të rezultateve të të nxënësve gjatë shkallëve të kurrikulës, si pikë referimi për planifikimin dhe organizimin e punës mësimore-edukative në nivel shkolle;
- fleksibilitet më të madh në planifikimin dhe organizimin e punës mësimore-edukative, nëpërmjet zgjerimit të ciklit të planifikimit të nxënies nga një vit shkollor në dy/tri vite shkollore (në varësi nga shkalla konkrete e kurrikulës);
- përgatitjen e udhëzimeve të qarta për organizimin e punës mësimore-edukative gjatë shkallëve të kurrikulës, në mënyrë të veçantë për metodat e punës dhe format e vlerësimit;
- forcimin e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies së shkollës dhe të njësive arsimore vendore për cilësinë e arsimit që afrohet nga shkolla.

Tabela: Shkallët 3 dhe 4 të kurrikulës.

Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (KSNA)	Nivelet e sistemit të arsimit formal	Shkallët e kurrikulës	Kurrikulat bërthamë
KSNA 2	Arsim i mesëm i ulët Klasat VIII – IX	<i>Shkalla 4 e kurrikulës</i> Përforcim i arritjeve dhe orientim në karrierë	<i>Kurrikula bërthamë për klasat VI-IX të arsimit të mesëm të ulët</i>
	Arsim i mesëm i ulët Klasat VI – VII	<i>Shkalla 3 e kurrikulës</i> Zhvillim i mëtejshëm i bazave dhe orientim	

Tabela: Përshkrimi i shkallëve të kurrikulës, për arsimin e mesëm të ulët.

Shkalla 3, klasa VI-VII <i>Zhvillim i mëtejshëm i bazave dhe orientim</i> Nxënësit i krijohen mundësitë për:	Shkalla 4, klasa VIII-IX <i>Përforcim i arritjeve dhe orientim në karrierë</i> Nxënësit i krijohen mundësitë për:
--	---



- zhvillimin e mendimit abstrakt dhe kompleks (p.sh. aftësitë e larta intelektuale) që është i nevojshëm për të njohur botën dhe veten, si dhe përzgjidhjen e problemeve;
- njohjen më të thellë të vetes, të të tjerëve dhe të mjedisit natyror e shoqëror;
- zhvillimin e aftësive për vetëvlerësim;
- zhvillimin e aftësive për komunikim efektiv, duke përfshirë dhe konceptet ose kategoritë matematikore dhe shkencore;
- zgjerimin e mundësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në gjuhën amtare, në gjuhën e huaj të parë dhe në gjuhën e huaj të dytë;
- zhvillimin e përgjegjshmërisë për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore dhe për mbrojtjen të mjedisit.
- përdorimin e burimeve të informacionit dhe qëndrimin kritik ndaj tij;
- zhvillimin e interesit për jetën publike nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë në veprimtari të ndryshme jashtëshkollore;
- përballjen me çështje të ndryshme nga jeta reale nëpërmjet projekteve që do të mundësojnë konsolidimin e njohurive të tyre dhe zhvillimin e mëtejshëm të aftësive, vlerave dhe qëndrimeve;
- familjarizimin me mundësitë e ndryshme të studimit dhe orientimit në karrierë;
- përgatitjen praktike dhe veprimtari të orientuese që u mundësojnë qartësimin e aspiratave të tyre;
- përforcimin e aftësive të vetëvlerësimit;
- përforcimin e kompetencave për punë të pavarur, individuale dhe në grup.

2.3 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe për shkallë

Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallë shprehin kërkesat themelore për zhvillimin e kompetencave kyçe në përfundim të një shkalle të caktuar të kurrikulës si dhe kushtin për kalim nga një shkallë në tjetrën. Rezultatet e të nxënit për shkallë nxisin integrim të mëtejshëm të fushave të kurrikulës në funksion të zhvillimit të kompetencave kyçe. Ato parashikohen që të përvetësohen nga të gjithë nxënësit.



Tabela e rezultateve të të nxënimit të kompetencave kyçe për shkallën 3

Nr.	Shkalla 3 Klasa VI-VII	Nivelet e kompetencës			
		1	2	3	4
I.	Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive</i>				
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit. 2. Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime. 3. Lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. Dhe e komentonatë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim. 4. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. 5. Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyre me shkrim. 6. Shkruan një tekst deri në 500 fjalë (letër, udhëzim, kërkesë, ese etj.), duke respektuar rregullat gjuhësore. 7. Shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare ose të huaj, për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 8. Përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevoja të veta apo si detyrë shkollore). 				
II.	Kompetenca e të menduarit <i>Nxënësi mendon në mënyrë krijuese</i>				



	<ol style="list-style-type: none"> 1. Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media. 2. Shpreh mendimin për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme. 3. Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrar, shkencor, artistik), duke përcaktuar hapat kryesore të zbatimit. 4. Zgjidh një problem (matematikor, gjuhësor, shoqëror, shkencor etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse. 5. Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematikor, gjuhësor, shkencor, artistik, shoqëror) duke paraqitur rezultat të njëjtë. 6. Interpretin mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë. 7. Krahason ngjashmëri të dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike. 8. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike. 				
III.	Kompetenca e të nxënësve <i>Nxënësi mëson për të nxënë</i>				
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. 2. Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, matematikë ose arte, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit. 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. 4. Shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar. 				



	<ol style="list-style-type: none"> 5. Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike. 6. Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave në fushatë ndryshmetë dijes. 7. Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur. 8. Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo gjetiu). 				
IV.	<p>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</p> <p><i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i></p>				



	<ol style="list-style-type: none">1. Përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.2. Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.3. Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh.pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën, etj) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.5. Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme grafike, ilustrime, disajne (të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve).6. Ndihmon në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve vullnetare apo humanitare në shkollë dhe në komunitet dhe shpreh përvojat dhe ndjenjat e vetme shkrim dhe forma të tjera të shprehurit.7. Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).8. Merr pjesë si anëtar i një jurie, (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi sportiv, shkencor, artistik, etj., duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.				
V.	Kompetenca personale <i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i>				
	<ol style="list-style-type: none">1. Prezanton para nxënësve procesin e përgatitjes së një ushqimi specialiteti shtëpiak sipas një recete për ushqim të shëndetshëm.2. Vlerëson përmbajtjen e vlerës ushqimore (ndikimin pozitiv dhe negativ në shëndet) për tri lloje ushqimesh të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose përreth.3. Diskuton në grup me argumente për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.4. Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktiviteteve				



	<p>fizike dhe sportive, duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës.</p> <p>5. Identifikon shenjat/simbolet e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete.</p> <p>6. Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.</p> <p>7. Kërkon ndihmë/këshillë nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të ndryshme të dyshuara/supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat çënohet shëndeti fizik dhe mendor.</p> <p>8. Shpjegon pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit gjatë një debati ose prezantimi (me gojë ose me shkrim).</p> <p>9. Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.</p> <p>10. Merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit, që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike, etj., dhe raporton (me gojë, me shkrim) për përvojat personale të fituara.</p> <p>11.</p>	
<p>VI.</p>	<p>Kompetenca qytetare</p> <p><i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i></p>	



1. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. Dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.
2. Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj, argumenton nevojën dhe përparësitë që sjell ndryshimi i tyre.
3. Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
4. Mirëkupton dhe mbështet personat, të cilëve u është shkelur ndonjë e drejtë, duke evidentuar shkeljen nëpërmjet ilustrimeve me shembuj nga jeta e përditshme, nga mediet, të dhënat historike, romanet, që ka lexuar, apo nga filmat, që ka parë, në mënyrë që të mos përsëriten më.
5. Shpjegon (në forma të ndryshme të të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit dhez batimit të rregullave dhe ligjeve për raporte të shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interesit.
6. Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
7. Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe jashtë saj dhe propozon masa konkrete për parandalimin e tyre.
8. Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

VII.

Kompetenca digjitale

Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin



<ol style="list-style-type: none"> 1. Përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive. 2. Përdor imazhet për të modifikuar ose krijuar vepra të artit për një prezantim digjital. 3. Shpjegon avantazhet dhe disavantazhet në përdorimin e teknologjive të ndryshme për të afruar informacionin për dëgjues të synuar. (p.sh: krahasojnë komunikimin përmes videove dhe mjeteve të komunikimit masiv; e-mail, CD-messenger). 4. Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacionetë marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelëose grafik). 5. Përcakton mjetet e duhura teknologjike për qasjen në informacione dhe burime elektronike. 6. Zhvillon aftësinë mediatike për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre (p.sh.,dallon nëse një material i marrë nga interneti është fakt dhe burimi është primar ose sekondar). 7. Ndërton sisteme të teknologjisë së informacionit nëpërmjet mbledhjes, përpunimit dhe daljes së informacionit, si dhe të feedback-ut të marrë nga mësuesit ose nxënësit e tjerë. 8. Debaton mbi ndikimin, avantazhet dhe dizavantazhet e teknologjive ekzistuese dhe të reja në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit. 				
---	--	--	--	--

Tabela e rezultateve të të nxënit të kompetencave kyçe për shkallën 4

Nr.	Shkalla 4 Klasa VIII-IX	Nivelet e kompetencës			
		1	2	3	4
I.	Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit <i>Nxënësi komunikon në mënyrë efektive</i>				



	<ol style="list-style-type: none"> 1. Merr pjesë në bashkëbisedime me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor dhe shoqëror duke bërë pyetje, dhënë përgjigje dhe veçuar informacionin kryesor. 2. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. 3. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshetuar forma të komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik. 4. Përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj. 5. Harton një tekst, deri në pesëqind fjalë (bazuar në imagjinatën e vet), duke vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar më parë. 6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun e përshtatshëm. 7. Diskuton për një temë të caktuar në gjuhën amtare, në gjuhën angleze ose në gjuhën e dytë të huaj, në lëndë të ndryshme, duke respektuar rregullat e komunikimit. 8. Identifikon burime të ndryshme informacioni për arsimim dhe orientim profesional, si dhe zhvillon një plan individual për zhvillimin e karrierës së tij. 				
<p>II.</p>	<p>Kompetenca e të menduarit</p> <p><i>Nxënësi mendon në mënyrë krijuese</i></p>				
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Paraqet në forma të ndryshme (me gojë, të shkruar, grafike, me simbole) argumente për të përforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara. 2. Përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre. 3. Analizon një punim (p.sh. artikull gazete, pikturë etj) duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm. 4. Përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar qëllimin, aktivitetet kryesore, afatet, 				



	<p>vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre dhe parashikon pengesat e mundshme gjatë realizimit.</p> <p>5. Argumenton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët çojnë në përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi, të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu.</p> <p>6. Demonstron zgjidhjen e një problemi (të matematikës, gjuhësor etj.) bazuar në të dhënat tekstuale, numerike, eksperimentale të detyrës, e cila realizohet në klasë/shkollë apo jashtë saj, argumenton ecurinë për arritjen e rezultatit.</p> <p>7. Interpreton një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situatat të jetës së përditshme me shkrim/me gojë.</p> <p>8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive.</p>	
<p>III.</p>	<p>Kompetenca e të nxënit</p> <p><i>Nxënësi mëson për të nxënë</i></p>	



	<ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/faktet për një temë; veçon me anë të teknikave të ndryshme pjesët sipas rëndësisë dhe nevojës për temën/detyrën e dhënë. 2. Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje/projektme bazë klase/shkolle ose jashtë saj. 3. Regjistron, skedon dhe përdor teknika të tjera për të m e n a x h u a r informacionin/faktet ose formulat për një temëduke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë. 4. Parashtron pyetje për çështje të ndryshme dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke e videntuar përparimin/vështirësitë deri në zgjidhjen përfundimtare. 5. Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e argumentuar para të tjerëve. 6. Prezanton në mënyrë të pavarur udhëzimet/simbolet e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografietj, për të përmbushur një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj. 7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxëniet të temës së dhënë duke klasifikuar informacionin e njohur nga ai i panjohur si dhe atë që është i paqartë. 8. Përdor elementët e portofolit personal për vetëvlerësimin dhe identifikimin e anëve të forta, i shfrytëzon ato për përparimin në mësimet dhe për orientimin për karrierë. 				
<p>IV.</p>	<p>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</p> <p><i>Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive</i></p>				
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme. 2. Ndërmerr aktivitete të ndryshme për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore për shkollën ose për komunitet (ekspozitë, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit të hartuar me anëtarë te grupit. 3. Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut 				



	<p>dhe biodiversitetit duke i paraqitur idetë në formë të shkruar ose në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, jep mendimin dhe qëndrimin e vet përkëtë çështje si dhe organizon aktivitete për mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>4. Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/dhe publikimeve të ndryshme të shkollës.</p> <p>5. Zhvillon një plan për shpenzimet dhe kursimet mujore personale, të familjes ose të klasës dhe argumenton rëndësinë e planifikimit të buxhetit.</p> <p>6. Përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientim në karrierë.</p> <p>7. Propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportiv, shkencor, teknologjik, artistik, etj., (si anëtar jurie të ngritur në nivel klase, shkolle apo shoqërie civile).</p> <p>8. Hulumton nevojat e shkollës ose të komunitetit dhe në bazë të të dhënave organizon aksione vullnetare apo humanitare për plotësimin ose përmirësimin e nevojave.</p>	
<p>V.</p>	<p>Kompetenca personale</p> <p><i>Nxënësi bën jetë të shëndetshme</i></p>	



	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerëson vlerën ushqyese të ushqimeve të cilat konsumon, duke i klasifikuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme (gjatë stinëve, sëmundjeve etj.). 2. Argumenton nevojën e respektimit të regjimit ushqimor të shëndetshëm dhe rekreacionin ditor, javor apo mujor sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjura nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, shkollë apo në familje. 3. Vlerëson domosdoshmërinë e kushteve higjienike për përgatitjen dhe konsumimin e ushqimeve dhe pijeve, shpjegon rrethanat e mundshme të helmimit nga papastërtia. 4. Zhvillon aktivitete fizike dhe sportive me karakter krijues apo garues duke u përpjekur në arritjen e rezultateve të caktuara, me angazhim dhe sjellje të pëlqyera, si dhe duke menaxhuar emocionet gjatë manifestimit të rezultateve. 5. Analizon shkaqet e një reagimi konfliktual apo emocional dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit. 6. Dallon sjelljen korrekte nga ajo jo korrekte gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/tejkalimin e tyre. 7. Shpjegon rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetentë të nevojshëm për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor. 8. Përshkruan mundësitë, rreziqet, pasojat e infeksioneve, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme duke sqaruar mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre nëpërmjet formave të ndryshme të prezantimit (të folur, të shkruar, grafike, pllakate, pamflete, apo lojë teatrale, performancë artistike etj). 9. Reagon ndaj sjelljeve negative duke identifikuar shkaqet e paraqitjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit (p.sh. përdorimi i duhanit, alkoolit apo drogës) etj. 				
<p>VI.</p>	<p>Kompetenca qytetare</p> <p><i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët</i></p>				
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Praktikton të drejtat dhe detyrimet si qytetar në situata konkrete të jetës së përditshme, në klasë, shkollë, komunitet ose gjatë diskutimit dhe respektimit të mendimit të tjetrit. 				



2. Reagon ndaj personave të cilët shkelin, çënojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve duke i ilustruar këto sjellje me shembuj të figurave të shquara historike, personazheve nga letërsia a filmat si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin.
3. Solidarizohet me personat në nevojë ose të rrezikuar, duke ndërmarrë veprime konkrete për afrimin e ndihmës sipas nevojës që kanë.
4. Merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e një votimi të zhvilluar në klasë ose shkollë për një aktivitet të caktuar duke zbatuar rregullat përkatëse dhe raporton me shkrim për rrjedhën e gjithë procesit.
5. Reagon me pjekuri, maturi e qetësi ndaj sjelljeve/veprimeve jo korrekte që ndodhin në klasë/shkollë apo jashtë saj dhe promovon sjelljet dhe veprimet korrekte duke vënë në dukje shkaqet dhe pasojat e manifestimit të tyre për individin dhe për të tjerët.
6. Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, shkollë apo në komunitet, mban qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete parandalimi.
7. Përgatit në grup një aktivitet, duke përdorur tolerancën si mjet për promovimin e diversitetit kulturor, etnik, gjinor, fetar, social etj., në shkollë apo në komunitet.
8. Përshkruan procedurat dhe institucionet përgjegjëse për hartimin dhe ndryshimin e ligjeve duke argumentuar domosdoshmërinë e zbatimit të tyre në jetën e përditshme me anë të formave të ndryshme të të shprehurit.
9. Prezanton të kaluarën e familjes, të rrethit shoqëror ose të personaliteteve dhe ngjarjeve kryesore të kombit të vet, duke krahasuar të tashmen me të kaluarën për të nxjerrë përfundime për të ardhmen.

VII.

Kompetenca digjitale

Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin



1. Përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënit dhe për të rritur efektivitetin në mësimnxënie.
2. Përdor mjetet multimediale për të bashkëpunuar me persona të tjerë dhe për të rritur produktivitetin e tij dhe të nxënit efektiv.
3. Bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur mjetet e telekomunikacionit bashkëpunues, për të hetuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj.
4. Krijon animacione origjinale ose dokumentarë, duke u bazuar tek ngjarjet e komunitetit, lokalitetit dhe mjedisit shkollor.
5. Përdor me saktësi komandat e avancuara të programeve standarde për përpunimin e teksteve, tabelave, videove e fotografive për prezantime.
6. Përdor aftësitë e të menduarit kritik për të planifikuar, hulumtuar e menaxhuar projekte, për të zhvilluar strategji, për të zgjidhur problemet dhe , arrin vendimmarrje, në bazë të informacionit të fituar duke përdorur mjetet dhe burimet e duhura digjitale.



FUSHAT E TË NXËNIT TË ARSIMIT TË MESËM TË ULËT

Fushat e të nxënit përbëjnë bazën e organizimit të procesit mësimor-edukativ në shkollë, për çdo nivel arsimor dhe shkallët përkatëse të kurrikulës. Kurrikula e arsimit tonë parauniversitar është e organizuar në shtatë fusha të nxëni. Fushat e të nxënit përfshijnë një ose më shumë lëndë apo module. Lëndët dhe modulet bazohen në rezultatet e të nxënit të përcaktuara për çdo fushë. Disa lëndë të fushës mund të jenë pjesë e disa shkallëve kurrikulare.

Fushat e të nxënit janë:

1. Gjuhët dhe komunikimi
2. Matematika
3. Shkencat e natyrës
4. Shoqëria dhe mjedisi
5. Artet
6. Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti
7. Teknologjia dhe TIK-u

Për secilën fushë përcaktohen rezultatet e të nxënit të cilat mundësojnë zhvillimin e kompetencave kyçe.

Rezultatet e të nxënit sipas fushave sigurojnë:

- Zhvillimin e kompetencave përmes një tërësie të përbashkët përvojash mësimore të ndërlidhura.
- Lidhjen ndërmjet lëndëve dhe veprimtarive mësimore që realizohen në kuadër të një fushe të nxëni, me synim integrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që mundësojnë këto lëndë.
- Zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies në nivel shkolle.



Secila nga fushat e të nxënit, nga pikëpamja e organizimit të materialit, paraqitet sipas formatit të mëposhtëm:

1. Hyrje
2. Qëllimi i fushës
3. Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre
4. Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha
5. Rezultatet e të nxënit
6. Shpërndarja e kohës mësimore
7. Udhëzime metodologjike
8. Udhëzime për vlerësimin
9. Materialet dhe burimet mësimore



3.1 Fusha e të nxënit: “Gjuhët dhe komunikimi”

3.1.1 Hyrje

Zhvillimi gjuhësor dhe letrar është themelor për zhvillimin intelektual, shoqëror dhe emocional të nxënësve ndaj duhet konsideruar edhe si elementi kryesor i gjithë kurrikulës së arsimit bazë. Nëpërmjet studimit të tekstit letrar, kjo fushë ndikon edhe në formimin estetik të nxënësve. Njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, që zotëron nxënësi në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”, janë bazë për arritjet e nxënësve edhe në fusha të tjera të të nxënit dhe më pas në jetë.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” u mundëson nxënësve të zhvillojnë dhe të përdorin gjuhët si mjete komunikimi në jetën e përditshme, si dhe në veprimtaritë e tyre profesionale e shoqërore.

Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj e parë, gjuhë e huaj e dytë.

Gjuha shqipe mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, nga klasa përgatitore deri në klasën XII.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII). Si gjuhë e huaj e dytë mund të jetë: gjuha frënge, gjuha italiane, gjuha gjermane etj. Ajo përfshihet në kurrikulën me zgjedhje të detyruar dhe zhvillohet me 4 orë në secilën shkallë.

Kurrikula bërthamë e fushës “Gjuhët dhe komunikimi” përmban qëllimin, tematikat kryesore dhe përshkrimin e tyre, kompetencat e fushës dhe përshkrimin e tyre, rezultatet e të nxënit, udhëzimet metodologjike të mësimdhënies, si dhe kriteret e vlerësimit për shkallët kurrikulare. Kurrikula, gjithashtu, paraqet një pasqyrë të qartë të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave që nxënësit duhet t'i zhvillojnë, përvetësojnë dhe arrijnë nëpër shkallë dhe nivele.

Kurrikula bërthamë është strukturuar sipas parimeve të përcaktuara në kornizën kurrikulare (shkallët dhe nivelet kryesore). Aty paraqitet ajo që nxënësit duhet të përvetësojnë nga lëndët e përfshira në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.



3.1.2 Qëllimet e fushës

Qëllimet e fushës “Gjuhët dhe komunikimi” janë:

- Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit;
- Dallimi i llojeve të ndryshme të teksteve letrare dhe jo letrare;
- kuptimi, analiza dhe vlerësimi i teksteve letrare dhe joletrare;
- vlerësimi i letërsisë kombëtare e botërore, nëpërmjet studimit të veprave të shkrimtarëve, përfaqësues të periudhave të ndryshme të letërsisë shqiptare dhe botërore;
- formimi estetik i nxënësve;
- respektimi i vlerave kombëtare dhe i diversitetit gjuhësor;
- zhvillimi i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve rrethsishtimit gjuhësor: sintaksë, morfologji, fonetikë, drejtshkrim, leksikologji dhe semantikë;
- zhvillimi i shkathtësi vetë të shprehurit nëpërmjet mjeteve të ndryshme dëgjimore dhe pamore.

3.1.1 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

Kompetencat e fushës “Gjuhët dhe komunikimi” janë si më poshtë:

1. Të dëgjuarit

Nxënësit demonstronjë sjellje dhe qëndrime të përshtatshme gjatë të dëgjuarit si: vëmendje, kontakt me sy, pëlqim, nxitje dhe interes. Ata dëgjojnë dhe kuptojnë një larmi tekstesh, si dhe shprehin opinionet dhe vlerësimin e tyre rreth këtyre teksteve.

2. Të folurit

Nxënësit shqiptojnë saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jenë të kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; përdorin gjatë të folurit edhe elemente të komunikimit joverbal; diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.

3. Të lexuarit

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore dhe demonstronjë kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve.

4. Të shkruarit



Nxënësit shkruajnë për qëllime dhe dëgjues të ndryshëm. Ata ndjekin gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësit, gjithashtu, respektojnë strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.

5. Përdorimi i drejtë i gjuhës

Që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, atëherë ata duhet të zotërojnë njohuri, të demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja. Kështu, nxënësit njohin pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; njohin llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe respektojnë diversitetin gjuhësor; kanë njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre. Gjithashtu, nxënësit ndërjegjësohen për pasurinë dhe vlerat shprehëse që ka gjuha.

3.1.2 Rezultatet e të nxënit

Rezultatete të nxënit janë hartuar mbi bazë ne kompetencave të fushës dhe përmbajnë kërkesat që nxënësi duhet t'i arrijë pas përfundimit të çdo shkalle.

Organizimi i rezultateve të të nxënit përmban njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat të cilat zhvillohen dhe thellohen gradualisht nëpër shkallë, duke pasur parasysh zhvillimin fizik dhe psikomotor të nxënësve. Këto rezultate mundësojnë arritjen e shtatë kompetencave të përcaktuara në kornizën kurrikulare.

Më poshtë janë dhënë rezultatet e të nxënit të gjuhës shqipe dhe gjuhës së huajpër shkallën e tretë dhe të katërt, si dhe njohuritë, shkathtësi të, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për arritjen e këtyre rezultateve.

Lënda: Gjuhë shqipe

KSNA 2	
Shkalla e tretë Klasa VI - VII	Shkalla e katërt Klasa VIII- IX
Rezultatet e të nxënit në fund të klasës së shtatë	Rezultatet e të nxënit në fund të klasës së nëntë



Të dëgjuarit

Nxënësi:

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">- krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to;- jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon. | <ul style="list-style-type: none">- interpreton tekstin dhe nëntekstin, si edhe gjykon për qëllimin, ndjenjat e folësit, vërtetësinë dhe besueshmërinë e tekstit;- diskuton, zgjeron dhe gjykon idetë e dëgjuara, si edhe merr pjesë në veprimtari praktike, ku dëgjon për tema të fushave të ndryshme. |
|---|--|

Të folurit

Nxënësi:

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none">- zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij;- merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve;- identifikon materiale të ndryshme dhe i përdor për të dhënë mesazhe ose porosi nëpërmjet reklamave e lajmërimeve dhe bën prezantimin e tyre në media. | <ul style="list-style-type: none">- flet qartë dhe kuptueshëm për tema të ndryshme në situata formale dhe joformale;- përfshihet në diskutime, parafrazon e përmbledh komentet e prezantuara me gojë, duke marrë parasysh edhe elementet e gjuhës së gjesteve në një prezantim;- krijon tekste mediatike për qëllime dhe audienca të ndryshme duke përdorur format dhe teknikat e përshtatshme. |
|--|---|

Të lexuarit

Nxënësi:

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">- interpreton tekstet duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst dhe idetë e nënkuptuara;- dallon informacionin e rëndësishëm në tekst;- lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato; <p>a) Tekste letrare</p> | <ul style="list-style-type: none">- kupton tekstin edhe kur mendimet dhe idetë nuk jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shpjegon se si gjuha dhe stili ndikojnë për t'i dhënë idetë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar;- analizon dhe diskuton për interpretimet e të tjerëve rreth tekstit. <p>a) Tekste letrare</p> |
|---|--|



- analizon në tekste të ndryshme poetike, tregimtare dhe dramatike gjuhën e figurshme;
- dallon temën dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik;
- dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre;
- shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.

a) Tekste joletrare

- dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme;
- kupton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme (paragrafë, tituj, nëntituj, etj.).

- vlerëson gjuhën dhe idetë që përcjell autori në tekst, analizon sjelljen dhe qëndrimet e personazheve, zhvillimin e fabulës ose subjektit;
- bën dallimin mes personazhit, autorit dhe tregimtarit;
- krahason stilin, gjuhën dhe tematikën në tekste të ndryshme;

b) Tekste joletrare

- përzgjedh, krahason dhe përmbledh informacionin nga tekste të ndryshme;
- dallon informacionin e rëndësishëm nga i parëndësishmi, faktin nga opinioni, shkakun nga pasoja;
- veçon tiparet karakteristike në nivelin e fjalëve, fjalive dhe tekstit në tekste të ndryshme.

Tëshkruarit

Nxënësi:

- përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara;
- mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.

- ndjek dhe realizon hapat e domosdoshëm në procesin e të shkruarit;
- përdor formatë efektshme të tëshkruarit për qëllime dhe audiencë të caktuara;
- paraqet në mënyrë të strukturuar informacionin, idenë dhe mendimet e tij duke zbatuar rregullat drejtshkrimore.

Përdorimi i drejtë gjuhës

Nxënësi:



- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none">- dallon dhe përdor fjalitë e thjeshta dhe të përbëra si dhe përcakton llojin e tyre;- dallon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali;- përcakton klasat e fjalëve dhe kategoritë e tyre gramatikore;- dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;- dallon fushën leksikore, familjen e fjalëve, si dhe kuptimin e parë dhe kuptimet e tjera të tyre;- përdor mirë gjuhën standarde shqipe. | <ul style="list-style-type: none">- dallon, përdor dhe analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit, gjymtyrëve kryesore;- përdor dhe analizon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta;- përdor dhe analizon klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;- analizon stilet dhe regjistrat e gjuhës;- vlerëson pasurinë leksikore të shqipes, përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit. |
|--|---|

Njohuritë dhe konceptet

- Komunikim verbal dhe joverbal (gjeste, mimikë, gjuhë e trupit).
- Rregullat e të folurit, të dëgjuarit dhe diskutimit në grup.
- Strategjitë e të lexuarit dhe hapat në procesin e shkrimit.
- Struktura e organizimit dhe karakteristikat e teksteve.
- Fakti, opinioni, citime, referenca, shënimet në fund të faqes, bibliografi.
- Tekste joletrare si: autobiografi, biografi, intervista, udhëpërshkrime, kronika, reportazhe, enciklopedi, rregullore, artikull gazete ose reviste, e-mail, përmbledhje, ese, CV, fletëpalosje.
- Lloje të ndryshme rimash, vargjesh, strofash.
- Tiparet dhe llojet kryesore të teksteve poetike, tregimtare dhe dramatike.
- Metaforë, krahasim, hiperbolë, simbol, antitezë, personifikim, alegori, aliteracion, ironi, sarkazëm, personifikim.
- Njohuri të përgjithshme rreth folklorit, letërsisë shqipe dhe botërore.
- Llojet e fjalive, skemat e fjalive të përbëra.
- Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta, llojet e tyre.
- Klasat e fjalëve, të ndryshueshme të pandryshueshme, kategoritë gramatikore.
- Mënyrat dhe llojet e fjalëformimit.
- Leksiku, gjuha standarde, familja e fjalëve, fusha leksikore.



- Stilet dhe regjistrat e gjuhës.
- Shenjat e pikësimit dhe rregullat e drejtshkrimit.

Aftësitë dhe shkathtësitë

- Mendimkrijues
- Mendimi kritik
- Zgjidhja e problemeve
- Përpunimi i informacionit
- Interpretimi
- Krahasimi
- Vlerësimi
- Prezantimi
- Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Qëndrimet dhe vlerat

- Korrektësi në komunikim.
- Vëmendje dhe përqendrim gjatë të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.
- Pjesëmarrje në diskutime duke respektuar dhe pranuar mendimin ndryshe.
- Empati gjatë komunikimit.
- Bashkëpunim në grup.
- Motivimpërtë lexuar për kënaqësi dhe informacion.
- Respektim i etikës gjatë komunikimit personal dhe në grup.
- Vlerësim i kontributit të të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre.
- Vetëbesim dhe vetëvlerësim gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme.
- Vullnet gjatë kryerjes së detyrave .
- Tolerancë dhe respekt për kulturën dhe gjuhën e tjetrit.
- Imagjinatë dhe mendim krijues për zgjidhjen e problemeve.
- Vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grup.
- Pavarësinë vendimarrje dhe veprime.
- Kureshtje për hulumtim dhe kërkim.
- Kujdes për veten, të tjerët dhe ambientin.



Lënda: Gjuhë e huaj

Rezultatet e të nxënit për shkallën 3 dhe 4	
Shkalla e tretë	Shkalla e katërt
Klasa VI– VII	Klasa VIII - IX
Rezultatet e të nxënit në fund të klasës së shtatë	Rezultatet e të nxënit në fund të klasës së nëntë
Të dëgjuarit	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - Tregon se kupton pikat kryesore dhe mendime të shprehura në pasazhe të përbëra nga materiale të njohura nga kontekste të ndryshme, duke përfshirë ngjarje të ditës apo të ardhshme. Ata mund të kenë nevojë për disa përsëritje. 	<ul style="list-style-type: none"> - Tregon se kupton pasazhe të gjata. - Dallon çështjet kryesore në një pasazh që përmban disa fjali komplekse dhe gjuhë të panjohur; - Kupton gjuhën e folur me shpejtësi pothuajse normale, por me ndonjëpërsëritje.
Të folurit	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - Tregon aftësi për t'i përdorur njohuritë e tij gjuhësore, që të zëvendësojë dhe përshtasë fjalë e fraza në bashkëbisedim me një gramatikë, përgjithësisht të saktë. - Fillon dhe zhvillon një bisedë. - Diskuton çështjet e interesit personal apo të ditës. - Improvizon dhe perifrazon; - Shqipton drejt fjalë e fjalime gjuhë zakonisht është e saktë. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kërkon dhe jep informacion dhe mendime në një bashkëbisedim. - Tregon aftësi për të përshtatur gjuhën në situata të improvizuara. - Justifikon dhe kërkon mendime personale dhe ide në situata informale dhe formale. - Merret me besim me elemente të paparashikueshme në biseda, ose me njerëz që janë të panjohur. - Flet rrjedhshëm, me shqiptim të saktë. - Jep mesazhe të qarta edhe me disa gabime.



Të lexuarit

Nxënësi:

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Shpreh kuptimin e një shumëllojshmërie tekstesh të tipave të ndryshëm, që ngërthejnë fjali komplekse dhe një fjalor të panjohur. - Ai është në gjendje të konsultojë lloje të ndryshme materialesh të njohura referuese. | <ul style="list-style-type: none"> - Tregon aftësi për të rrokur shpejt thelbin e një pasazhi. - Tregon se kupton tekste më të gjatë, që mbulojnë një gamë të gjerë materiali të përfytyruar dhe faktik, me fjali komplekse dhe gjuhë të panjohur. - Përdor një gjuhë komplekse. - Përdor fjalorin dhe strukturat që gjenden në leximin e tyre për të dhënë përgjigje me gojë ose me shkrim. - Përdor materiale të tjera referuese kur këto janë të nevojshme. |
|---|---|

Të shkruarit

Nxënësi:

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Shkruan duke përmbushur kërkesat e njohura të lexuesve dhe qëllimet funksionale me një ortografi dhe gramatikë përgjithësisht të saktë; - Shkruan tekste të shkurtra për një sërë temash të njohura duke shprehur mendime të thjeshta. - U referohet përvojave të kohëve të fundit apo të planeve për të ardhmen, si dhe aktiviteteve të përditshme. Edhe pse mund të ketë disa gabime, kuptohet me pak ose aspak vështirësi. Përdor fjalorë për të kontrolluar fjalët që ka mësuar ose fjalë të reja. | <ul style="list-style-type: none"> - Redakton dhe rishkruan hartime, duke përdorur burime referuese për të zgjeruar fjalorin; - Përshtat fjalorin e mësuar më parë për qëllime të reja. - Shkruan tema me lidhje reale dhe imagjinare. - Përdor burime referuese për të përmirësuar saktësinë e tyre. - Përdor shumëllojshmëri të shprehjes. |
|--|---|

Përdorimi i drejtë gjuhës

Nxënësi:



- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none">- dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pyetëse, pohore dhe mohore, duke respektuar shenjat e pikësimit;- dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe shumës;- zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme, të shkuar dhe të ardhme, sipas modeleve të dhëna;- dallon mbiemrin si fjalë që tregon cilësi të emrit;- formon fjali me përemra vetorë dhe me numërorë. | <ul style="list-style-type: none">- dallon dhe përdor drejt lloje të ndryshme fjalish (dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore);- dallon dhe përdor drejt gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta të fjalisë (kundrinor, rrethanor, përcaktor);- dallon kategoritë kryesore gramatikore të emrit, foljes, mbiemrit, përemrit, si dhe gjen lidhëzat dhe parafjalët;- dallon dhe përdor sinonimet, antonimet, idiomat. |
|---|---|

Njohuritë dhe konceptet

- Komunikim verbal dhe joverbal
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst.
- Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.
- Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare.
- Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman.
- Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim.
- Strofë, varg, rimë.
- Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet.
- Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim.
- Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë.
- Llojet e fjalive sipas intonacionit.
- Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta.
- Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit.
- Parafjalë, lidhëz.
- Shenjat e pikësimit.
- Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Aftësitë dhe shkathhtësitë

- Të dëgjuarit



- Të folurit
- Të shkruarit
- Të lexuarit
- Zgjidhja e problemeve
- Përpunimi i informacionit
- Të menduarit krijues
- Mendimi kritik
- Interpretimi
- Krahasimi
- Vlerësimi
- Prezantimi
- Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Qëndrimet dhe vlerat

- Korrektësi në komunikim.
- Vëmendje gjatë dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit.
- Pjesëmarrje në diskutime duke respektuar dhe pranuar mendimin ndryshe
- Empati gjatë komunikimit.
- Bashkëpunim në grup.
- Motivim për të lexuar për kënaqësi dhe informacion.
- Respektim i etikës gjatë komunikimit personal dhe në grup.
- Vlerësim i kontributit të të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre.
- Vetëbesim dhe vetëvlerësim gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme.
- Vullnet gjatë kryerjes së detyrave.
- Tolerancë dhe respekt për kulturën dhe gjuhën e tjetrit.
- Imagjinatë dhe mendim krijues për zgjidhjen e problemeve.
- Vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grup.
- Pavarësi në vendimmarrje dhe veprime.
- Kureshtje për hulumtim dhe kërkim.
- Kujdes për veten, të tjerët dhe ambientin.



3.1.3 Ndarja e kohës

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” në arsimin e mesëm të ulët zhvillohet:

- Në shkallën e tretë (klasa 6 dhe 7) dhe përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj e parë, Gjuhë e huaj e dytë;
- Në shkallën e katërt (klasa 8 dhe 9) dhe përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, gjuhë e huaj e parë, gjuhë e huaj e dytë.

Planifikimii kohës bëhet në përputhje me rezultatete të nxënimit të përcaktuara për shkallë dhe fushë.

Fusha e të nxënimit	Shkalla 3	Shkalla 4
	Klasa VI – VII	Klasa VIII – IX
Gjuhët dhe komunikimi (% dhe orë)	28.6% 20 orë	26 % 20 orë
Gjuhë shqipe	10 orë	10 orë
Gjuhë e huaj e parë	6 orë	6 orë

3.1.4 Udhëzime metodologjike

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor dhe letrar të nxënësve. Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, kubimi, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënimit, pyetja sjell pyetjen* etj. shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënimit dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënimit. Gjuhët dhe komunikimika për synim matjane kompetencave të fushës të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënimit.

Mësimdhënia duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

a) Mësimdhënie me në qendër nxënësin



Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi” kërkojnë që nxënësit të nxënë konceptet, të zotërojnë shprehjet dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

b) Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxisin të mësuarit bashkëveprues. Nxënësit gjatë orëve të gjuhës shqipe dhe gjuhës së huaj shpesh do të nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta do t’u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

3.1.5 Udhëzime për vlerësim

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënësve. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në procesin e të nxënësve dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien.

Vlerësimi i nxënësve për fushën “Gjuhët dhe komunikimi” ka për synim matjen e kompetencave të fushës të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënësve.

Llojet e vlerësimit

Vlerësimi diagnostikues që zakonisht kryhet në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikatat e mësimdhënies së mësuesit dhe të nxënësve në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi i vazhdueshëm (formues) është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe prindërit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i



mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë të nxënësve.

Vlerësimi përmbledhës kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësve me notë për prezantimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara individualisht ose në grup.

Një formë e vlerësimit me shkrim nga nxënësve janë edhe testimet.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së kompetencave gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, siç janë qortimet nga mësuesi. Praktikën e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësve. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri te rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve; ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësve mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Portofoli i nxënësve, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndër-lëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, mësuesi rekomandon.

Pjesë e vlerësimit është edhe informimi i nxënësve dhe prindërve për rezultatet e vlerësimit. Informacioni është përshkrues ose me notë.



3.1.6 Materialet dhe burimet mësimore

Në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”, për arritjen e kompetencave, është me rëndësi përdorimi i mjeteve dhe materialeve të shumta mësimore. Tekstet mësimore nuk duhet të jenë burimi i vetëm për marrjen e informacionit. Në procesin e të nxënës duhen përdorur materiale nga interneti, libra nga biblioteka e shkollës, fletë pune, udhëzues të ndryshëm etj.



3.2 Fusha e të nxënit: Matematika

3.2.1 Hyrje

Matematika përfaqësohet si fushë të nxëni dhe lëndë mësimore. Formimi matematik i nxënësve duhet t'i përgjigjet kërkesave të shoqërisë së sotme, e cila ka nevojë për individë të aftë në përdorimin dhe interpretimin e matematikës. Matematika mundëson zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të menduar në mënyrë kritike dhe për të punuar në mënyrë të pavarur e sistematike. Ajo nxit kërkshërinë dhe inkurajimin për zbulime, për marrjen e njohurive të reja me qëllim zbatimin e tyre dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Një nga aspektet më të rëndësishme është integrimi i matematikës me të gjitha fushat dhe çështjet ndërkurrikulare me qëllim që të zotërohen kompetencat kyçe.

Matematika mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës. Në shkallën e parë dhe të dytë trajtohet lidhja konceptuale për numrat, figurat gjeometrike, pozicionin në hapësirë, matjet dhe shkathtësitë për llogaritje dhe zgjidhje të problemeve. Në shkallën e tretë dhe të katërt kjo lidhje integrohet me njohuritë nga algjebra, gjeometria dhe statistika, kurse në shkallën e pestë dhe të gjashtë sigurohet një zgjerim dhe thellim i njohurive edhe nga trigonometria, analiza matematike dhe probabiliteti. Në këto shkallë matematika është në funksion të përgatitjes së nxënësve për studime të mëtejshme.

Nëpërmjet mësimit të matematikës, nxënësit do të marrin njohuri mbi numrat, hapësirën, masat dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave (statistikës). Ata do të jenë në gjendje të kuptojnë rolin e të menduarit matematik për zhvillimin e shkencës e të teknologjisë moderne, si dhe rëndësinë e zbatimit të matematikës në situatat e zgjidhjes së problemeve nga jeta reale. Në këtë fushë, nxënësit vlerësojnë matematikën në tërësi si formë e përshkrimit, si metodë e njohjes së realitetit dhe si pjesë e kulturës njerëzore e progresit shoqëror.

3.2.2 Qëllimi i fushës së matematikës

Fusha/lënda e matematikës ka si qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë dhe strukturat matematikore, si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë



llogaritëse dhe të zgjidhjes së problemit në jetën e përditshme. Nëpërmjet fushës/lëndës së matematikës, zhvillohet elasticiteti intelektual, aftësia për të gjykuar nga këndvështrime të ndryshme, përqëndrimi, aftësia krijuese, fantazia dhe marrja e vendimeve, të cilat janë me rëndësi për një organizim aktiv dhe të përgjegjshëm të shoqërisë. Karakteristikë e mënyrës matematikore të të punuarit dhe të të menduarit janë përdorimi i saktë i gjuhës, zhvillimi i koncepteve të qarta, të menduarit logjik, argumentimi, si dhe kuptimi i varësive reciproke ndërmjet dukurive e proceseve.

Mësimi i matematikës në shkollë synon që nxënësi:

- të fitojë përvoja në paraqitjen e koncepteve me mënyra të ndryshme;
- të mësojë të argumentojë, me shkrim dhe me gojë, përgjigjet e tij duke u bazuar në ilustrime dhe mjete konkrete;
- të mësojë të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet, rregullsitë dhe marrëdhëniet shkak-pasojë ndërmjet dukurive, të praktikohet në vëzhgime të situatave problemore që kanë lidhje me mjedisin e tyre të përditshëm;
- të kuptojë konceptet matematike nëpërmjet hetimeve dhe t'i përdorë ato;
- të dallojë situatat problemore dhe të zgjidhë problema matematike;
- të argumentojë veprimet dhe përfundimet e tyre dhe t'ua paraqesë të tjerëve;
- të përdorë rregulla dhe të ndjekë udhëzime;
- të edukohet të punojë në grup;
- të paraqesë situatat matematikore në mënyra të ndryshme;
- të përdorë teknologjinë për të lehtësuar zbatimet e matematikës.
- të ndihet i suksesshëm në matematikë.

3.2.3 Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Fusha/lënda e matematikës zhvillohet nga klasa e parë deri në klasën e nëntë të arsimit bazë dhe mësimdhënia e nxënia e saj mbështetet në disa tematika kryesore. Secila tematikë ka të bëjë me njohuritë, shprehjet matematike dhe qëndrimet të cilat përdoren për përmbushjen e kompetencave kryesore të fushës dhe kompetencave kyç. Fusha/lënda e matematikës fokusohet në këto tematika kryesore:

Numrat: Nxënësi përdor kuptimin e numrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe algoritmin e veprimeve me numra për të paraqitur sasi në botën reale.



Matjet: Nxënësi zbaton proceset e matjes, përzgjedh teknika dhe formula të përshtatshme për të kryer matje direkte dhe indirekte në situata reale.

Gjeometria: Nxënësi përdor arsyetimin dhe vërtetimin për të zbuluar dhe provuar marrëdhëniet gjeometrike.

Algjebra dhe Funkzioni: Nxënësi zbulon ligjësi, përdor kuptimin për funksionin dhe simbolet algjebrike për të modeluar marrëdhënie dhe situata matematikore.

Statistika dhe Probabiliteti: Nxënësi lexon, kupton dhe interpreton të dhënat statistikore për të marrë vendime në jetën e përditshme.

3.2.4 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

Fusha/lënda e matematikës nëpërmjet përmbajtjes dhe shprehive të përcaktuara, ka si qëllim, që gjatë zbatimit, të zhvillojë bazat e të menduarit matematik, të ushtrojë përqëndrimin dhe komunikimin, nëpërmjet përvojave empirike të hedhë themelet e formulimit të koncepteve e strukturave matematike. Në përmjet shprehive të përcaktuara, ajo hedh themelet e modelimeve matematike, thellon kuptimin e koncepteve bazë duke zgjeruar gamën e tyre e duke vendosur bazat për asimilimin e mëvonshëm të koncepteve e strukturave matematike që lidhen me zgjidhjen e problemeve me jetën e përditshme.

Sipas Kornizës Kurrikulare të Shqipërisë, të mësuarit është e bazuar në kompetenca. Kompetencat përcaktohen si njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë një procesi të mësimdhënies dhe nxënies. Kompetenca demonstron nga nxënësi (njohuri), bazohet në performacën e tij (aftësi) si dhe në perspektivën e sjelljes (qëndrim). Organizimi i mësimi të matematikës me bazë kompetenca përqëndrohet në atë që duhet të bëjë dhe që duhet të jetë i gatshëm të bëjë nxënësi.

Bazuarnë këtë kurrikulë, fusha/ lënda e matematikës synon të përmbushë 6 kompetenca kryesore të fushës/lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyç që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij.

Kompetencat e fushës së matematikës	Përshkrimi i tyre
Zgjidhja problemore në matematikë	Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore që krijohen brenda matematikës, të marra nga fushat e tjera shkollore si dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së



	përditshme.
Arsyetimi dhe vërtetimi matematik	Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës.
Të menduarit dhe komunikimi matematik	Nxënësi përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik.
Lidhja konceptuale	Nxënësi kupton ndërtimin e koncepteve matematike për të formuar një të tërë dhe përdorur varësitë ndërmjet këtyre koncepteve.
Modelimi matematik	Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situatatë jetës së përditshme.
Përdorimi i teknologjisë në matematikë	Nxënësi përdor teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar infiguracione.

3.2.5 Rezultatet e të nxënit

Rezultatet thelbësore mësimore në matematikë bazohen në këto gjashtë kompetenca matematikore. Më poshtë paraqiten rezultatet e të nxënit për secilën kompetencë matematikore për shkallën e tretë dhe të katërt.

KSNA 2	
Shkalla e tretë, klasat VI – VII	Shkalla e katërt, klasat VIII – IX



Rezultatet e të nxënit në fund të klasës së shtatë

Rezultatet e të nxënit në fund të klasës së nëntë

1. Zgjidhja problemore në matematikë

Nxënësi :

- Përdor simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numra racionalë.
- Demonstron marrëdhëniet ndërmjet numrave racionalë.
- Përdor matjet në figurat 2D (D = dimensionale) dhe në objekte 3D për zgjidhjen problemore.
- Përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave.
- Kryenvrojtime dhe interpretimetë tabelave dhe diagrameve të gatshme.

- Përdor koncepte, simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numra realë.
- Demonstron zgjidhjen problemore që lidhet me shprehjet algjebrike dhe transformime gjeometrike.
- Përdor matjet në figurat 2D dhe në objekte 3D për zgjidhjen problemore.
- Përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave.
- Kryen vrojtime, hetime që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.
- Përshkruan dhe modelon matematikisht situata problemore që krijohen me numra realë, shprehje algjebrike, figura 2D, objekte 3D nga lëndët e tjera dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme.

2. Arsyetimi dhe vërtetimi matematik

Nxënësi :

- Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D.

- Arsyeton dhe vërteton pohime matematike përmes metodave



- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none">– Sugjeron formula të ndryshme.– Ndërton figura gjeometrike.– Klasifikon numrat racionalë.– Përdor kundërshebullin.– Argumenton shndërrimet. | <ul style="list-style-type: none">– direkte dhe indirekte, të zbatuara në veprimet me numrrealë, transformime gjeometrike, matje, probabilitet dhe statistikë.– Zhvillon dhe zbaton shprehite arsyetimit (dallimi i marrëdhënieve, përgjithësimime anë të induksionit, deduksione të thjeshta, përdorimi empirik i kundërshebullit).– Hamendëson dhe gjykon hamendësime.– Planifikon dhe strukturon argumente matematike për përfundimet e gjetura. |
|--|--|

3. Të menduarit dhe komunikimi matematik

Nxënësi :



- Demonstron zbatimin e numrave racional.
- Kryen matje përfiguruar 2D dhe objektet 3D.
- Përdor terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme.
- Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur:
 - a) gjuhën e përditshme;
 - b) fjalorin fillestar matematik;
 - c) paraqitje të ndryshme.
- Komunikon të menduarin e tij matematik duke përdorur simbole matematike.
- Krijon paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale;
- Mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore.
- Gjeneron konkludime të përshtatshme matematike duke grumbulluar dhe përpunuar të dhënat.
- Grumbullon dhe ruan infiguracione nga burime të ndryshme që ndërlidhen me numrat realë dhe vetitë e tyre, shprehje algjebrike, statistikë dhe probabiliteti.
- Përkthen nga gjuha natyrore në atë të matematikës dhe anasjelltas.
- Komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur:
 - a) fjalorin dhe simbolet matematike;
 - b) paraqitje të ndryshme të përshtatshme.
- Krijon shumëllojshmëri të paraqitjeve me vizatime apo me përdorimin e teknologjisë, të koncepteve matematike (numerike, gjeometrike, algjebrike, grafike).
- Krijon krahasime mes tyre dhe zbaton paraqitje të përshtatshme në zgjidhjen e problemave.
- Përdor burime të ndryshme për marrjen e infiguracionit.
- Mendon matematikën si pjesë e kulturës njerëzore.

4. Lidhja konceptuale



Nxënësi :

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore. - Integron njohuritë e shprehitë matematike me situata ose dukuritë marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.). - Integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme. | <ul style="list-style-type: none"> - Lidh koncepte dhe modele të reja matematike me ato të përvetësuara më parë nga fusha e matematikës dhe fushat e tjera dhe kupton formimin e tyre. - Përdor varësitë ndërmjet koncepteve matematike mbi njëri-tjetrin, për të formuar një të tërë; - Integron njohuritë dhe shprehitë matematike me situata ose dukuritë marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet, arti dhe kultura, ngjarjet aktuale etj.). - Informohet për zhvillimin e koncepteve matematike përgjatë kohës dhe në kultura të ndryshme. |
|--|---|

5. Modelimi matematik

Nxënësi

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Krijon modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore si numër dhjetor, thyesë, përqindje, eksponent, kënde, kongruencë dhe simetri; - Përdor figurat simbolike përmes vijave dhe grafikëve, për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në matematikë, në fushat e tjera dhe në jetën e përditshme. | <ul style="list-style-type: none"> - Krijon një shumëllojshmëri të gjerë të koncepteve rrënjë katrore, ngjashmëri, funksion linear, polinome, bazuar në parimin e modelimit matematikor. - Përdor parimin e modelimit matematikor për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme. |
|---|---|



6. Përdorimi i teknologjisë në matematikë

Nxënësi :

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">– Përdor makina llogaritëse të avancuara për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara matematikore.– Zgjidh detyra matematike, duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e Teknologjisë dhe TIK-ut.– Përdor teknologjinë për të analizuar, komunikuar dhe zbuluar infiguracion matematik.– Përdor teknologjinë për zbatime të matematikës në shkencat e tjera. | <ul style="list-style-type: none">– Përdor makina llogaritëse të avancuara për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara matematikore.– Zgjidh detyra matematike, duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e Teknologjisë dheTIK-ut;– Verifikon rezultatet e problemeve të ndryshme duke përdorur TIK dhe programe (p.sh. MS, EXCEL);– Përdor teknologjinë për të analizuar, interpretuar dhe zbuluar infiguracion matematik;– Përdor teknologjinë për zbatime të matematikës në shkencat e tjera. |
|---|--|

Njohuritë dhe konceptet

- Numrat realë.
- Veprime me numra realë.
- Njehsimi i gjatësisë, perimetrit, syprinës, vëllimit, kohës, masës; monedhat.
- Figurat, gjeometria në plan.
- Objektet, gjeometria në hapësirë.
- Shndërrimet gjeometrike dhe sistemi koordinativ.
- Trigonometria
- Algjebra dhe funksioni.
- Shprehjet shkronjore dhe shndërrime të tyre.



- Ekuacionet, inekuacionet, sisteme të ekuacioneve dhe zgjidhja e tyre.
- Funkzioni
- Statistika, grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave.
- Probabiliteti

Aftësitë dhe shkathtësitë

- Identifikimi
- Përshkrimi
- Formulimi
- Arsyetimi
- Zbatimi
- Njehsime
- Matje
- Vrojtimi
- Skicime
- Krijimmodelesh
- Interpretimi
- Ndërtimi
- Krahasimi
- Vlerësimi
- Prezantimi
- Përdorimi i burimeve dhe i mjeteve

Qëndrimet dhe vlerat



- Kurioziteti
- Motivimi për studimin e matematikës.
- Organizimi i të menduarit.
- Shpirti i objektivitetit dhe paanësisë.
- Imagjinata dhe krijimtaria për zgjidhjen e problemeve.
- Insistimi në fokusimin e problemeve.
- Vetvlerësimi dhe mendimi kritik.
- Pavarësia në mendime dhe veprime.
- Qëndrimi ndaj pyetjeve.
- Dyshimi dhe siguria.
- Kritikë konstruktive.
- Iniciativa dhe interesi në qasjet e ndryshme.
- Besimi në forcat vetjake.
- Besimi në përdorimin e teknologjisë.
- Respekti për punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta).
- Vullneti dhe toleranca.
- Respekti për saktësinë, përpjekjet vetjake dhe ato në grup.
- Besimi te vlerat që matematika u ofron individëve dhe shoqërisë.

3.2.6 Ndarja e kohës

Plani mësimor specifikon përqindjen e peshës së fushës/lëndës së matematikës si dhe numrine orëve që ka matematika për secilën shkallë.

Fushat e të nxënit	KNSA 2	
	Shkalla 3	Shkalla 4
	Klasa VI – VII	Klasa VIII – IX
Matematikë (%)	14.3%	13.3%
Matematikë (orë)	8 orë	7 orë



3.2.7 Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e matematikës është kusht parësor në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Mësimdhënia e matematikës, e cila udhëhiqet nga parimi që “çdo nxënës është i aftë të nxërë matematikë”, synon gjithëpërfshirjen, barazinë në të gjitha aspektet dhe motivimin.

Nxënësi të një klase janë të ndryshëm, përse i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e matematikës kërkon që nxënësit të zotërojnë kompetencat, të nxënë konceptet, të zotërojnë shprehjet. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e matematikës mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënësve të matematikës;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që dhënia e çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë matematikore;
- të nxënësve bazuar në hetimin dhe zbulimin;
- rëndësinë e zbatimeve praktike, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet matematike mesituata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe teknologjisë;
- rolin e zgjidhjes së problemave dhe shumëllojshmërisë së strategjive të zgjidhjeve;
- veçoritë e punës individuale dhe punës në grup;
- dobinë e përdorimit të burimeve të shumëllojshme të informacionit (përfshirë TIK-un);
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së matematikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor



mësuesi dhe nxënësi janë komplementarë të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e mirëmenđuar dhe e mirëplanifikuar krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit.

3.2.8 Udhëzime për vlerësimin

Roli parësor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënësit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anë të dobëta dhe anë të forta të nxënësve në përmbushjen e rezultateve të të nxënësit për secilën kompetencë, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Nëpër zgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve, duhen pasur parasysh:

- Përcaktimi i qëllimit dhe i strategjisë së vlerësimit;
- Përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimi qartë i qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim;
- adresimi i vlerësimit të njohuritë, shprehitë e aftësitë ;
- reflektimi i besimit që të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;
- informacioni për rezultatet e vlerësimit duhet të motivojë nxënësin, të ndikojë që nxënësi të pranojë se gabimi është pjesë e të nxënësit dhe të ndihmojë progresin e mëtejshëm;
- vlerësimi duhet të konsiderohet si pjesë e procesit mësimdhënie-nxënie dhe jo si veprimtari më vete;
- vlerësimin dihon nxënësit të marrin përgjegjësi për veten e tyre, duke përfshirë strategji të vetëvlerësimit, të vlerësimit të shokut me shokun;
- vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës në kuptimin që t'u sigurojë mundësinë të gjithë nxënësve të demonstrojnë arritjet e tyre dhe të arrijnë më të mirën e mundshme.



Vlerësimi inxënësve ndahet në tre tipe kryesorë:

Diagnostikues, që zakonisht kryhet në fillim të shkollës apo vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikatat e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, jo formal dhe mund të bëhet me gojë.

Formues, një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe prindërit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar procesin e mësimdhënies - nxënies. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vlerësimi me notë i nxënësit.

Përmbledhës, që kryhet për të përcaktuar çfarë është mësuar pas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimetpërmbledhëse përdorenjo vetëmpër tëinformuar nxënësite prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për tëpërmirësuar praktikatat e mësimdhëniesdhetë nxënësit.

Gjatë vlerësimit mësuesi duhet të mbështetet në një sasi të konsiderueshme të dhënash që përfshihen në këto elemente:

- vlerësimi i përgjigjeve me gojë;
- vlerësimi i punës në grup;
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë;
- testet për një grup temash të caktuara;
- testet në përfundim të një kohe të caktuar;
- testet në përfundim të gjysmës së parë ose në fund të vitit mësimor.

Detaje që kanë lidhje me vlerësimin në arsimin bazë gjenden në dokumente zyrtare të posaçme për këtë qëllim.

3.2.9 Materialet dhe burimet mësimore

Gjatë mësimit të matematikës, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime të cilat nxënësi i



prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, bën vizatime, modelime, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedise për aktivitete alternative etj.

Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, një kuptimore dhe me një fjalor të pastër të gjuhës. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai/ajo u prezanton/sqaron nxënësve përmbajtje të caktuara ose shkathtësitë që ata duhet të performojnë.

Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medieve detyra dhe projekte të ndryshme.



3.3 Fusha e të nxënit: Shkencat e natyrës

3.3.1 Hyrje

Shkenca është veprimtari intelektuale dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Kompetencat, që zhvillon kjo fushë, u shërbejnë individëve në aspektin personal, social dhe ekonomik. Njohja e shkencave natyrore kontribuon në përparimin teknologjik dhe siguron zhvillimin e qëndrueshëm të jetës në planetin tonë.

Kurrikula bërthamë e shkencave të natyrës është e detyrueshme për të tre nivelet e arsimit parauniversitar.

Në shkallën 3 dhe në shkallën 4, fusha e shkencave natyrore integron njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: biologji, fizikë, kimi. Në këto shkallë nxënësit zgjerojnë fushën e njohjes për dukuritë më të zakonshme në jetën dhe veprimtaritë e përditshme, zhvillojnë aftësitë, strategjitë dhe shprehitë e të menduarit të nevojshme për hetimin shkencor dhe skicimin teknologjik, lidhin njohuritë shkencore dhe teknologjike me njëra-tjetrën dhe me jetën, përdorin gjuhën dhe terminologjinë shkencore, si dhe krijojnë bazat konceptuale për të nxënit e mëtejshëm të shkencës.

Kurrikula bërthamë *në shkallën 3 dhe 4* fokusohet në zhvillimin e koncepteve të rëndësishme të shkencës, duke i përfshirë nxënësit në situata kontekstuale të rëndësishme dhe duke i motivuar ata nëpërmjet zbatimeve dhe përfshirjeve në kërkime shkencore aktuale. Atyre u krijohen mundësitë të ndërmarrin hetime të hapura për të zhvilluar aftësitë e kërkimit, për të zhvilluar ide abstrakte të shkencës si dhe teori themelore të saj (e pjesëzave, atomike, evolucionit).

3.3.2 Qëllimet e fushës

Qëllimet e fushës së shkencave të natyrës janë konceptuar në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Përmes kësaj fushe nxënësit:

- zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në shkencat e natyrës;



- zbulojnë lidhjet e varësisë ndërmjet botës së gjallë dhe mjedisit;
- zhvillojnë aftësitë shkencore, të menduarit kritik dhe krijues;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe shoqërisë;
- nxisin kureshtjen dhe zhvillojnë interesin për botën që i rrethon;
- ndërgjegjësohen për të bashkëvepruar me mjedisin në mënyrë të përgjegjshme dhe konsensuale;
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;
- shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

3.3.3 Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Tematikat e përbashkëta të fushës janë koncepte themelore rreth të cilave organizohet e gjithë përmbajtja e fushës, përkatësisht dhe e disiplinave që përfshihen në të. Ato shërbejnë si instrument i fuqishëm integruar në funksion të zhvillimit të kompetencave të fushës.

Temat e përbashkëta të fushës për **shkallët 3 – 4** janë *diversiteti, sistemet, ndërveprimet, energjia, modelet, shkallëzimi dhe matja*.

Ndonëse secila prej tyre përshkruhet veçmas, ato shpesh kanë elemente të ndërthurur gjatë hartimit dhe zbatimit të programeve për zhvillimin e kompetencave.

Diversiteti

Kjo temë nënvizon rëndësinë e ruajtjes së shumëllojshmërisë në natyrë. Për të kuptuar më mirë botën, në të cilën jetojmë, njeriu përpiqet të organizojë këtë shumëllojshmëri. Ka disa tipare të përbashkëta që lidhin të gjitha qeniet e gjalla dhe faktorë unikë në botën jo të gjallë që e ndihmojnë njeriun t'i klasifikojë ato. Ruajtja e shumëllojshmërisë siguron mbijetesën dhe vazhdimësinë e jetës.

Në fokus të kësaj teme në këto shkallë është diversiteti i kafshëve, bimëve, mikroorganizmave, mjedisit natyror, lëndëve dhe vetive e karakteristikave të tyre.



Sistemet

Një sistem përfaqëson një tërësi pjesësh të cilat punojnë së bashku për të kryer një funksion të caktuar. Ka sisteme në natyrë, si dhe sisteme të ndërtuara nga njeriu. Ndër shembujte sistemeve në natyrë janë sistemet e trupit të njeriut. Shembuj të sistemeve të ndërtuara nga njeriu janë sistemet elektrike. Njohja e sistemeve e lejon njeriun të kuptojë si funksionon secila pjesë e sistemit dhe si ndërveprojnë me njëra-tjetrën për të kryer një funksion të caktuar.

Kjo temë përqendrohet tek studimi i sistemeve të bimëve, kafshëve dhe njeriu, studimi i sistemit elektrik, sistemit Diellor dhe Tokës, sistemeve të orientimit dhe lëvizjes si harta dhe globi, sistemeve të matjes.

Ndërveprimi

Studimi i ndërveprimit midis dhe brenda sistemeve zhvillon të kuptuarit e mjedisit dhe rolit të njeriut në të. Ndërveprimet ndodhin brenda një organizmi, midis organizmave si dhe midis organizmave dhe mjedisit. Ndërveprimi i njeriut me mjedisin drejton zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë. Në të njëjtën kohë shkenca dhe teknologjia ndikojnë në mënyrën si njeriu ndërvepron me mjedisin. Të kuptuarit e këtij ndërveprimi ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë pasojat pozitive dhe negative të veprimeve të tij dhe të jetë përgjegjës për to.

Tema fokusohet te ndërveprimi brenda dhe ndërmjet bimëve, kafshëve, njeriut dhe mjedisit, mikroorganizmave, atmosferës, sistemit diellor dhe tokës, forcave, shkencës dhe teknologjisë.

Energjia

Energjia bën të mundur ndryshimet dhe lëvizjen në natyrë. Njeriu përdor forma të ndryshme energjie për qëllime të ndryshme. Të gjitha qeniet e gjalla, përfshirë dhe njeriun, kanë nevojë për energji për të kryer proceset jetësore. Të kuptuarit e kësaj teme i ndihmon nxënësit të vlerësojnë rëndësinë dhe përdorimet e energjisë si dhe nevojën për ta ruajtur atë.

Kjo temë studion burimet dhe përdorimet e energjisë, shndërrimet e saj nga një formë në tjetrën, dritën, zërin, elektricitetin dhe magnetizmin. Ajo trajton mënyrat e shfrytëzimit të energjisë dhe u krijon mundësitë nxënësve për të identifikuar rastet e keqpërdorimit dhe, për pasojë, të ruajtjes dhe kursimit të saj.



Modelet

Modelet përfaqësojnë dukuritë dhe ndërtohen për të lehtësuar kuptimin e proceseve dhe të strukturave që nuk mund të vrotohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose për të bërë parashikime të arsyetuara. Modelet përdoren në mësimin e shkencës dhe përfshijnë ato fizike, konceptuale dhe matematike. Meqenëse ato janë përfaqësime të dukurive aktuale, së brendshmi ato nuk janë të sakta. Kjo është arsyeja pse ato ndryshojnë gjatë përpjekjeve që bën njeriu për përmirësimin e tyre në paraqitjen, shpjegimin dhe parashikimin e dukurive.

Tema fokusohet te modeli i qelizave si njësitë bazë të jetës, modeli grimcor i lëndës, modeli i atomit dhe molekulës, modeli i valor i dritës.

Shkallëzimi dhe matja

Kuptimi i shkencës nga nxënësit varet nga shkallëzimi që ata i bëjnë kohës dhe hapësirës pasi nëpërmjet tij ata mund të bëjnë krahasime gjatë vrotimeve. Shpesh ata kanë vështirësi të punojnë me shkallëzime që nuk i përdorin në jetën e përditshme, të tilla si ato të distancave shumë të mëdha në hapësirë apo ato shumë të vogla në botën e atomit apo në proceset e ngadalta në kohë të fazave gjeologjike. Gjatë mësimin të shkencës nga shkalla 1- 4, nxënësit mësojnë dhe përshtaten me shumëllojshmëri shkallëzimesh. Ata krahasojnë ngjarjet dhe dukuritë duke përdorur terma të gjuhës së përditshme si “më e madhe”, “më shpejt” etj. në matje të përafërta “me sy”, ose duke përdorur sisteme shkallëzimi në matje të sakta, me instrumente dhe njësi matëse të zyrtarizuara, si p.sh. sistemin ndërkombëtar të njësisive SI.

Kjo temë fokusohet te madhësitë fizike, kimike, biologjike, gjeografike, sistemet e njësisive, matjet dhe krahasimet e tyre.

3.3.4 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

I gjithë procesi i të nxënit në fushën e shkencave, në të gjitha shkallët, ka në fokus zhvillimin e **kërkimit shkencor**.

Ai organizohet rreth tri kompetencave, të njëjta në të gjitha shkallët.

Kompetenca 1: Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre.

a) *Përcakton problemin:*



- Identifikon karakteristikat shkencore të problemit.
- Thekson elementet që kanë lidhje me njeri-tjetrin.
- Formulon problemin.
- b) *Zgjedh hetimin ose skicon strategjinë:*
 - Konsideron strategji të ndryshme.
 - Merr parasysh kufizimet që shoqërojnë secilin skenar.
 - Zgjedh atë që mendon se është strategjia më e mirë .
 - Argumenton zgjedhjet e bërë.
 - Planifikon procedurën .
- c) *Analizon rezultatet e tij/saj ose zgjidhjen :*
 - Kërkon trendët domethënës në të dhënat ose provat tipike.
 - Kontrollon rezultatet sipas procedurës.
 - Formulon probleme të reja ose sugjeron mënyrat e përmirësimit të zgjidhjes.
 - Nxjerr rezultatet .
- d) *Realizon procedurën:*
 - Ndjek hapat e planit.
 - Nëse është e nevojshme, përshtat testet e tij/saj, rishikon planin e tij/saj ose kërkon një mënyrë të re për zgjidhjen e problemit.
 - Mban shënim për çdo detaj ose vrojtim të nevojshëm për analizën e problemit.

Kompetenca 2: Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore.

- a) *Identifikon ndikimet e shkencës dhe të teknologjisë:*
 - Studion ndikimet afatgjata të shkencës dhe të teknologjisë tek individët, shoqëria, mjedisi dhe ekonomia.
 - Vendos shkencën dhe teknologjinë në kontekstet e tyre sociale dhe historike; studion ndikimin e tyre në mënyrën e jetesës së njerëzve.
 - Identifikon pyetje ose çështje etike.
- b) *Kupton si funksionojnë objektet teknike:*
 - Demonstron kuriozitet rreth disa objekteve teknike.
 - Shqyrton përbërjen dhe funksionimin e tyre.
 - I zbërthen në pjesë, nëse është e nevojshme.
 - Identifikon materialet, pjesët dhe tipat e ndryshëm të lidhjeve në objektet teknike.



- Dallon sisteme dhe nënsisteme të ndryshme.
- Shpjegon si funksionojnë ato.
- c) *Kupton dukuritë natyrore:*
 - Pyet veten rreth mjedisit të tij/saj.
 - Shqyrton dukuri të veçanta.
 - Përshkruan karakteristikat e tyre.
 - I ilustron ato me diagrama skematike.
 - Shpjegon dukuritë duke përdorur ligjet ose modelet.
 - Siguron koherencën e shpjegimit.
 - Familjarizohet me konceptet që lidhen me dukuritë dhe pranon lidhjen e tyre.

Kompetenca 3: Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.

- a) *Shkëmben informacione shkencore me të tjerët:*
 - Kupton rolin e ndarjes së informacionit.
 - Është i hapur në këndvështrimet e të tjerëve.
 - Krahason të dhënat dhe procedurat e tij/saj me ato të të tjerëve.
 - Vlerëson këndvështrimin e tij/saj ose zgjidhjen duke i krahasuar ato me të tjerët.
- b) *Përhap dhe zhvillon njohuritë ose rezultatet shkencore:*
 - Merr parasysh përbërjen e audiencës.
 - Përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit (p.sh. simbolet, tabelat, vizatimet teknike).
 - Përshtat mesazhin sipas tipit të medias që përdor (p.sh. prezantim me gojë ose me shkrim, faqe web) .
- c) *Interpreton dhe formulon mesazhe shkencore:*
 - Përdor informacionin shkencor dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme.
 - Sigurohet që burimet të jenë të besueshme.
 - Vlerëson përshtatshmërinë e tyre.
 - Prezanton informacionin sipas rregullave dhe konvencioneve të shkencës, teknologjisë dhe matematikës.

Të tri kompetencat e fushës lidhen me njëra-tjetrën. Nëse kompetenca e parë ka të bëjë me mënyrat e të arsyetuarit, që i mundësojnë nxënësit të merren me probleme shkencore, dy



kompetencat e tjera i mësojnë ata se si të përdorin instrumentet dhe procedurat e duhura dhe si të komunikojnë në gjuhën e shkencës dhe të teknologjisë për të zgjidhur problemet. Duke zbatuar mënyrat e të arsyetuarit shkencor, nxënësit do të kuptojnë natyrën e mjeteve, objekteve dhe procedurave të përdorura në këtë fushë dhe do të jenë të aftë të vlerësojnë ndikimin pozitiv apo negativ të shkencës dhe teknologjisë në mjedis dhe shoqëri. Përveç kësaj, në prezantimin e shpjegimeve ose sqarimin e zgjidhjeve të tyre, ata do të ndërgjegjësohen për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës dhe terminologjisë në shkencë dhe teknologji.

Këto kompetenca zhvillohen së bashku dhe jo veçmas apo njëra pas tjetrës. Për të realizuar metodat dhe procedurat specifike shkencore, nxënësit duhet të njohin dhe të aftësohen për të përdorur konceptet dhe gjuhët që lidhen me to. Ata familjarizohen me këto metoda dhe procedura të cilat marrin kuptim dhe kanë rëndësi sipas konteksteve ku zbatohen.

Kompetencat e fushës së shkencave lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me kompetencat kyçe. Ato janë të lidhura ngushtë me tematikat e fushës dhe zhvillohen nëpërmjet tyre.

3.3.5 Rezultatet e të nxënit

KSNA 2	
Shkalla e tretë, klasat VI-VII	Shkalla e katërt, klasat VIII-IX
Rezultatet në fund të klasës së shtatë	Rezultatet në fund të klasës së nëntë
1. Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre	
Nxënësi:	



- Eksploron probleme duke kërkuar qasje dhe strategji relativisht komplekse dhe abstrakte.
- Mbledh informacionin, planifikon punën e tij/saj dhe mbledh të dhëna për një numër të madh parametrash.
- Vlerëson qasjen e tij/saj duke marrë parasysh një numër të madh elementesh.
- Kur analizon një problem, ai/ajo konsideron si dimensionet shkencore, ashtu dhe teknologjike të problemit dhe situatës.
- Përfshihet në procesin e kërkimit shkencor dhe përcakton situatën e dhënë
- Sipas procesit të hetimit shkencor, formulon çështje që lidhen me të ose afron shpjegime tentative, duke i përdorur ato për të formuluar hipoteza të testueshme ose për të bërë parashikime të pëlqyeshme.
- Justifikon hipotezën e tij/saj ose parashikimet.
- Zhvillon procedurën e tij/saj dhe kur është e përshtatshme kontrollon të paktën një ndryshore që ndikon në rezultatet.
- Në zhvillimin e procedurës zgjedh mjetet, pajisjet dhe materialet që do t'i nevojiten mes burimeve që ka në dispozicion dhe, nëse është e nevojshme, përdor teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.
- Zbaton procedurën e tij/saj, punon në mënyrë të sigurtë dhe bën përshtatje nëse është e nevojshme.
- Mbledh të dhëna të vlefshme me anë të përdorimit të saktë të mjeteve ose instrumenteve që ka zgjedhur.
- Analizon të dhënat që ka mbledhur, duke i përdorur ato për të formuluar përfundime ose shpjegime relevante.
- Nëse është e aplikueshme, propozon më pas hipoteza të reja ose sugjeron mënyrat e modifikimit të procedurave.



2. Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore.

Nxënësi:

- Përdor mjete, teknika, instrumente dhe procedura që janë më komplekse dhe abstrakte se ato të përdorura në shkallën e dytë, duke u përfshirë më shumë dhe duke bërë vlerësime të sofistikuar të rezultateve që ka marrë.
- Skicon mjete më të përdorshme, instrumente dhe teknika.
- Njeh fushat kryesore në të cilat zbatohet shkenca dhe teknologjia (p.sh. teknologjia e kompjuterave, bioteknologjia, inxhinieria mjeksore, farmakologjia, transformimi i energjisë dhe zbatimet e saj, robotika, astronautika).
- Merret me situatën ose çështjet që lidhen me dukuritë natyrore, ngjarjet aktuale, problemet e përditshme ose çështjet madhore të ditës. I analizon ato nga këndvështrimi shkencor duke iu referuar njëres ose më shumë disiplinave shkencore.
- Kur analizon një situatë në këndvështrimin shkencor, përcakton dukurinë në fjalë dhe identifikon komponentët shkencore. Përcakton shpjegimet ose zgjidhjet tentative dhe pastaj i zhvillon ato mbi bazën e disa koncepteve, ligjeve, teorive dhe modeleve shkencore.
- Kur analizon një situatë në një këndvështrim teknologjik, përcakton funksionin e objektit dhe provon si punon ai. Përdor objektin dhe nëse është e nevojshme, e ndan në pjesë për të kuptuar sistemet kryesore dhe mekanizmat e tij. Përshkruan parimet e punës të objektit duke përdorur koncepte të përshtatshme shkencore dhe teknologjike. Shpjegon zgjidhjet për zgjedhjen e objektit.
- Studion përparësitë dhe mangësitë e zgjidhjeve të mundshme si pjesë të procesit të vendimmartjes si dhe identifikon ndikimin e vendimit të tij/saj, duke u fokusuar veçanërisht në ndikimet mjedisore dhe etike.

3. Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.

Nxënësi:



- Interpreton dhe rendit informacion kompleks shkencor dhe teknologjik që përfshin një numër të madh të elementeve të gjuhës shkencore dhe të teknologjisë (një numër të madh termash dhe shprehjesh të specializuara; një numër të madh të simboleve, formulave, diagramave, tabelave dhe grafikëve).
- Interpreton dhe formulon mesazhe gojore, me shkrim ose vizuale që lidhen me shkencën dhe teknologjinë.
- Përdor saktësisht gjuhën e shkencës dhe teknologjisë, përfshirë gjuhën matematike dhe të simboleve si dhe gjuhën e jetës së përditshme.
- Formulon mesazhe të qarta, të organizuara dhe strukturuara mirë duke ndjekur konvencionet.
- Përshtat mesazhin e tij/saj sipas audiencës së synuar (nëse është e nevojshme).
- Shpjegon mesazhet, që ka formuluar ose interpretuar ,duke përdorur gjuhën e jetës së përditshme.

I. Njohuritë dhe konceptet

Dukuritë shkencore, modelet, faktet, konceptet dhe parimet, fjalori dhe terminologjia shkencore, instrumentet dhe aparatet shkencore, teknikat e sigurisë, zbatimet shkencore dhe teknologjike.

Diversiteti

- Shëndeti dhe sëmundjet
- Evolucion i njeriut
- Klasifikimi i gjallesave
- Proceset jetësore të bimëve
- Klasifikimi i bimëve
- Kafshët jorruazore/invertebrorët
- Kafshët rruazore/vertebrorët
- Viruset dhe monerët
- Protistët
- Kërpudhat
- Evolucion i jetës në Tokë
- Trashëgimia dhe riprodhimi
- Grupet e lëndëve
- Vetitë e metaleve dhe jometaleve
- Lidhja kimike
- Oksidet, bazat, acidet, kripërat
- Ajri, oksigjeni dhe dioksidi i karbonit
- Vetitë e disa elementeve dhe grupeve në tabelën periodike



- Përbërjet organike
- Hidrokarburet

Sistemet

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> – Qeliza – Elektriciteti – Mbrojtja, mbështetja dhe lëvizja – Gjaku dhe qarkullimi i tij – Frymëkëmbimi dhe aparati i frymëkëmbimit – Të ushqyerit dhe ushqimet – Jashtëqitja dhe ekuilibri I organizmit – Riprodhimi te njeriu – Sistemi nervor | <ul style="list-style-type: none"> – Veçoritë e së gjallës – Qeliza dhe sistemet qelizore – Trashëgimia dhe riprodhimi – Elektrostatika – Rryma elektrike |
|--|--|

Ndërveprimi

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> – Organizmat dhe mjedisi – Të ushqyerit dhe ushqimet – Shëndeti dhe sëmundjet – Forca dhe lëvizja – Forca dhe baraspesha – Puna dhe energjia – Burimet e energjisë | <ul style="list-style-type: none"> – Proceset jetësore te bimët – Bioteknologjia – Bashkëveprimi gjallesë-mjedisi – Ndotja e mjedisit – Oksidet, bazat, acidet, kripërat – Reaksionet kimike – Ajri, oksigjeni, dyoksidi I karbonit – Njehsimet në kimi – Tretësirat ujore – Fortësia e ujit dhe trajtimi I tij – Elektrolitët, shpërbashkimi elektrolitik – Llojet e reaksioneve kimike – Reaksionet termokimike – Reaksionet redoks – Dukuritë elektrokimike – Njehsimet në kimi – Dukuri mekanike – Rrjedhësit – Kalorimetria – Gazet – Elektromagnetizmi – Vala dhe tingulli |
|--|--|

Modelet



- Drita
- Ndërtimi i molekulave të lëndës

- Ndërtimi i atomit dhe tabela periodike
- Motorët
- Gjeneratorët
- Transformatori
- Vala
- Optika gjeometrike

Shkallëzimi dhe matja

- Matjet, madhësitë fizike, kimike, biologjike, njësitet matëse të temave të mësipërme.

- Matjet, madhësitë fizike, kimike, biologjike, njësitet matëse të temave të mësipërme.

II. Aftësitë dhe shkathtësitë

- Formulimi i hipotezës
- Krijimi i mundësive
- Parashikimi
- Vrojtimi
- Përdorimi i aparateve dhe pajisjeve
- Krahasimi
- Klasifikimi
- Interpretimi
- Shpjegimi
- Analiza
- Vlerësimi
- Komunikimi

III. Qëndrimet dhe vlerat

- Kurioziteti
- Krijimtaria
- Integriteti
- Objektiviteti
- Mendjehapur
- Këmbëngulja
- Përgjegjshmëria

3.3.6 Ndarja e kohës

Plani mësimor specifikon peshën në përqindje të fushës së shkencave të natyrës në planin e



përgjithshëm mësimor si dhe numrin e orëve të planifikuara për secilën shkallë.

Fusha e të nxënit		
	Shkalla 3	Shkalla 4
	Klasa VI – VII	Klasa VIII – IX
Shkencat e natyrës (%) dhe orë	10.7%	19.3%
	6 orë	12 orë
Fizikë	3	4
Biologji	3	4
Kimi		4

3.3.7 Udhëzime metodologjike

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies në fushën e shkencave natyrore janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre.

Mësimdhënia dhe të nxënit, i bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesit e fushës së shkencave natyrore:

- të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve, që nënkupton përvojat individuale të tyre dhe, mbi këtë bazë, të mbështesin e orientojnë të nxënit e tyre;
- të nxisin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve, vëzhgimeve në natyrë dhe eksperimenteve;
- të nxisin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojnë nxënësit, duke i konsideruar si partnerë, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë komplementarë të njëri-tjetrit;
- të mbështesin të nxënit e pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;



- të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të shkencave natyrore, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore.
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës.
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënit.

Siguria

Mësuesit janë përgjegjës për sigurinë e nxënësve gjatë veprimtarive në klasë, për nxitjen dhe motivimin e tyre për rregullat dhe përgjegjësitë e sigurisë. Ata duhet të planifikojnë gjithmonë veprimtari praktike të sigurt dhe t'u tregojnë nxënësve kushtet e sigurisë në përputhje me ato të bordit të shkollës dhe politikave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Gjatë veprimtarive në fushën e shkencës, nxënësit zbatojnë gjithmonë dhe në mënyrë të ndërgjegjshmerregullat e sigurisë në shkollë, klasë dhe jashtë tyre; identifikojnë paraprakisht kushtet në të cilat veprimtaria mund të mos jetë e sigurt dhe tregojnë se si mund të parandalohen aksidentet në të gjitha rastet e mundshme; përdorin pajisjet, kimikatet dhe mjetet sipas udhëzimeve; tregojnë vazhdimisht shqetësim për sigurinë e tyre dhe të tjerëve.

3.3.8 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit të nxënësve në nivel klase dhe shkalle. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimittëkompetencave të fushës së shkencave të natyrës nga ana e nxënësve. Vlerësimi u shërben mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënit si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara. Ndërsa vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtasë llojin evlerësimit,qëllimit specifik të synuar.



Është thelbësore që vlerësimi të jetë pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. I gjithë procesi i të nxënit në shkencat e natyrës mbështetet në kërkimin shkencor, si i tillë edhe vlerësimi merr shumë forma.

Për vlerësimet me shkrim mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale që përfshijnë shkencën në jetën e përditshme, shoqëri dhe mjedis, si pikënisje për ndërtimin e pyetjeve në mënyrë që të pasqyrojnë zbatimin e njohurive shkencore në kontekste të jetës reale. Situatat e zgjedhura duhet të jenë domethënëse dhe tërheqëse. Përveç testeve me shkrim, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve duke përdorur mënyrat e mëposhtme si:

- punët praktike;
- modelet dhe maketet;
- punët laboratorike;
- posterat;
- projektet kurrikulare dhe ndërlëndore lojërat dhe kuicet;
- detyrat individuale;
- vrojtimit e mësuesit;
- loja me role;
- lista e kontrollit;
- esetë;
- portofoli.

Mësuesi mund të vlerësojë nxënësit përmes përdorimit të portofolit. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësve dhe siguron një tablo të plotë të arritjes së tyre. Puna e mbledhurafron të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve shkencore, zbatimin e shkathtësive të procesit, dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ajogjithashtu u afron nxënësve mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

Vlerësimi në bazë shkolle, si vlerësimi formues dhe vlerësimi përmbledhës duhet të përdoret për të siguruar një tablo të plotë të performancës dhe progresit të nxënësve si dhe efektivitetit të procesit të mësimdhënies dhe të nxënit.

3.3.9 Materiale dhe burime mësimore

Një rol të rëndësishëm në procesin e të nxënit në shkencat e natyrës zënë mjetet mësimore. Ato kanë funksione të ndryshme si: informimi, motivimi, konkretizimi, demonstrimi,



ilustrimi, plotësimi i të dhënave, shpjegimi i përmbajtjes mësimore, nxitja e aftësive të të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimi dhe përsosja e aftësive, racionalizimi i kohës, bashkëveprimi nxënës - mësues etj. Ato duhet të sigurohen dhe të zgjidhen në sasinë dhe cilësinë e duhur. Në planin mësimor ditor ato planifikohen për çdo temë, vetëm se mësuesi duhet të njohë mirë metodikën e demonstrimit dhe të aktivizimit të nxënësve nëpërmjet tyre. Që këto mjete të jenë sa më funksionale në orën e mësimi, *duhet të plotësojnë disa kërkesa metodike, shkencore, psikologjike, estetike, teknike dhe ekonomike.*

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

Mjetet pamore natyrore si: objektet natyrore të gjalla ose jo të gjalla, koleksionet.

Mjetet artificiale si: maketet, modelet, fotografitë, vizatimet, skemat, tabelat.

Mjetet audiovizive si: televizor, film, video, video-projektor, videokasetë, kompjuter, internet, teletekst, CD.

Mjetet dëgjimore: radio, magnetofon, telefon, kasetofon etj.

Mjetet verbale, tekstet si: tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, revistat, atlasat, (mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën kërkimore të nxënësve).

Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për shkencën. Plani duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre shkencore, si dhe në kryerjen e vizatimeve apo krijimeve të ndryshme.

Mjedisi mësimor si: (klasa, laborator, kabinetet e punës, natyra, ferma etj.)

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet e Web të shkencës dhe teknologjisë të rekomanduara nga mësuesi.
- Përdorimi i CD-ROM për ruajtjen e informacionit të dëshiruar.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm software.
- Paraqitja grafike e të dhënave.



3.4 Fusha e të nxënit: Shoqëria dhe mjedisi

3.4.1 Hyrje

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” u krijon nxënësve mundësitë të zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tyre si anëtarë të një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

Përmes kësaj fushe nxënësit zhvillojnë bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillojnë konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbatojnë këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë.

Nxënësit aftësohen të vlerësojnë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Në shkallën e tretë dhe të katërt, fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve të tilla si: histori, gjeografi, qytetari. Shkalla dhe format e integritimit ndryshojnë në varësi të niveleve moshore, tematikave dhe çështjeve të ndryshme.

Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni në këto shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

3.4.2 Qëllimet e fushës

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” synon që nxënësit:

- të aftësohen për t’u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimension lokal, kombëtar, rajonal, evropian e global, duke ndërtuar identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- të zhvillojnë vlerat themelore të qytetarisë si tolerancën, mirëkuptimin, të drejtat e njeriut dhe demokracinë;
- të zhvillojnë bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve



politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhet me to, përmes studimit të gjithë përvojës njerëzore;

- të aftësohen për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën, për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen dhe me perspektivat e së ardhmes, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të kuptojnë kompleksitetin e çështjes historike, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë përpikërinë e burimeve historike;
- të zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë ndërmjet aspekteve fizike dhe humaneve të rajoneve e vendeve në botë;
- të vlerësojnë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm;
- të zotërojnë shkathtësinë e kërkimit, interpretimit, organizimit të njohurive dhe të komunikimit të tyre në mënyra të ndryshme.

3.4.3 Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Tematikat e përbashkëta të fushës shërbejnë si instrument i fuqishëm integruar në funksion të zhvillimit të kompetencave të fushës. Ndonëse secila prej tyre përshkruhet veçmas, ato shpesh kanë elemente të ndërthurura në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Proceset shoqërore

Proceset shoqërore përfshijnë zhvillimet dhe ndryshimet ,që ndodhin në jetën shoqërore në mjedisin ku jeton, në nivel vendor, rajonal dhe global. Këto procese ndodhin në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë shoqërore (fusha ekonomike, politike, shoqërore, ligjore, kulturore etj.) dhe, në korrelacion me njëra-tjetrën, ndikojnë jetën tonë dhe të shoqërisë. Njohja e këtyre proceseve, e ligjshmërisë dhe e lidhjeve shkak-pasojë është domosdoshmëri për vendimmarrjet tona dhe për shkallën tonë të lirisë në këtë proces vendimmarrjeje.

Vetëm në këtë bazë, pjesëmarrja qytetare do të jetë e përgjegjshme, e vetëdijshme, aktive dhe e orientuar nga e ardhmja dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia



Duke studiuar të kaluarën dhe trashëgiminë e saj nxënësit kuptojnë konceptet kyçe historike si kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, lidhjet shkak- pasojë, shumëllojshmërinë kulturore etnike dhe fetare, rëndësinë dhe perspektivat, fillimisht nëpërmjet njohjes dhe kuptimit të historisë personale dhe familjare, historisë së shkollës, historisë zonës, rajonit, për t'u zgjeruar më pas në njohjen dhe kuptimin e historisë së vendit dhe atë të qytetërimeve botërore. Kuptimi i kronologjisë aftëson nxënësit të kuptojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak- pasojë. Nxënësit kuptojnë rolin e kohës në ndryshueshmërinë e njerëzve, shoqërisë dhe mjedisit, njohin disa nga ndryshimet më të rëndësishme, që kanë ndodhur, duke filluar nga elementët e jetës së përditshme e deri në ndryshimet shoqërore, ekonomike, kulturore që kanë formësuar botën.

Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve dhe mjediseve

Përmes kësaj tematike nxënësit zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, kuptojnë vendndodhjen e njerëzve, të vendeve, rajoneve dhe burimeve si dhe përshkruajnë arsyet e kësaj vendndodhjeje. Nxënësit eksplorojnë si kanë ndikuar dhe ndikojnë ngjarjet historike, faktorët fizikë dhe humanë në zhvillimin vendor, rajonal, kombëtar dhe global. Ato vëzhgojnë dhe debatojnë rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe propozojnë krahasojnë e vlerësojnë alternativat e përdorimit të burimeve natyrore në komunitete, rajone, kombe dhe në botë.

Individët, grupet, shoqëria

Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktuara institucionesh socializuese si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë.

Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme që kanë lidhje me jetën dhe bashkejetsën paqësore në shoqëri.

Kultura

Nxënësit kuptojnë si qëniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku dhe përshtaten ndaj



kulturës. Ata vlerësojnë rolin e kulturës në formimin e jetës dhe të shoqërisë, ku jetojnë, si dhe jetës dhe shoqërisë së të tjerëve dhe marrin vendime mbi bazën e njohurive për kulturën në faza të ndryshme të shkollimit të tyre në emër të respektimit të diversitetit kulturor dhe të bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve dhe kulturave.

Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi

Përmes kësaj tematike nxënësit fitojnë njohuri për mënyrën si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave dhe të shërbimeve dhe njihen e kuptojnë çështjet themelore që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike. Ata njihen, në përputhje me nivelin e shkollimit dhe të kurrikulës, me konceptet kryesore ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tyre dhe të shoqërisë. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe realizimi i kompetencës ekonomike, që nënkupton njohuri për funksionimin e botës ekonomike dhe aftësi për të vepruar me mençuri në këtë botë.

Pushteti, autoriteti, qeverisja

Përmes kësaj tematike, nxënësit fitojnë dije dhe ndërtojnë njohuri për rregullat e jetës kolektive e kushtet demokratike për zbatimin e tyre, si dhe për mundësitë që ekzistojnë në një shoqëri demokratike në të gjitha nivelet e jetës politike. Ata ndërtojnë njohuri për institucionet publike demokratike dhe për rregullat e lirisë dhe të vepruarit dhe ndërgjegjësohen për faktin se ndërtimi i institucioneve demokratike dhe gëzimi i këtyre lirive janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve.

3.4.4 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

Procesi i të nxënësve në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, në të gjitha shkallët, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare, si një ndër kompetencat kyçe si dhe në sasinë dhe cilësinë e duhur edhe të kompetencave të tjera.

Kjo kompetencë përbëhet nga dimensionet personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatitin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në jetën dhe punën shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, në shoqëritë gjithnjë e më të larmishme, për të zgjidhur konfliktet atje, atëherë dhe kur kjo është e nevojshme.



Kompetenca shoqërore dhe qytetare i përgatit individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore, ekonomike, politike etj. dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.

Nxënësi njih dhe pranon rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencave të qytetarisë për përgatitjen për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore dhe politike dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.

Nxënësi argumenton rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t'u solidarizuar në zgjidhjen e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë.

Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut.

Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen.

Nxënësi përdor konceptin e kohës dhe të hapësirës në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj.

Nxënësi zhvillo këndvështrimin e tij hapësiror për botën, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve, të vendeve si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje.

Nxënësi eksploron konceptet themelore gjeografike dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisin.

Nxënësi pranon rëndësinë që ka kompetenca kompetenca shoqërore dhe qytetare për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe European.

Nxënësi kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror. Ata njohin lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe veprojnë



për të realizuar atë.

Nxënësi njih konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj. me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. Ai kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë Europiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë European e më gjerë.

Nxënësi komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerë.

Nxënësi është i vetëdijshëm që kompetenca bazohet në ndjenjën e integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin. Ai pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor.

Ai vlerëson diversitetin, respekton të tjerët dhe përgatitet për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise.

Nxënësi zhvillon vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe European si dhe vetëdijen për diversitetin dhe indentitet kulturore në Europë.

3.4.5 Rezultatet e të nxënit

Në tabelën e mëposhtme, përshkruhen rezultatet e të nxënit, të cilat nxënësit duhet t'i arrijnë në mënyre progresive dhe të vazhdueshme, sipas secilës tematikë.

KSNA 2	
Shkalla 3 Klasa VI, VII	Shkalla 4 Klasa VIII, IX
1. Proceset shoqërore Nxënësi:	



- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan veçoritë e përbërësve të gjeosistemit, lidhjen dhe bashkëveprimin ndërmjet tyre dhe pasojat e këtij bashkëveprimi për tiparet fizike dhe humane të mjedisit në nivel lokal, rajonal e global. - Respekton ndërvarësinë shoqërore, politike, ekonomike e kulturore në shoqërinë globale, duke vlerësuar njëkohësisht trashëgiminë natyrore e kulturore të vendit të tyre. | <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon pasojat e proceseve fizike në modelet dhe sistemet e tokës dhe në mjedisin human, ndërveprimin e veprimtarisë njerëzore me mjedisin natyror, duke evidentuar lidhjet shkak-pasojë të këtij ndërveprimi në nivel lokal, rajonal e global. - Shpjegon lidhjet si brenda ashtu dhe ndër periudha e shoqëri të ndryshme, respekton origjinën historike dhe vlerëson dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë. |
|--|---|

2. Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia

Nxënësi:

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan dhe shpjegon jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre sipas linjës kronologjike. - Përdor saktë datat, termat dhe fjalorin kronologjik për ndërtimin dhe shpjegimin e ngjarjeve historike. - Analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve dhe ndryshimeve historike duke shpjeguar pasojat në përfundimin e ngjarjeve. | <ul style="list-style-type: none"> - Ndërton linjën e kohës duke vendosur në të periudhat dhe ngjarjet e rëndësishme historike. - Kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike. - Analizon jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre, duke përfshirë historinë e shqiptarëve, historinë europiane dhe atë botërore sipas linjës kronologjike. |
|--|--|

3. Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve dhe mjediseve

Nxënësi:



- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">- Përshkruan tiparet e mjediseve në nivel lokal dhe rajonal dhe lidhjet që ekzistojnë ndërmjet ndryshimeve në mjedis dhe zakoneve të banorëve që jetojnë në të.- Shpjegon ndikimin e ngjarjeve historike, faktorëve fizikë e njerëzorë në zhvillimin lokal, kombëtar dhe global.- Shpjegon si modelet e lëvizjes në botë (p.sh., njerëzve, prodhimit etj.) çojnë në ndërvarësinë midis vendeve e rajoneve.- Përdor prezantime të ndryshme të tokës (p.sh., hartat, globin etj.) për të mbledhur dhe krahasuar informacionin për vendet, rajonet. | <ul style="list-style-type: none">- Vlerëson kompleksitetin dhe ndërvarësinë ndërmjet rajoneve të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, rajoneve dhe vendeve të ndryshme të botës.- Përshkruan si kanë ndikuar dhe ndikojnë ngjarjet shoqërore dhe historike, faktorët fizikë dhe njerëzorë në zhvillimin vendor, kombëtar, rajonal dhe global.- Propozon zgjidhje të mundshme të situatave mjedisore në Shqipëri, rajon e më gjerë.- Interpretin informacionin e përftuar përmes prezantimeve të tokës në hartë, glob, imazhe satelitore etj. |
|---|--|

4. Pushteti, autoriteti, qeverisja

Nxënësi:

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">- Identifikon dhe përshkruan çështje që lidhen me të drejtat dhe rolin e individit në lidhje me mirëqënien e përgjithshme.- Dallon dhe përshkruan qëllime të qeverisjes.- Identifikon dhe përshkruan ide dhe mekanizma qeveritare që shërbejnë për të përmbushur nevojat dhe dëshirat e qytetarëve.- Identifikon dhe përshkruan <i>disa</i> tipare të sistemit politik në vendin tonë dhe arrin të identifikojë udhëheqësit përfaqësues nga nivele dhe degë të ndryshme të qeverisjes.- Dallon dhe përshkruan veprimet që ndihmojnë një bashkëpunim ose një | <ul style="list-style-type: none">- Shqyrton në mënyrë të vazhdueshme të drejtat, rolet dhe statusin e individit në lidhje me mirëqënien e përgjithshme.- Përshkruan dhe shpjegon qëllimin e qeverisjes dhe si është përdorur ai për të ruajtur, për të përdorur dhe justifikuar fuqitë e saj.- Analizon idetë dhe mekanizmat qeveritare për të përmbushur nevojat dhe dëshirat e qytetarëve, për të rregulluar territorin, për të menaxhuar konfliktet dhe për të vendosur rregull dhe siguri.- Përshkruan se si mënyrat e organizimit të kombeve i shërbejnë forcimit të unitetit dhe diversitetit, duke ndikuar në rregullin dhe sigurinë. |
|---|--|



- | | |
|---|--|
| <p>konflikt të caktuar brenda një vendi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan rolin e teknologjisë në komunikim, transport, procesin e informimit, si dhe zhvillimin në fusha të tjera që kontribuojnë për të zgjidhur konfliktet. - Përdor koncepte të tilla si fuqia, roli, statusi, drejtësia gjatë shqyrtimit të dukurive të ndryshme të komunitetit ku jetojnë. - Tregon me shembuj si qeveritë përpiqen të arrijnë idealet e deklaruara brenda dhe jashtë vendit. | <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon dhe analizon tiparet bazë të sistemit politik dhe të udhëheqësve përfaqësues në nivele dhe degë të ndryshme të qeverisjes. - Analizon dhe shpjegon kushtet, veprimet dhe motivet që ndihmojnë bashkëpunimet ose konfliktet brenda dhe ndërmjet kombeve. - Analizon rolin dhe pasojat që ka teknologjia në komunikim, transport, procesin e informimit, si dhe zhvillimin në fusha të tjera të jetës shoqërore. - Shpjegon dhe zbaton koncepte koncepte të tilla si fuqia, roli, statusi, drejtësia dhe ndikimi për shqyrtimin e çështjeve dhe problemeve sociale. - Shpjegon me shembuj si qeveritë përpiqen të arrijnë idealet e deklaruara brenda dhe jashtë vendit. |
|---|--|

5. Prodhimi, konsumi dhe shpërndarja

Nxënësi:



- Fillon të identifikojë karakteristikat sipërmarrëse, që ai zotëron, dallon aftësitë dhe njohuritë që duhen për të filluar një biznes dhe, duke analizuar modele aktuale sipërmarrësish, nxënësi identifikon bizneset që mund të fillojë.
- Krijon karta të profilit të sipërmarrësit.
- Bën zgjedhje për të kuptuar konceptin e njohjes së vetvetes - aftësitë, interesat, vlerat dhe strukturën e botës së punës, duke u bazuar në fushën e arsimit, të karrierës dhe zgjedhjeve të tjera të jetës.
- Shpjegon shkallën e njohjes së vetvetes - aftësitë, interesat dhe vlerat vetjake, mundësitë e karrierës dhe tregon si klasifikohen ato në botën e punës. Ai dallon lidhjen ndërmjet financave vetjake, arsimimit dhe mundësive të karrierës dhe zbaton vendimmarrjen për arsimim dhe karrierë.
- Tregon rëndësinë e një buxheti të barazuar për të gjithë punonjësit dhe rrugët për të barazuar buxhetin.
- Identifikon koston oportune duke e shoqëruar këtë me përdorimin e parave dhe të kartës së kreditit. Ai shpjegon përparësit në dhe mangësitë e përdorimit të kartës së kreditit dhe identifikon situatat e dhura për të përdorur paratë dhe kartën e kreditit.
- Përshkruan rezultatet e favorshme dhe të pafavorshme të shkallës së besueshmërisë vetjake në përdorimin e kartës së kreditit dhe shpjegon shkaqet pse shifrat në shkallën e besueshmërisë ngrihen dhe ulen. Ai arrin të dallojë rreziqet financiare dhe shpjegon se sigurimet janë një mënyrë për të pakësuar rreziqet, duke identifikuar koston oportune të pagesës së sigurimeve.

6. Individët, grupet, shoqëria

Nxënësi:



- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Demonstron të kuptuarit e koncepteve të tilla si: roli, statusi dhe klasa sociale në përshkrimin e ndërveprimit të individit me grupet sociale. - Tregon me shembuj ndikime të grupit dhe të institucioneve tek njerëzit, ngjarjet dhe elementet e kulturës. - Dallon forma të ndryshme të bashkëveprimit të institucioneve me njerëzit. - Identifikon dhe përshkruan shembuj konfliktesh ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe presionit të grupit. - Tregon si grupet dhe institucionet punojnë për të përmbushur nevojat individuale dhe për të nxitur të mirën e përgjithshme. | <ul style="list-style-type: none"> - Demonstron të kuptuarit e koncepteve të tilla si roli, statusi dhe klasa sociale në përshkrimin e ndërveprimit të individit me grupet sociale. - Analizon dhe shpjegon mënyrën si grupet dhe institucionet ndikojnë tek njerëzit, ngjarjet dhe elementet e kulturës. - Analizon format e ndryshme si institucionet marrin pjesë dhe bashkëveprojnë me njerëzit. - Identifikon dhe analizon shembuj tensionesh midis shprehjeve të individualitetit dhe grupit ose përpjekjeve institucionale për të vënë në lëvizje konformitetin social. - Identifikon dhe përshkruan shembuj të tensioneve midis sistemeve të besimit, ligjeve dhe politikave të qeverisjes. - Përshkruan rolin e institucioneve për të përshpejtuar ose ngadalësuar vazhdimësinë ose ndryshimin. - Zbaton njohuritë në lidhje me rolin që grupet dhe institucionet luajnë për të përmbushur nevojat individuale dhe të mirën e përgjithshme. |
|---|---|

7. Kultura

Nxënësi:



- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none">- Dallon dhe përshkruan mënyra të ndryshme të plotësimit të nevojave dhe interesave nga grupe, shoqëri dhe kultura të ndryshme .- Dallojnë dhe përshkruajnë se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë informacionet dhe përvojat.- Tregon me shembuj ndikime të gjuhës, të letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës.- Dallojnë dhe përshkruajnë shembuj të reagimit të ndryshëm të individëve ose grupeve të ndryshme ndaj mjediseve shoqërore ose fizike etj., mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre. | <ul style="list-style-type: none">- Dallon, krahason dhe shpjegon ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre.- Shpjegon pse njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë ndryshe informacionet dhe përvojat.- Shpjegon me shembuj si gjuha, letërsia, artet, traditat, bindjet, vlerat dhe sjelljet ndikojnë në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës.- Shpjegon pse individët dhe grupet reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre.- Përshkruan ndikimin dhe bashkëveprimin e diversitetit kulturor dhe të kohezionit social brenda dhe ndërmjet grupeve.- Zbaton konceptin e diversitetit kulturor në vendimmarrjet e tij në shoqëri |
|---|---|

Koncepte kyç

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none">- Koha- Kronologjia- Burime historike- Ndryshimi dhe vazhdimësia- Shkaku dhe pasoja, rëndësia- Këndvështrim- Diversitet kulturor, etnik, fetar, gjuhësor,- Epokë | <ul style="list-style-type: none">- Ligj- Të drejta themelore- Konventë- Përgjegjësi- Ndotje mjedisi- Burime natyrore- Varfëri- Demokraci- Karakteristika shoqërore e |
|---|---|



- Periudha historike
- Shtet
- Proces historik
- Ngjarje
- Vendndodhje
- Vendi
- Rajon
- Hapësira
- Mjedi natyror
- Mjedi human
- Ndërveprimi
- Lëvizja
- Zhvillim i qëndrueshëm

- individuale
- Institucion
- Vendimmarrje
- Partitë politike
- Zgjedhje
- Reklama
- Plan biznesi
- Konsumator
- Sipërmarrës
- Buxhet

Aftësitë dhe shkathtësitë



<ul style="list-style-type: none"> - Përdorim dhe interpretim i hartave, fotografive ajrore, imazheve satelitore. - Ndërtim dhe interpretim i grafikëve, diagramave, të dhënave statistikore. - Vëzhgime në terren - Krijim i modeleve - Përdorimi i burimeve historike - Kërkimi historik - Komunikimi për të kaluarën - Këndvështrimi dhe interpretimi - Përdorim i TIK-ut - Përdorimi i fjalorit historik, gjeografik 	<ul style="list-style-type: none"> - Aftësia e të menduarit kritik e krijues - Aftësia për të zgjidhur problemet - Aftësia për të vlerësuar - Aftësia për të transferuar dhe zbatuar njohuritë në një kontekst të caktuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Aftësia pjesëmarrëse - Aftësia komunikuese - Aftësia për të bashkëpunuar dhe punuar në grupe - Aftësia për të debatuar dhe për të arritur të bëjnë marrëveshje. - Aftësia ndërkulturore - Aftësia për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet - Aftësia për të ndërmjetësuar
--	---	---

Qëndrimet dhe vlerat

- Përkushtimi ndaj parimit të gjithësisë, të ndërvaresisë dhe të pandashmërisë së të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.
- Bindja për vlerën, dinjitetin dhe lirinë e individit.
- Përkushtimi ndaj shtetit të së drejtës, drejtësisë, barazisë dhe paanësisë.
- Përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore.
- Bindja për vlerën dhe domosdoshmërinë e parimeve, institucioneve dhe procedurave demokratike, si dhe për rëndësinë e veprimit qytetar.
- Respektimi i kulturave të tjera; pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme;
- Përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjykimeve dhe çdo forme të diskriminimit.
- Bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë personale.



- Përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysht ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.
- Prirja për të qenë anëtar i pavarur i shoqërisë,
- Prirja për të respektuar vlerat individuale dhe dinjitetin njerëzor.
- Prirja për të marrë përsipër përgjegjësitë personale, politike dhe ekonomike të qytetarit.
- Prirja për t'iu bindur “rregullave të lojës” së demokracisë, si pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve.
- Prirja për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme.
- Prirja për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

3.4.6 Ndarja e kohës

Plani mësimorspecifikon peshën në përqindje të fushës “Shoqëria dhe mjedisi” në planin e përgjithshëm mësimor si dhe numrin e orëve të planifikuar për secilën shkallë.

Fusha e të nxënit		
	Shkalla 3	Shkalla 4
	Klasat VI – VII	Klasat VIII – IX
Shoqëria dhe mjedisi (% dhe në orë)	14.3%	16.1%
	8 orë	10 orë
Qytetari	2	2
Histori	3	4
Gjeografi	3	4

3.4.7 Udhëzime metodologjike

Metodologjia e zbatimit të kurrikulës bërthamë luan rol thelbësor për përmbushjen e qëllimeve të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”. Të nxënit përmes kësaj fushe mund të realizohet vetëm me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve, në mënyrë që ata të kuptojnë, të brendësojnë, të vlerësojnë e të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar mbi të njohuri,



aftësi, shkathtësi e qëndrime të reja në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen.

Mësuesi angazhon nxënësit në një proces në të cilin ata parashtrojnë pyetje dhe formulojnë përgjigje, inkurajon frymën e mendimit krijues dhe kritik duke nxitur diskutimin ndërmjet tyre, duke inkurajuar pavarësinë e nxënësve, iniciativën e tyre, ndërveprimin. Në këtë qasje mësuesi nxit shpirtin udhëheqës të nxënësve, bashkëpunimin, tolerancën, vetëbesimin dhe shpirtin sipërmarrës të cilat reflektohen në rezultatet e të nxënit.

Mësimdhënia e bazuar në kompetenca kërkon që mësuesit të përzgjedhin strategji, metoda, teknika dhe forma të ndryshme të punës me nxënës, si dhe të organizojnë përvojat mësimore të nxënësve që integrojnë njohuritë përkatëse me shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet. Disa nga metodat, teknikat dhe strategjitë e sugjeruara në këtë fushë janë:

- diskutimet;
- debati;
- vrojtimit;
- intervistat;
- ekskursionet;
- vizitat në muze ose vendngjarje historike;
- konkurset;
- projektet kurrikulare dhe ndërkurrikulare.;
- etj.

3.4.8 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit në nivel klasedheshkalle. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësve, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësit të kompetencave të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”.

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale që përfshijnë shoqërinë dhe mjedisin si pikënisje për vlerësimin e nxënësve.

Format e ndryshme të vlerësimit duhet t’u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.



Mësuesi mund të vlerësojë nxënësit përmes përdorimit të portofolit. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësve dhe siguron një tablo të plotë të arritjes së tyre. Puna e mbledhur afon të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimineshkathtësive dhe zhvillimin eqëndrimeve. Ajogjithashtu u afon nxënësve mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

3.4.9 Materialet dhe burimet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësit. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.



3.5 Fusha e të nxënit: Arte

3.5.1 Hyrje

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës dhe pjesë integrale e jetës sonë të përditshme, ku në të përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, në të cilën ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Artet dhe studimi i tyre zhvillon njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: art pamor, muzikë dhe dramë të cilat lidhen ngushtë dhe ndihmojnë në zhvillimin intelektual, emocional, social dhe kulturor të nxënësve.

Artet zhvillojnë forma të ndryshme të inteligjencës dhe mundësojnë të kuptuarit dhe interpretimin e realitetit duke e shndërruar atë në gjuhë simbolike.

Nëpërmjet ndjeshmërisë, subjektivitetit dhe krijimit, praktikat në art mundësojnë për t'ju dhënë kuptim ideve, për të komunikuar nëpërmjet krijimeve artistike. Gjuha artistike dhe veprat e artit, të veshura me vlera sociale dhe kulturore të jetës së përditshme, kontribuojnë në zhvillimin e këtyre vlerave dhe pasqyrojnë historinë dhe shoqërinë njerëzore. Gjithashtu arti luan një rol të rëndësishëm në shprehjen dhe ruajtjen e vlerave kulturore të shoqërisë dhe në zhvillimin, afirmimin dhe ruajtjen e identitetin kulturor.

Objekti i studimit të fushës së arteve në këtë nivel është përdorimi i mjeteve shprehëse fjalës, tingujve, ngjyrave, formave, fjalës, veprimit, emocionit dhe shpjegimi i gjuhës artistike muzikore, pamore dhe dramatike gjatë procesit krijues në shkollë dhe jashtë saj. Zbatimi i tyre do të bëhet nëpërmjet krijimit, analizës dhe vlerësimit të proceseve artistike apo edhe veprimeve të ndërsjella, përmes situatave konkrete të cilat nxitin të mësuarit konkret të arteve.

Artet përfshijnë artin pamor, muzikën dhe dramën si lëndë të detyrueshme në **shkallën 3** dhe në **shkallën 4**.

Kurrikula bërthamë e arteve **në shkallën e tretë** dhe **katërt**, fokusohet në zgjerimin e njohurive artistike dhe zhvillimin e tyre në përdorimin dhe zbatimin e gjuhës artistike. Ata fillojnë të krijojnë dhe performojnë/realizojnë në mënyrë më sistematike, dhe vlerësojnë artet duke krijuar gjykime dhe qëndrime të qarta në klasë, përmes punëve të artit dhe vlerësimit të



veprave artistike, zhvillimit të tyre historik, duke krijuar kompetenca të qëndrueshme dhe të zbatueshme në këto disiplina artistike.

3.5.2 Qëllimi i fushës

Artet janë konceptuar në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Fusha e arteve ndihmon në krijimin e identitetit dhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve. Ajo gjithashtu ndihmon për të ngushtuar hendekun në mes të mësimin akademik dhe botës së punës. Njohuritë e qëndrueshme artistike, të marra në fushën e arteve mund t'i hapin rrugën studimeve të mëtejshme që kanë lidhje me profesione dhe mundësi punësimi në fushën e arteve dhe kulturës. Fusha e arteve mundëson zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, nëpërmjet trajtimit të elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare, me të cilat përfaqësohet kombi ynë brenda vendit dhe më gjerë, si pjesë integrale e të nxënësve në art.

Fusha e arteve synon:

- zgjerimin e njohurive dhe koncepteve artistike në arte;
- krijimin e kompetencave artistike për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme artistike;
- aftësimin e nxënësve për të vlerësuar vepra të artit shqiptar dhe atij botëror, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike;
- formimin e aftësive artistike, të menduarit kritik dhe krijues;
- zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve;
- përfshirjen dhe bashkëpunimin në veprimtari artistike tradicionale, duke manifestuar vlerat e artit kombëtar si pjesë e pandashme e vlerave të artit botëror;
- ndërveprimin në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike;
- kontribuimin personal në zhvillimet artistike – kulturore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

3.5.3 Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Fusha e arteve në shkallën e tretë dhe të katërt të arsimit të mesëm të ulët, kërkon të përmbushë disa aspekte themelore të të nxënësve, dhe zhvillohet përmes disa tematikave. Ato shërbejnë si instrument i fuqishëm integruar në funksion të zhvillimit të kompetencave të fushës.



Në shkallën e tretë dhe të katërt zhvillohen tematikat *gjuha dhe komunikimi artistik, teknika dhe procese artistike dhe historia, kultura dhe shoqëria*. Secila prej tyre përshkruhet veçmas gjatë hartimit dhe zbatimit të programeve për zhvillimin e kompetencave, ndërsa në kurrikulën bërthamë ato kanë elemente të përbashkëta.

Ato janë:

- a) Gjuha dhe komunikimi artistik.
- b) Teknika dhe procese artistike.
- c) Historia, kultura dhe shoqëria.

a) Gjuha dhe komunikimi artistik

Nxënësit i krijojnë mundësi të:

- përdorë dhe zbaton konceptet artistike (art pamor, muzikë dhe dramë), në funksion të proceseve artistike, duke realizuar punë të ndryshme artistike;
- analizojë krijimet e veta dhe të tjerëve në (art pamor, muzikë dhe dramë), duke komunikuar përmes një gjuhe artistike;
- prezantojë idetë artistike personale duke i komunikuar lirshëm ato;
- përjetojë vepra të ndryshme artistike, duke komunikuar ide dhe qëndrime personale;
- reflektojë dhe vlerësojë veprimtaritë artistike, duke u shprehur përmes formave të ndryshme të shprehjes artistike.
- komunikojë ide dhe emocione, duke përdorur gjuhën artistike përkatëse në artin pamor, muzikë dhe dramë, në procese të ndryshme krijuese dhe performuese;
- shpjegon qëndrimin e vet, lirshëm dhe pavarur;
- shprehë para shokëve apo të tjerëve përjetimet dhe emocionet e përjetuara gjatë shikimit të një filmi, performimit/realizimit të një dramatizimi, kënge apo një vizatimi.

b) Teknika dhe procese artistike

Nxënësit i krijojnë mundësi të:

- zbatojë teknika dhe procese të ndryshme artistike në artin pamor, muzikë dhe dramë;
- përdorë në mënyrë të vetëdijshme gjuhën artistike nëpërmjet mjeteve shprehëse të arteve si: fjalët, tingujt, ngjyrat, format, lëvizjet etj;
- krijojë duke përdorur mjete dhe teknika të ndryshme artistike, për të zhvilluar ide personale dhe origjinale;



- krijojë punë artistike, bazuar në elemente, procese dhe teknika artistikë apo materialeve të dhëna;
- përdorë teknika dhe procese artistike të artit pamor, muzikës dhe dramës, për të prezantuar në mënyrë artistike temat/projektet që i interesojnë;
- reflektojë dhe vlerësojë aktivitetet personale dhe të tjerëve, duke u shprehur përmes formave të ndryshme artistike
- përdorë mediat, si mjete të rëndësishme të informimit, të komunikimit dhe të ndërveprimit në epokën digjitale, për tu prezantuar në mënyrë artistike, lirshëm dhe të pavarur.

c) Historia, kultura dhe shoqëria

Nxënësit i krijojnë mundësi të:

- përjetojnë veprat e ndryshme artistike;
- kuptojë zhvillimin, rolin dhe ndikimin e artit në shoqëri;
- njohë vepra dhe autorë të arteve në kontekste të ndryshme sociale, politike dhe kulturore;
- vlerësojë rolin e ndërveprimit të arteve në kontekste të ndryshme historike, shoqërore, kulturore etj;
- identifikojë dhe promovojë vlerat e trashëgimisë kulturore (familjare, të komunitetit, kombëtare dhe më tej);
- respektojnë vlerat e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe më gjerë.

3.5.4 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

I gjithë procesi i të nxënësve në fushën e arteve, në të gjitha shkallët, zhvillohet përmes kompetencave të kësaj fushe **krijimit, performimit/realizimit dhe vlerësimit**. Në të gjitha shkallët e kurrikulës, ato zhvillohen dhe plotësohen më tej me kompetencat specifike lëndore brenda fushës. Kompetencat e fushës së arteve lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me kompetencat kyçe. Këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me tematikat e fushës dhe zhvillohen nëpërmjet tyre. Kompetencat që përbëjnë fushën e arteve për të gjitha lëndët art pamor, muzikë, dramë dhe kërcim janë:

Kompetenca 1: Krijimi artistik

- Përdorin ide të ndryshme për të krijuar një vepër artistike (muzikore, pamore,



koreografike apo dramatike).

- Përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike.
- Eksperimentojnë duke zhvilluar më tej idetë e veta artistike.
- Organizojnë krijimin e vet artistik, sipas elementeve të gjuhës artistikë.
- Ndajnë përvojat e veta krijuese me të tjerët.

Kompetenca 2: Performimi/realizimi artistik

- Interpretojnë/realizojnë përmbajtje të ndryshme nga tematika apo vepra artistike.
- Zbatojnë teknika dhe procese të ndryshme artistike.
- Respektojnë rregullat e performimit/interpretimi/realizimit artistik.
- Ndajnë përvojat e veta performuese/realizuese të veprave artistike me të tjerë.
- Analizojnë punën e interpretuar/realizuar në mënyrë artistike.

Kompetenca 3: Vlerësimi artistik

- Analizojnë veprat artistike të performuara/realizuara.
- Shpjegojnë kuptimin veprave të realizuara/performuara.
- Bëjnë një gjykim kritik dhe estetik.
- Vlerësojnë përvojat e veta dhe të të tjerëve për veprat artistike.

Në shkallën *e tretë dhe të katërt* zhvillohen të njëjtat kompetenca të cilat ndërthuren në mënyrë të harmonishme me njëra- tjetrën, duke plotësuar qëllimet e edukimit jo vetëm për artet, por edhe më gjerë. Kompetencat e arteve, edhe në këtë shkallë, zhvillojnë aftësitë krijuese, interpretuese dhe vlerësuese. Nëpërmjet një përvoje sistematike të punës artistike, gjatë ciklit fillor, nxënësit janë bërë më të vetëdijshëm për potencialin e tyre krijues përmes përdorimit të gjuhëve artistike. Nëpërmjet kontaktit me veprat e artit që ofrojnë shumëllojshmëri modelesh shprehëse dhe komunikimi, nxënësit janë aftësuar në vlerësimin e pasurisë së madhe të gjuhëve të ndryshme artistike, në eksplorimin e mjedisit të tyre kulturor dhe në përgatiten për zbulimin e kulturave të tjera.

Nxënësit, në shkallën *e tretë dhe të katërt* krijojnë, performojnë/realizojnë dhe vlerësojnë vepra arti, nëpërmjet kombinimit të perceptimeve, intuitës, përshtypjeve dhe njohurive të ndryshme. Ata reflektojnë, komunikojnë dhe përdorin informacione nga burime të ndryshme. Nxënësit inkurajohen të zhvillojnë aftësitë e tyre kritike dhe estetike dhe të hapin horizontin e tyre kulturor nëpërmjet njohjes së veprave të artit të artistëve të periudhave dhe origjinave të ndryshme.



Edukimi artistik duhet të përfshijë mundësinë e integritit të teknologjisë në procesin mësimor duke e konsideruar atë si një mjet të ri të fuqishëm shprehës, frymëzimi dhe komunikimi.

3.5.5 Rezultatet e të nxënit

Rezultatet e të nxënit në fushën e kurrikulës së arteve zhvillojnë tri kompetencat kyçe të fushës përmes këtyre tematikave:

1. Gjuha dhe komunikimi artistik.
2. Teknika dhe procese artistike.
3. Historia, kultura dhe shoqëria.
4. ¹
5. ¹

KSNA 2	
Shkalla e tretë Klasa përgatitore, VI, VII	Shkalla e katërt Klasa VIII, IX
Rezultatet në fund të klasës së shtatë	Rezultatet në fund të klasës së nëntë
1. Krijimi i veprave artistike¹	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - Krijon duke shprehur përjetimin, ndjenjat dhe idetë personale; - Interpreton këngë, luan në instrumente muzikore dhe ritmizon modele ritmike, nga 	<ul style="list-style-type: none"> - Krijon në mënyrë origjinale dhe shquhet për aft si performuese (interpretuese) individuale dhe në grup; - k ndon dhe interpreton k ng dhe melodi të ndryshme individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga gjini të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë); - krijon vepra dy dhe tri dimensionale, në mënyrë të lirshme ose mbi një temë të caktuar; - krijon duke përdorur mjetet e ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat

¹Me fjalën vepra artistike (muzikore, figurative, apo dramatike) do të kuptojmë të gjitha punët që krijojnë, realizojnë dhe vlerësojnë nxënësit në klasë, apo punët e artistëve të ndryshëm.



<p>kohë të thjeshta;</p> <ul style="list-style-type: none">- krijon vepra dy dhe tri dimensionale, në mënyrë të lirshme në tema të caktuara;- improvizon në mënyrë krijuese mbi melodie ritm e t njohura m par ;- krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve;- krijon duke u mbështetur në ide artistike origjinale, nëpërmjet përdorimit të mjeteve shprehëse të larmishme artistike në muzikë, dramë dhe art pamor;- merr pjesë në aktivitetet artistike sipas prirjeve, mundësive dhe interesave të veta.	<p>dhe idetë personale në muzikë dhe art pamor;</p> <ul style="list-style-type: none">- krijon dhe kontribuon në realizimin skenik të shfaqjeve të ndryshme si mjuzikëll, ose një kolazhi muzikor;- interpreton individualisht ose në grup, në aktivitetet artistike të shkollës, komunitetit dhe më gjerë sipas prirjeve, mundësive dhe interesave të tyre.
--	---

2. Performimi/realizimi i veprave artistike

Nxënësi:

<ul style="list-style-type: none">- përdor teknikat artistike për të performuar/realizuar një punë të vetën në arte;- zbaton teknikat	<ul style="list-style-type: none">- përdor teknikat dhe proceset e arteve gjatë krijimit të një melodie apo krijimit të punëve dy dhe tri dimensionale;- zotëron teknikat dhe proceset gjatë krijimit vetëm dhe në grup, në muzikë dhe art pamor;- performon/interpreton një apo më shumë veprimtari
--	--



<p>dhe proceset artistike gjatë performimit/realizimit, në muzikë, dramë dhe art pamor;</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstron aftësi si performuese (interpretuese) në një apo më shumë veprimtari artistike; - realizon vepra dy dhe tri dimensionale dhe demonstron aftësi si në një veprimtari artistike. 	<p>artistike;</p> <ul style="list-style-type: none"> - realizon vepra dy dhe tri dimensionale dhe demonstron aftësi si në një veprimtari artistike; - performon me instrumente muzikore në kohë të ndryshme; - interpreton në muzikë; - përdor media dhe teknologji të ndryshme për të paraqitur veprimtari artistike personale ose në grup.
--	--

3. Vlerësimi i veprave artistike

Nxënësi:

<ul style="list-style-type: none"> - vlerëson në mënyrë kritike punët artistike të vetat dhe të tjerëve në muzikë dhe art pamor; - reagon emocionalisht ndaj një veprë artistike muzikore, dramatike apo pamore; - vlerëson një vepër artistike përmes përjetimit, vëzhgimit, dëgjimit dhe interpretimit artistik; 	<ul style="list-style-type: none"> - vlerëson dhe prezanton në mënyrë kritike punët artistike në muzikë dhe art pamor; - vlerëson të bukurën në një vepër muzikore apo figurative, duke u shprehur përmes të kësaj shprehjeje (esesë), poezisë etj.; - vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar formën, elementet artistike dhe teknikat në funksion të shprehjes artistike; - vlerëson dhe prezanton në mënyrë individuale apo në grup, vepra artistike në muzikë dhe art pamor, duke përdorur media dhe teknologji të ndryshme; - vlerëson punën e vet apo të shokut duke analizuar në mënyrë kritike dhe përdorur një fjalor të thjeshtë artistik gjatë vlerësimit;
---	--



- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - çmon të bukurën punët artistike individuale dhe të të tjer ve, në muzikë, dramë dhe art pamor, duke u shprehur me fjalët e veta; - vlerëson punën e vet apo të shokut duke përdorur një fjalor të thjeshtë artistik gjatë analizës; - prezanton punën e vet në veprimtaritë artistike në klasë apo në ato publike (koncert, shfaqje dramatike, ekspozitë) duke përdorur mjetet dixhitale. | <ul style="list-style-type: none"> - prezanton punët e veta artistike, prezanton veten me sukses dhe vetëbesim në aktivitetet e ndryshme artistike individuale ose grupore në shkollë, komunitet dhe më gjerë. |
|---|---|

Njohuritë dhe konceptet kryesore

Gjuha dhe komunikimi artistik

Elemente dhe koncepte & parime artistike

- | | | |
|---------------|----------------|-----------------------|
| - Tingulli | - Melodia | - Kontrasti |
| - Ritmi | - Sipërfaqja | - Përsëritja |
| - Dinamika | - Vëllimi | - Ndryshimi |
| - Vija | - Ngjyra | - Krahasimi |
| - Forma | - Roli | - Theksi |
| - Karakteri | - Zëri | - Ekuilibri |
| - Trupi | - Fjala | - Uniteti |
| - Objekti | - Dritat | - Harmonia |
| - Perspektiva | - Lëvizja | - Zhvillimi |
| - Hapësira | - Drejtpeshimi | - Sensi kompozicionit |
| - Energjia | - Koha | - Sensi i tërësisë |
| | - Veprimi | - Sensi i stilit |



Teknika dhe procese artistike

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Teknika vokale - Teknika instrumentale - Teknika akuarelit - Teknika e vizatimit - Teknika e gdhendjes - Teknika e ngrohjes - Teknika e shkontraktimit - Teknika e kujtesës | <ul style="list-style-type: none"> - Këndimi - Krijimi - Dëgjimi - Interpretimi/performimi - Luajtja në instrument - Këndimi - Interpretimi - Loja muzikore/dramatike - Vizatimi - Ngjyrosja - Modelimi - Skeçi - Dialogu - Monologu - Hapa - Përjetimi emocional - Veprimi me anë të fjalës - Aktrimi - Sikuri - Veprimi fizik dhe psikik - Imitimi - Fotografimi - Modelimi - Gdhendja - Kolazhi - Kompozimi - Gjinitë dhe llojet artistike. |
|--|---|

Veprimtari artistike



- Lojëra teatrale
- Dramatizim (lojë teatrale)
- Kor
- Ekspozitë
- Shfaqje
- Koncert

Historia, kultura dhe shoqëria²

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">- Notat- Pentagrami- Ritmet e thjeshta- Ritmet e përbëra- Ritmet e përziera- Format muzikore- Këngët popullore- Vallet popullore- Trashëgimi- Isopolifonia- Format muzikore | <ul style="list-style-type: none">- Gjinitë artistike (opera, baleti, portreti, pejzashi, kompozimi etj.)- Veprimtari dhe institucione kulturore (opera, galeri, muze etj.)- Eksperienca artistike (takime dhe biseda me artistë, muzikantë, artizanë, dizajn etj.)- Profesione që lidhen me karriera të ndryshme artistike- Vepra arti dhe veprimtari artistike (riprodhime, fotografi, filma etj.)- Zhvillimi i arteve në periudha të ndryshme nga lashtësia deri në ditët tona |
|---|--|

Aftësitë dhe shkathtësitë

- Dëgjimi muzikor dhe perceptimi pamor.
- Përjetimi artistik.
- Zhvillimi i vëmendjes dhe i kujtesës artistike.
- Vullneti dhe motivimi.
- Iniciativa dhe interesimi.
- Imagjinata dhe krijueshmëria.
- Ndjenja për të vëzhguar dhe dalluar ritmin dhe harmoninë (tingujt, ngjyrat, format, strukturat, karakteret, lëvizjet, etj.)
- Shkathtësitë muzikore.
- Shkathtësitë lëvizore.

²Deri në shkallën e tretë nxënësit duhet të dëgjojnë/shikojnë/vëzhgojnë fragmente të 20-25 veprave artistike, muzikore dhe pamore më pak dramatike. Në fund të shkallës së tretë nxënësit duhet të shikojnë/dëgjojnë/vëzhgojnë fragmente të 30 veprave artistike, muzikore dhe pamore.



- Shkathësitë shprehëse figurative.
- Komunikimi dhe të shprehurit.
- Shkathësia për punë në grup (kori, vallet, muralet etj).
- Të menduarit analitik, kritik dhe krijues.

Qëndrimet dhe vlerat

- Kurioziteti.
- Dëshira për tu shprehur artistikisht.
- Vetëbesimi.
- Dëshira për shprehje dhe komunikim në mënyrë të pavarur.
- Pjesëmarrja aktive vetëm dhe në grup.
- Shoqërimi.
- Këmbëngulja.
- Bashkëpunimi.
- Diversiteti dhe kuptimi i kulturave të ndryshme.
- Respekti për veten dhe të tjerët.
- Qëndrimi ndaj artit dhe konceptit të të bukurës në art.
- Respektimi i trashëgimisë kulturore kombëtare dhe trashëgimisë së kulturave të tjera.
- Respekti ndaj kulturave të ndryshme.
- Bashkëpunimi dhe përgjegjësia.
- Përqendrimi dhe durimi.

3.5.6 Ndarja e kohës

Sipas Kornizës së kurrikulës së Shqipërisë, në planin mësimor për nivelin e dytë, fusha e kurrikulës së arteve, do të zhvillohen gjithsej 9 orë mësimore.

Në shkallën e tretë të kurrikulës, artet zhvillohen në klasën gjashtë dhe të shtatë. Janë gjithsej 2 orë mësimore në javë të planifikuara për kurrikulën e arteve, gjithsej 5 orë në këtë shkallë.

Në klasën e gjashtë zhvillohen këto lëndë:

- muzikë 1 orë



- art pamor 1 orë
- dramë 1 orë

ndërsa në klasën e shtatë zhvillohen këto lëndë:

- muzikë 1 orë
- art pamor 1 orë

Në shkallën e katërt të kurrikulës, artet zhvillohen në klasë e tetë dhe të nëntë. Janë gjithsej 2 orë mësimore në javë të planifikuara për secilën lëndë në kurrikulën e arteve, gjithsej 4 orë në këtë shkallë. Ato zhvillohen si më poshtë:

Në klasën e tetë zhvillohen këto lëndë:

- muzikë 1 orë
- art pamor 1 orë

Në klasën nëntë zhvillohen këto lëndë:

- muzikë 1 orë
- art pamor 1 orë

Fusha e të nxënit		
	Shkalla 3	Shkalla 4
	Klasa VI – VII	Klasa VIII – IX
Arte (%)	8.9%	6.5%
Muzikë (orë mësimore/javë)	2	2
Art pamor (orë mësimore/javë)	2	2
Dramë (orë mësimore/javë)	1	-

3.5.7 Udhëzime metodologjike

Procesi i mëimit të arteve në këtë nivel zhvillohet në baza njohjeje për të gjitha lëndët brenda fushës së arteve nga nxënësit. Cilësia e mësimdhënies është çelësi për suksesin e nxënësve në mësimin e arteve. Mësuesit duhet të inkurajojnë çdo nxënë të besojë se do të jetë i suksesshëm në mësimin e muzikës, artit pamor apo dramës, duke kuptuar shumë mirë interesat e tyre dhe nevojat që ata kanë. Ata ndihmojnë nxënësit të aktivizojnë njohuritë e



mëparshme, t'i rendisin dhe përdorin ato, duke diferencuar udhëzimet për nxënës me nevoja të veçanta. Po kështu mësuesit duhet të stimulojnë dhe inkurajojnë të gjithë nxënësit, duke krijuar mjedise ku nxënësit të kenë mundësi për të performuar/interpretuar/krijuar nëpërmjet arteve.

Gjatë procesit të mësimdhënies, mësuesit duhet të sigurojnë një shumëllojshmëri aktivitete të bazuara në vlerësimin e nevojave individuale të nxënësve, në nevojat e grupit dhe në praktikën më të mira mësimore. Gjithashtu, mësuesit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë për zhvillimin e veprimtarive të artit pamor, dramës dhe muzikës.

Improvizimi përdoret edhe për të mbërritur në dramatizimin e ngjarjeve që rezultojnë drejtpërsëdrejti nga përvoja personale e secilit pjesëmarrës e më tej në përpunimin e saj, në përballjen me përvojat e të tjerëve, si dhe në dramatizime të mbështetura në materiale letrare, tregime, përralla, poezi, folklor ose legjenda.

Nxënësit vendosen në situata konkrete praktike muzikore dhe dramatike në të cilat përjetojnë dhe provojnë vetë të krijojnë dhe interpretojnë artistikisht vetëm dhe në grupe. Mësimdhënia e arteve, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike, tashmë e vetëdijshme për ata, ku çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore muzikore, figurative dhe dramatike është e pëlqyeshme dhe krijon emocione. Është shumë e rëndësishme kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie artistike në mënyrë të vetëdijshme, gjë që u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte.

Disa komponentë shumë të rëndësishëm, që ndihmojnë në formimin e kulturës artistike të nxënësve dhe që duhet të merren parasysh nga mësuesit gjatë punës së tyre, janë:

Arti, si komponent i edukimit estetik.

Si e tillë, fusha e arteve ndihmon në edukimin estetik, sepse edukon shijet, zhvillon ndjesinë për të vëzhguar dhe dalluar të bukurën në art.

Arti, si komponent i formimit edukativ dhe social.

Nëpërmjet veprimtarive të përbashkëta, siç janë: të kënduarit në grup, loja në instrument, interpretimi etj., nxënësit koordinojnë veprimet me njëri-tjetrin, duke krijuar kështu raporte shoqërore. Në këtë mënyrë ata fillojnë të gërshetojnë punën dhe përgjegjësinë personale me punën në grup atë që është e përbashkët, p.sh.: kori zhvillon rregullin, ku veprimtaria e çdo nxënësi (këndimi) zhvillohet me kërkesat e të bërit muzikë në mënyrë të përbashkët, apo vënia e një tregimi/përrallë në skenë, aktivitet i cili bëhet i pëlqyeshëm kur të gjithë nxënësit bashkëveprojnë në harmoni me njëri-tjetrin.



Arti si komponent i proceseve psikologjike.

Nëpërmjet përjetimit dhe njohjes me artet, në mënyrë të vetëdijshme nxiten një sërë procesesh psikike. Format e ndryshme të punës në disiplinat artistike për këtë grupmoshë, zhvillojnë vëmendjen tek *ritmi, melodia, ngjyrat, format, lëvizjet, fjala, gjesti* etj., herë veç e veç dhe herë të gjitha së bashku.

Nxitja dhe të shprehurit, përmes *krijimeve* të ndryshme në arte, zhvillon imagjinatën tek ata p.sh: *dëgjimi i muzikës* i bën fëmijët më të ndjeshëm dhe më të drejtpërdrejtë në përjetimin e pjesëve muzikore, i jep kuptimin e së bukurës muzikore. Ose *riprodhimi* i një tregimi i fut ata në botën e personazhit etj.

Arti si komponent i zhvillimit fizik.

Artet nxitin jo vetëm proceset psikike por njëkohësisht edhe proceset fizike, sepse ato janë të ndërlidhura dhe të kushtëzuara. P.sh.: muzika ndikon në gjithë qenien fizike të njeriut përmes *lëvizjeve, frymëmarrjes dhe qarkullimit të gjakut*. Këndimi zhvillon aparatën e këndimit dhe të gjitha organet marrin pjesë njëkohësisht gjatë të kënduarit dhe funksionojnë në mënyrë të sinkronizuar. Kërcimi dhe lidhjet e saj me muzikën përmes *lëvizjeve* përmes harmonizimit të ritmit ose kombinimi i tyre me muzikën i bëjnë lëvizjet më të gjalla, të organizuara, plastike, emocionale.

3.5.8 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në kurrikulën e arteve, ndryshe nga lëndët e tjera, mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirje të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale në forma të ndryshme të artit. *Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi* i punëve artistike janë forma të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësve dhe objekt i vlerësimit janë krijimi i kompetencave artistike të nxënësve në fushën e arteve përmes krijimit, performimit/realizimit dhe vlerësimit. Arritjet në fushën e arteve janë më shumë individuale prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla.



Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes të kënduarit, të aktrimit të një pjese tekstuale letrare, të dëgjuarit muzikor apo letrar i një vepre, të krijuarit e punëve dy dhe tre dimensionale, të analizuarit të pjesëve artistike etj.

P.sh:mësuesit zhvillojnë vetë një larmi mënyrash vlerësimi në dramë, si :

- përdorin fjalë e shprehje inkurajuese gjatë punës me interpretimin e këngës/dramës;
- vlerësojnë një nxënës duke i besuar rolin kryesor/ose solistin, vlerësim që e detyron më shumë nxënësin dhe i jep më shumë përgjegjësi;
- shpallin interpretuesin/krijuesin më të mirë (në art pamor, dramë dhe muzikë);
- vlerësojnë pjesëmarrjen dhe aktivizimin në veprimtaritë e ndryshme artistike-kulturore.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet në punët konkrete, si: përvetësimi i elementeve artistike, aftësitë bashkëpunuese dhe prurjet krijuese-improvizuese, pjesëmarrja në veprimtaritë artistike në komunitet, pasioni, vlerësimi dhe përkushtimi ndaj arteve, etj.

Portofoli i nxënësit, është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në arte. Ai mund të përmbajë krijime, detyra tematike (ese), organizime dhe projekte kurrikulare, prodhime të ndryshme të CD-ve e DVD-ve në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj.

3.5.9 Materialet dhe burimet mësimore

Artet studiohen përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike artistike, për secilën lëndë.

P.sh në artin pamor, në këtë nivel kemi punët dy dhe tri dimensionale, ilustrimet (foto, punime të artistëve, objekte nga natyra, ilustrime veprash arti), ose materiale të tilla si: letra, pëlhura, plastelina, materiale organike etj. Ndërsa për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve apo ekspozitave/veprave të ndryshme, për ndjekjen e pjesëve dramatike, kërcimeve të ndryshme, këngëve apo veprave të artit përdoren magnetofoni, TV, CD dhe DVD.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- > *Mjetet pamore natyrore si: modele për të vizatuar etj.*



- > *Mjetet artificiale si:* fotografitë, vizatimet.
- > *Mjetet audiovizive si:* Tv, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- > *Mjetet dëgjimore:* radio, magnetofon, kasetofonetj.
- > *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme arti. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për artet. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në kryerjen e vizatimeve apo krijimeve të ndryshme.
- > *Mjedisi mësimors:* (klasa, kabinetet e e artitetj.)



3.6 Fusha e të nxënit: Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti

3.6.1 3.6.1 Hyrje

Fusha mësimore “Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti” në arsimin parauniversitar ndihmon që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme, të cilat sigurojnë mirëqenien e shëndetit të tyre mendor, emocional, fizik dhe social, si dhe të ndihmojnë të përballin me sukses sfidat e jetës së tashme dhe të ardhme.

Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit do të afrojë një qasje të integruar të edukimit fizik dhe sporteve me edukatën shëndetësore, nga shkalla 1 deri në shkallën 6, e cila do të përfshijë shpalosjen e mënyrave të jetës së shëndetshme apo mbrojtjen prej sëmundjeve dhe rreziqeve prej tyre.

3.6.2 Qëllimi i fushës

Fusha mësimore “Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti” ka si qëllim të shihet një mjet ideal për promovimin e aktivitetit të rregullt fizik, edukimin e një stili jetese të shëndetshme e aktive dhe fitimin e kompetencave të rëndësishme e të vlefshme përgjatë gjithë jetës. Fusha e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit në shkallët 3-4, u mundëson nxënësve:

- përforcimin e mëtejshëm të njohurive teknike e taktike të fituara në disiplinat sportive dhe përdorimin e tyre në jetën e përditshme;
- zbatimin në veprimtaritë fizike e sportive të rregulloreve teknike të disiplinave sportive;
- kryerjen e kombinimeve lëvizore me përmbajtje të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit lëvizor me dhe pa mjete, si dhe elementë akrobatike;
- zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë të ushtruarit me aktivitet fizik e sportiv;
- praktikimin e rregullave dhe mënyrave të dhënies së ndihmës së parë në raste të traumave që ndodhin gjatë aktivitetit fizik;
- zbatimin në jetën e përditshme të parimeve të Olimpizmit, Filozofisë Olimpike dhe Fair-Play-t, si dhe krijimin e edukatës e të ushtruarit sistematik, disiplinës, vullnetit, vetëvlerësimit dhe konkurrencës së ndershme.



- vlerësimi i sportit si alternativë karriere në të ardhmen.

3.6.3 Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

Fusha e Edukimit fizik, sportit dhe shëndetit, në shkallën e tretë dhe të katërt të arsimit kërkon të zhvillohet përmes tematikave të mëposhtme:

1. Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike

- Lojëra lëvizore e popullore
- Gjimnastikë
- Atletikë

Edukimi fizik u ofron nxënësve një platformë nga e cila mund të formojnë kompetenca për të zhvilluar kapacitetet fizike e aftësitë koordinatave që ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive personale dhe ndërpersonale. Kjo tematikë u mundëson nxënësve të zhvillojnë dhe krijojnë aftësitë e nevojshme për pjesëmarrje në një gamë të gjerë të aktiviteteve fizike, sportive, kulturore që ndikon në rritjen e mirëqenies së tyre fizike dhe i përgatit për jetë aktive dhe të shëndetshme.

2. Aktivitete sportive

- Basketboll
- Volejbol
- Futboll
- Veprimtari sportive ndihmëse

Sportet u mundësojnë nxënësve përforcimin e njohurive dhe përdorimin e shumë elementeve e kombinacioneve tekniko-lëvizore që përfshihen në lojërat sportive. Nëpërmjet këtyre lojërave sportive (basketboll, volejbol, futboll, etj.) nxënësit krijojnë e fitojnë kompetenca shumë të rëndësishme për jetën, zhvillojnë më tej cilësitë fizike, aftësitë e komunikimit dhe të punuarit në skuadër, duke e konsideruar sportin si mundësi për karrierë, zhvillojnë aftësitë për pranimin dhe ndarjen e përgjegjësisë, si dhe gëzimin e suksesit, mësohen të respektojnë rregullat e lojës dhe fair-play-t në aktivitetet sportive në shkollë e jashtë saj, që në vetvete përbën një model të respektit ndaj rregullave demokratike të jetës qytetare, si dhe formimin e kulturës së të ushtruarit sportiv për gjatë gjithë jetës.



3. Praktikim aktivitetesh në shërbim të komunitetit, mirëqenies dhe shëndetit

- Mirëqenie fizike, mendore, emocionale dhe sociale.
- Ruajtja e organizmit nga dëmtimet e mundshme gjatë të ushtruarit me aktivitet fizik e sportiv dhe dhënia e ndihmës së parë.
- Të ushqyerit e shëndetshëm.
- Edukimi olimpik dhe Fair-Play.
- Rreziqet nga përdorimi i substancave që krijojnë varshmëri.
- Planifikimin për zgjedhje dhe ndryshime.

Edukimi shëndetësor u mundëson nxënësve fitimin e kompetencave për ruajtjen dhe kultivimin e shëndetit të tyre dhe të tjerëve, u mundëson zhvillimin e respektit për vetveten dhe të tjerët, të praktikojnë mënyrat e ruajtjes së organizmit nga dëmtimet e mundshme, gjatë të ushtruarit në aktivitetet fizike e sportive, të zbatojnë rregullat e dhënies së ndihmës së parë, të zbatojnë mënyra të drejta të të ushqyerit dhe praktika të sigurta dhe higjienike në rutinën ditore, të zbatojnë parimet e filozofisë olimpike, të respektojnë edhe në jetën e përditshme rregullat e Fair-Play-t, të zhvillojnë të kuptuarit e efekteve negative të përdorimit të substancave narkotike, si dhe t'i ndihmojë ata të bëhen të ndërgjegjshëm për nevojën e ruajtjes së një mjedisi të shëndetshëm, në të cilin ata mund të mbrojnë veten dhe të tjerët nga faktorët e rrezikshëm.

3.6.4 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

I gjithë procesi i të nxënësve në fushën e “Edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit”, organizohet rreth tre kompetencave specifike të fushës. Të tri kompetencat e fushës lidhen me njëra-tjetrën.

Kompetenca 1: Zhvillimi i aftësive lëvizore në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive.

Në këtë kompetencë përfshihen *koordinimi, rregullimi, kontrolli, ndjesitë dhe vetë-shprehjet* duke iu referuar aftësisë për të ekzekutuar veprimeve të ndryshme lëvizore. Ato zhvillohen në situata të larmishme të të nxënësve të lidhura me lloje të shumta aktivitetesh si p.sh:aktivitete me përmbajtje të lëvizjeve lokomotore (vrapimi, ecja, notimi, çiklizmi, etj.) dhe lëvizje jo-



lokomotore si (kërcimi, goditja, etj.), lëvizje manipulative me dhe pa mjete, aktivitetet teknike e artistike (gjimnastika artistike e ritmike).

Përmbajtja e këtyre aktiviteteve duhet t'u mundësojë nxënësve të bëhen më të vetëdijshëm për trupat e tyre dhe për mjedisin në të cilin ata duhet të përshtatin aktivitetin fizik e të veprojnë në mënyrën e duhur e të sigurt.

Kompetenca 2: Ndërveprimi me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive

Pjesëmarrja në aktivitete fizike me të tjerët kërkues, të cilat shkojnë përtej mjeshtërisë së thjeshtë e lëvizore. Edhe pse zotërimi i kësaj kompetence nuk është një kushtthemel për angazhim në një aktivitet fizik, mungesa e saj kufizon zgjedhjen në shumëllojshmëri që ky aktivitetet ofron. Ndërveprimi me të tjerët inkurajon nxënësit të angazhohen në një proces ku ata zhvillojnë plane të ndryshme të veprimit për të përshtatur lëvizjet e tyre me ato të të tjerëve, për të sinkronizuar lëvizjet e tyre me ato të të tjerëve dhe për të komunikuar me njëri-tjetrin. Nxënësit mësojnë punën në grup, kryejnë detyra të përbashkëta dhe pranojnë drejtë fitoren dhe humbjen. Duke pasur parasysh se nxënësit do të përballen me situatatë ngjashme në jetën e tyre të përditshme, kjo kompetencë i ndihmon ata të zhvillojnë aftësitë sociale dhe gjykime etike të favorshme për të ndërtuar marrëdhënie harmonike ndër personale.

Kompetenca 3: Përshtatja e një stili jete aktiv dhe të shëndetshëm.

Të përshtatesh në një stil jete aktiv dhe të shëndetshëm do të thotë të krijosh mundësitë për të jetuar një jetë, e cila karakterizohet nga një mirëqenie e përgjithshme fizike, mendore dhe emocionale, në të cilën një individ gëzon aftësi për të ekzekutuar çdo ditë detyra energjike dhe aktivisht, kryen me kënaqësi aktivitetet e kohës së lirë dhe realizon lehtësisht kërkesat e ditës. Për një nxënës kjo kompetencë zhvillohet me edukimin e zakoneve të shëndetshme, angazhimin në forma të ndryshme të aktivitetit fizik e sportiv, të ushqyerit në mënyrën e duhur, mos ekspozimin ndaj substancave që krijojnë varësi, duke krijuar një model jete e cila do të sillte efekte të pëlqyeshme afatshkurtra, afatmesme e afatgjata.

3.6.5 Rezultatet e të nxënit

KSNA 2	
Shkalla e tretë, klasat 6-7	Shkalla e katërt, klasat 8 - 9
Rezultatet në fund të klasës së shtatë	Rezultatet në fund të klasës së nëntë



1. Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike

Nxënësi:

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Kryen kombinime lëvizore me përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes. | <ul style="list-style-type: none"> • Krijon kombinime lëvizore me përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Argumenton diferencën midis pozicioneve të sakta (drejtqëndrimeve) dhe të pasakta të qëndrimit të shtyllës kurrizore në vend dhe në lëvizje. | <ul style="list-style-type: none"> • Zbaton mënyrat e duhura të drejtqëndrimit në vend, në lëvizje, në situata të ndryshme lëvizore e sportive. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Analizon efektet e ushtrimit të lëvizjeve jolokomotor dhe lokomotor mbi organizmin e njeriut në jetën e përditshme. | <ul style="list-style-type: none"> • Demonstron përdorimin e lëvizjeve jolokomotor dhe lokomotor në situata të ndryshme lëvizore e sportive dhe gjatë jetës së përditshme. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Analizon efektet e ushtrimit të lëvizjeve manipulative mbi organizmin e njeriut në jetën e përditshme. | <ul style="list-style-type: none"> • Demonstron përdorimin e lëvizjeve manipulative në situata të ndryshme lëvizore e sportive dhe gjatë jetës së përditshme. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Përshtat lojërat lëvizore të mësuara sipas kushteve të diktuar nga ambienti. | <ul style="list-style-type: none"> • Krijon lojëra të reja lëvizore dhe organizon grupin (shokët e klasës) në zhvillimin e tyre. |

2. Aktivitete sportive

Nxënësi:

- | | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Përdor shprehitë motorike dhe kombinimet lëvizore të mësuara gjatë ushtrimit të aktiviteteve të ndryshme sportive. | <ul style="list-style-type: none"> • Demonstron metodologji të përshtatshme të të ushtruarit shprehive motorike dhe kombinimeve lëvizore (teknikat e duhura). |
| <ul style="list-style-type: none"> • Zbaton rregullat e lojërave lëvizore dhe sportive. | <ul style="list-style-type: none"> • Analizon lidhjen dhe përdorimin e rregullave të lojës me rregullat e jetës së përditshme. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunon me partnerin në lojë dhe respekton kundërshtarin. | <ul style="list-style-type: none"> • Analizon lidhjen midis situatave të lojës dhe jetës së përditshme. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Përshtat forma të ndryshme të veprimtarisë fizike me kushtet e mjedisit natyror. | <ul style="list-style-type: none"> • Argumenton efektet mbi organizmin e njeriut. |



- Zbaton mënyra të ndryshme të orientimit në natyrë.

- Analizon efektet e ushtrimit të aktivitetit në natyrë mbi organizmin e njeriut në jetën e përditshme

3. Praktikim aktiviteteve në shërbim të komunitetit, mirëqenies dhe shëndetit

Nxënësi :

- Identifikon gjendje të ndryshme emocionale në varësi të situatave të ndryshme të jetës së përditshme dhe tregon për to (p.sh. kur bashkëbisedon me mësuesit, kolegët, apo gjatë lojës, punës në grupe etj.)

- Analizon efektet e gjendjeve të ndryshme emocionale në përshtatje m situata të ndryshme (p.sh. pune në grupe, loje në shkollë dhe jashtë saj etj).

- Praktikun të drejtat dhe përgjegjësitë tij/saj në jetën e përditshme brenda dhe jashtë shkollës.

- Analizon mbi faktin që çdo individ është unik, i ndryshëm, si dhe mbi kontributin që çdo njëri duhet të japë që shkolla dhe mjedisi ku jeton të jetë i barabartë dhe mikpritës për të gjithë.

- Zbaton shkathtësi dhe shprehi për mirëmbajtjen e higjienës personale në shtëpi dhe në shkollë.

- Demonstron përkushtim dhe argumenton efektet në jetën e përditshme të ruajtjes dhe kultivimit të higjienës personale dhe të mjedisit në shtëpi, shkollë dhe komunitet.

- Njeh mënyra të dhënies së ndihmës së parë në raste traumash që mund të ndodhin gjatë aktivitetit fizik.

- Zbaton mënyra të thjeshta të dhënies së ndihmës së parë në raste traumash që mund të ndodhin gjatë aktivitetit fizik.

- Zbaton parimet e olimpizmit dhe rregullat e “Fair-Play-t” gjatë aktivitetit fizik, sportiv dhe në jetën e përditshme.

- Argumenton mbi dobishmërinë e praktikimit të parimeve olimpike dhe rregullave të “Fair-Play-t” edukimin e tij/saj.

- Zhvillon plane individuale për ushqim të shëndetshëm sipas sezoneve, periudhave ditore dhe zbaton rregullat e nevojshme të mënyrave të shëndetshme të të ushqyerit.

- Argumenton mbi nevojshmërinë e krijimit të një edukate individuale dhe zbatimit të rregullave dhe mënyrave të shëndetshme të të ushqyerit në jetën e përditshme.

- Identifikon medikamentet dhe substancat

- Argumenton mbi efektet negative të



e dëmshme që krijojnë varshmëri, si dhe medikamentet që ndikojnë pozitivisht në shëndetin e tij/saj.	substancave që krijojnë varshmëri.
• Identifikon talentet/aftësitë personale të tij/saj në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme.	• Konsideron dhe planifikon sportin si mundësi për karrierë.

Njohuri dhe koncepte

- Elementë të lëvizjes
- Lëvizje manipulative
- Lëvizje lokomotore
- Lëvizje jolokomotore
- Lojë lëvizore
- Rregulla të lojës
- Lojë tradicionale (popullore)
- Morali i lojës
- Lojëra sportive
- Marshim në natyrë
- Higjiena personale
- Veshja e përshtatshme
- Drejtqëndrime
- Rregullat e sigurisë
- Ndihma e parë
- Mënyra të të ushqyerit
- Edukim olimpik
- “Fair-Play”
- Substanca që krijojnë varshmëri
- Mënyra të drejta të përdorimit të substancave
- Mjedisi që na rrethon
- Planifikim
- Karrierë

Aftësi dhe shkathtësi



- Praktikon skema të ndryshme lëvizore.
- Përshtat skema lëvizore në situata të ndryshme sportive .
- Krijon
- Analizon
- Diskuton
- Pjesëmarrje aktive.
- Ushtron të drejtat e veta.
- Shpjegon
- Menaxhon emocionet.
- Demonstron sjelle, veprime, shprehi.
- Zbaton parimet
- Përshkruan llojet e ushqimit, aktivitetet fizike.
- Qëndrim të drejtë trupor.
- Ndërton bashkëpunim.
- Harton plane individuale.
- Hulumton

Qëndrime dhe vlera

- Respekton veten dhe të tjerët.
- I përgjegjshëm
- Tolerant
- Respektimi i diversitetit.
- I përkushtuar
- Qëndrim pozitiv
- Bashkëpunues
- Respekton kodin e mirësjelljes.
- Respekton kodin e veshjes.
- Respekton rregulloret.
- Gatishmëri
- I sigurt



3.6.6 Ndarja e kohës

Sipas Kornizës së kurrikulës së Shqipërisë, në planin mësimor për nivelin e parë, fusha e kurrikulës “Edukimi fizik, sportet dhe shëndetësi”, zhvillohet në **420 orë** mësimore. Si në shkallën e tretë edhe të katërtëntë kurrikulës, klasat 6 - 9, janë 3 orë mësimore në javë të planifikuara përedukim fizik, sporte dhe shëndet. Sportet kanë peshën kryesore në ndarjen e orëve mësimore, pasi eksperiencat lëvizore dhe njohuritë e mësuara, finalizohen në situatat e lojërave sportive duke u shndërruar në kompetenca të mirëfillta.

Fusha e të nxënit		
	Shkalla 3	Shkalla 4
	Klasat VI – VII	Klasat VIII – XI
Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti (orë mësimore/javë)	3 orë	3 orë
Edukim fizik	1 orë	1 orë
Sporte	1,5 orë	1,5 orë
Shëndet	0,5 orë	0,5 orë

3.6.7 Udhëzime metodologjike

Organizimi i mirë i procesit të mësimit të fushës mësimore “Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti”, do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete praktike ku zhvillojnë dhe zbatojnë elementët lëvizorë e sportivë. Aktiviteti lëvizor, (loja dhe sporti) janë një punë serioze, që dominon shumicën e jetës së tyre shkollore dhe jashtë saj, duke u zënë pjesën më të madhe të kohës e të energjisë, duke u edukuar aftësi dhe formuar sjellje shoqërore, si kontribut themelor në kërkesën për rritjen e shpejtë dhe të shëndetshme. Në orët e mësimit të edukimit fizik, sportiv e shëndetësor, vihet theks i veçantë nëmbajtjen ehigjienës, pjesëmarrja në to i mësonnxënësitse si të ruajnë pastërtinë dhe të kujdesen për higjienën e trupit gjatë dhe pas aktivitetit fizik. Gjatë këtyre orëve mësohen praktika të sigurta, të cilat, nëse ndiqen nga nxënësitgjatë gjithëjetës së tyre, do t’i shpëtojnëata ngashumë sëmundje. Pikërisht ky është dhe burimi kryesor që përbën motivimin e drejtë përkundrejt një objektivi të caktuar mësimor.

Lëvizjet statike si p.sh. ekuilibri mbi majat e gishtave ose goditja e topit nga një piketë, duhet të paraprijnë lëvizjet dinamike si ecja në tra ekuilibri ,ose goditja e një topi të



varur. Dhe fëmijët padyshim duhet të kryejnë me sukses veprime ose lëvizje të vetme para se të ekzekutojnë kombinime të tyre. Fëmijët, që kanë zotëruar mirë bazat, janë shumë më të sigurtë me aftësitë e tyre lëvizore dhe për pasojë me të njëjtën siguri do të vazhdojnë gjatë gjithë jetës.

Disa nga komponentët që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe suksesin e mësimit të Fushës “Edukimi fizik, sporte dhe shëndet”, janë:

Edukimi fizik, sportiv dhe shëndetësor si komponent i fitnesit.

Promovimi i fitnesit për gjatë jetës është një nga prioritetet e specialistëve të edukimit fizik, sidomos tani që fëmijët janë në një periudhë në të cilën janë më shumë të prirur për jetë sedentare se në çdo periudhë tjetër. Kështu që është parësore vënia e theksit tek fitnesi si pjesë e bazave të programeve edukative fizike.

“Edukimi fizik, sportiv dhe shëndetësor” si komponent i formimit edukativ e social.

Duke marrë pjesën e procesin mësimor të edukimit fizik dhe sporteve, nxënësit kanë filluar të mësojnë shumë gjëra për jetën. Atafitojnë në disa lojëra dhe humbasin në disa të tjera, kjo i bën ata të kuptojnë sefitorja dhe humbjat janë pjesë e jetës dhe duhet të pranohet të tilla. Kur një nxënës bëhet pjesë e një ekipi, ai mëson se bashkëpunimi të tjerët është shumë irëndësishëm në qoftë se duhet të arrihen qëllimet. Duhet të respektohen rregullat e lojës, vendimet e gjyqtarit dhe kundërshtari. Gjithashtu, pjesëmarrja në praktika lëvizore e sportive mundëson zhvillimin mendor e intelektual të nxënësve në mënyrë argëtuese dhe të drejtpërdrejtë.

Edukimi fizik, sportiv dhe shëndetësor si komponent i arteve.

Edukimi fizik dhe sportiv e gjen veten mjaft mirë si komponent i edukimit artistik, sepse janë të ndërlidhur me njëri - tjetrin. Edukimi fizik dhe sportiv vë në lëvizje gjithë trupin e njeriut të vallëzimit e muzikës që e shoqëron atë. Sinkronizimi dhe ritmizimi si aftësi koordinative, janë pjesë përbërëse të edukimit fizik e artistik, të cilët së bashku ndihmojnë në një zhvillim dhe formim më të plotë të nxënësit.

Edukimi fizik, sportiv dhe shëndetësor si komponent i edukimit estetik.



Edukimit fizik mund të konsiderohet edhe nga mënyra se si andikon pamjen dhe estetikën e një nxënësi. Kur një nxënës merr pjesë në aktivitete fizike, ai bëhet më i aftë dhe më tërheqës, formon një trup të bukur dhe më të shëndetshëm. E gjitha kjo ndihmon për të rritur vetëbesimin e tij, pasi çdokush dëshiron të ndihet mirë dhe të duket bukur.

3.6.8 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësit, ku nxënësi vlerësohet për arritjet e veta.

Qëllim i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi, si për shembull:

- Përdor fjalë e shprehje inkurajuese gjatë të mësuarit.
- Korrigjon me takt lëvizjet e gabuara.
- Me zgjedhjen e nxënësve më të mirë në vegla.
- Me zgjedhjen e nxënësve për ekipin e shkollës (basketboll, volejball, futboll etj.)
- Me shpalljen e lojtarëve më të mirë.
- Koha në sekonda e realizimit të veprimit lëvizor mbi bazën e progresit individual.
- Sasia në herë e përsëritjeve të veprimit lëvizor mbi bazën e progresit individual.
- Distanca në metra e arritur nga veprimi lëvizor mbi bazën e progresit individual.
- Me kompleks ushtrimesh dhe me pikë.
- Me sistem pikësh për ushtrimet e veçanta.
- Me sistem pikësh për vallëzimin e kompozuar.
- Me teste e pikë për kombinacionet teknike.
- Me teste për njohuri mbi edukimin shëndetësor
- Me pikë për veprime teknike individuale.
- Me pikë për veprime individuale.
- Me pikë për skemat lëvizore të vrapimeve të ndryshme.
- Këtyre vlerësimeve mund t'i shtohet edhe vlerësimet mbi aktivizimin në veprimtaritë e



ndryshme sportive.

Të gjitha këto duhet të reflektohen në kartelat e matjeve antropometrike dhe atyre fiziko-lëvizore. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet, ndërsa demonstroi arritjet e tij, duke shfaqur nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: merr pjesë në veprimtari të ndryshme sportive, apo sportive–artistike që organizon shkolla etj. Në angazhimin e nxënësve me grupe apo skuadra të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënësi në veçanti.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim.

3.6.9 Materialet dhe burimet mësimore

Për arritje suksesi në fushën e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit, është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që të motivojnë nxënësin dhe të stimulojnë progresin e tij/saj në mënyrë që të përvetësojë shprehje dhe shkathtësi të nevojshme për jetën. Baza materiale sportive është burim i vlefshëm dhe i rëndësishëm të nxënësit. Por qasja e nxënësve në informacion nuk duhet kufizuar vetëm në to, por të mundësohen burime të tjera të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe realizuar sa më me cilësi procesin mësimor në klasë. Për realizimin e mësimin duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë bazën materiale sportive, tekstin e edukimit shëndetësor, udhëzuesin kurrikular për mësuesin, aktivitete të ndryshme sportive, projekte, studime, analiza dhe raporte të ndryshme, si dhe librat e tjerë të fushave mësimore që mundësojnë qasje ndërkurrikulare.



3.7 Fusha e të nxënësve: Teknologji dhe TIK-u

3.7.1 Hyrje

Në kohët e sotme, Teknologjia dhe Tik-u janë kthyer në një mënyrë jetese ndaj së cilës fëmijët janë të tërhequr. Për t'iu përshtatur sa më mirë ndryshimeve të kohës, është i nevojshëm integrimi i TIK-ut në ciklin fillor pasi ndikon në zhvillimin e kompetencës digjitale të të gjithë nxënësve. Fëmijët e sotëm fillojnë të përdorin mjetet digjitale në një moshë shumë të re, ndaj shkolla duhet t'u përgjigjet nevojave të nxënësve.

Arsimi teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulës. Në një botë, ku ndeshesh me shumë lloje teknologjish, të cilat janë pjesë e jetës së përditshme për të gjithë njerëzit, nxënësve duhet të pajisen me aftësi për t'u përballur me to me vetëbesim. Është po aq e rëndësishme që nxënësve të vlerësojnë dhe të kuptojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nxënësve të moshës digjitale vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të mara nga burime të pafundme digjitale të informacionit të cilat mësuesi duhet t'i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj.

Tik-u dhe Teknologjia janë një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Ajo integron shprehitë për zgjidhjen e problemeve dhe ato praktike në prodhimin e produkteve dhe të sistemeve të dobishme. Për këtë arsye ajo është e pranishme në shumë fusha të të nxënësve, por veçanërisht në fushën e shkencave natyrore.

3.7.2 Qëllimi i fushës

- Të kontribuojë në një edukim të balancuar, duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që do t'u krijojë mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, kuptimesh, aftësishë njohëse e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës në një botë teknologjike.
- T'u krijojë mundësi nxënësve t'i integrojnë këto njohuri dhe shkathtësi/shprehi, së bashku me cilësitë për hulumtim dhe mendim reflektiv, për gjetjen e zgjidhjeve me vëmendjen e



duhur ndaj çështjeve të shëndetit dhe sigurisë.

- Të lehtësojë zhvillimin e një sërë aftësive të komunikimit, që do t'i nxisin nxënësit të shprehin aftësitë e tyre krijuese në mënyrë praktike dhe me imagjinatë, duke përdorur varietet formash: fjalë, grafikë, modele etj..
- Të sigurojë një kontekst, në të cilin nxënësit mund të zbulojnë dhe vlerësojnë ndikimin e teknologjive në ekonomi, në shoqëri dhe në mjedisin përreth.

3.7.3 Tematikat e fushës dhe përshkrimi i tyre

- **Analizë e thelluar e të dhënave**

Nxënësi është në gjendje të analizojë dhe interpretojë të dhëna statistikore nëpërmjet programeve të paketës Windows Office. Në këtë cikël synohet që nxënësi të zhvillojë aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për ta aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit dhe internetit.

- **Motorët e kërkimit dhe mjetet mediatike**

Nxënësit njohin specifikimet e motorëve të kërkimit dhe janë në gjendje të kërkojnë informacione në portale të ndryshme elektronike. Ata njohin dhe përdorin në mënyrë të saktë mjetet mediatike, si dhe funksionin dhe rolin e secilit mjet.

- **Gjuha e programimit (aplikimi i formulave bazë)**

Nëpërmjet gjuhës së thjeshtë të programimit pritet që nxënësit të njihen me koncepte të programimit dhe të mjedisit Scratch dhe t'i zbatojnë ato gjatë realizimit të detyrave ose projekteve kurrikulare.

- **Teknologjia, sistemet teknologjike dhe bota e kompjuterit**

Nxënësit përkufizojnë teknologjinë dhe sistemet teknologjike dhe analizojnë marrëdhëniet dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues.

Nxënësit përdorin në mënyrë të avancuar shumë medie për realizimin e detyrave, punëve praktike dhe projekteve.

- **Komunikimi grafik**



Nxënësit lexojnë dhe interpretojnë skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta teknike, si dhe përdorin mënyra të thjeshta të komunikimit grafik për të prezantuar ide dhe paraqitur objekte të thjeshta teknike.

- **.Strukturat, mekanizmat dhe materialet teknologjike**

Nxënësit përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike, si dhe përshkruajnë vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike kryesore në sistemet teknologjike të sotme

- **Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike**

Nxënësit analizojnë ndikimin e teknologjisë në veprimtaritë ekonomike, si dhe planifikojnë e realizojnë produkte dhe shërbime të thjeshta, me përdorimin e materialeve, veglave dhe proceseve të thjeshta teknologjike.

- **Etika dhe kushtet e sigurta nëpunë**

Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme në shtëpi, shkollë dhe mjedisin përreth.

3.7.4 Përshkrimi i kompetencave që zhvillon fusha

Aftësitë njohëse:

Përcaktimi i problemeve dhe nevojave njerëzore, vëzhgimi, mbledhja e të dhënave, interpretimi i të dhënave të mbledhura, specifikimi i kërkesave që duhet të përmbushë produkti, zgjidhja e problemeve që lidhen me skicimin e produktit, shqyrtimi dhe vlerësimi i zgjidhjes, krahasimi, dallimi, analiza sipas kriterëve dhe vendimmarrja e duhur.

Aftësitë praktike:

Matja, markimi, prerja dhe dhënia e formave, bashkimi dhe montimi, ndërtimi dhe përfundimi; organizimi i zinxhirit të aktiviteteve në një sekuencë logjike.

Aftësitë komunikuese:

Formulimi i ideve gjatë fazës së skicimit dhe në fazën e prezantimit të produktit përfundimtar; përgatitja e skicave, diagramave, modeleve dhe fotografive, si dhe skicat dhe



grafikët me anën e kompjuterit.

3.7.5 Rezultatet e të nxënit sipas fushës

Shkalla 3 dhe shkalla 4

KSNA 2

Shkalla e tretë, klasat VI-VII

Shkalla e katërt, klasat VIII-IX

I. Njohuritë, të kuptuarit dhe zhvillimi i shkathtësive përmes procesit të të nxënit

1. Përdor mjete, përmbajtje specifike, software dhe simulimet për të mbështetur të nxënit dhe kërkimin e informacionit.
2. Identifikon problemet dhe gjen zgjidhjen e duhur sipas pyetjeve të dhëna.
3. Zhvillon mendimin kritik dhe krijues nëpërmjet analizës dhe krijimit të informacionit në bashkëpunim më të tjerët.
4. Përzgjedh mjetet e nevojshme dhe të duhura për realizimin dhe zhvillimin e njohurive.

Rezultatet në fund të klasës së shtatë

Rezultatet në fund të klasës së nëntë

7. Analizë e thelluar e të dhënave

- Korrigjon tekstet nga ana ortografike duke përdorur fjalorin elektronik si dhe e formatojnë sipas modelit të kërkuar.
- Mirëmenaxhon problemet që mund të dalin gjatë punës me kompjuter.

- Analizon të dhënat e qelizave në Excel sipas formulave.
- Krijon animacione origjinale ose dokumentarë duke u bazuar tek ngjarjet e komunitetit, lokalitetit dhe ambientit shkollor.
- Përpunon fotografitë si dhe njeh formatet e ndryshme që afron kompjuteri për ruajtjen e dokumenteve.

2. Motorët e kërkimit dhe mjetet mediatike

- Bën dallimin midis web-browseve të

- Kupton rëndësinë e mbylljes së adresave



ndryshme (Internet, Explorer, Mozilla, Google Chrome).

- Përdor mjete të ndryshme multimediale për të realizuar projektet kurrikulare ose detyrat e kërkuara.

personale në raste se punojnë në kompjutera publik.

- Jep gjithnjë moshën e tij të saktë në websitet e sigurta në të cilat kërkohen të dhëna konkrete për regjistrimin personal.

3. Gjuha e programimit (aplikimi i formulave bazë)

- Krijon projekt në Scratch që kombinon animacionin dhe muzikën
- Krijon projekte biografike në Scratch duke i dhënë përparësi edhe gjuhës së përdorur.

4. Teknologjia, sistemet teknologjike dhe bota e kompjuterit

- Analizon ndikimin e teknologjisë në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues.
- Zbaton metodologjitë e duhura për të punuar saktë me teknologjitë.
- Njeh funksionet e avancuara të kompjuterit.
- Praktikon TIK-un nëpërmjet krijimit të blogjeve informative dhe komunikimit online nëpërmjet multi-mediave.

- Analizon marrëdhënien e teknologjisë me sistemet teknologjike.
- Mban qëndrim kritik ndaj marrëdhënies së teknologjisë me sistemet teknologjike për ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues.
- Përdor mjete, përmbajtje specifike, software dhe stimulimet për të mbështetur të nxënit dhe kërkimin e informacionit.
- Njeh antiviruset, funksionin e tyre dhe di të instalojë antivirusin në kompjuter.
- Ç'instalon programe nga Software dhe shkarkon të tjerë për t'i përditësuar.

5. Strukturat, mekanizmat dhe materialet teknologjike



- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none">- Dallon materialet teknologjike të llojeve të ndryshme.- Përshkruan vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike kryesore në sistemet teknologjike të sotme.- Realizon një produkt në mënyrë individuale ose në grup , për nevojat personale ose të komunitetit të zonës.- Përshkruan funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike.- Tregon përdorimin e sistemeve teknologjike në mjedisin familjar. | <ul style="list-style-type: none">- Përdor materiale teknologjike kryesore për realizimin e një produkti familjar.- Realizon objekte ose produkte të ndryshme gjatë zbatimit të skicave, të modeleve dhe teknikave artizanale, duke përdorur një gamë të gjerë të mjeteve të materialeve dhe veglave të punës.- Përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike.- Shqyrton një gamë të gjerë të objekteve të jetës së përditshme.- Eksploron se si një varg i formave, i objekteve dhe i strukturave të tjera mund të bëhet duke përdorur një shumëllojshmëri të materialeve me përmirësime të mundshme. |
|---|---|

6. Komunikimi grafik

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">- Lexon skica të objekteve të thjeshta teknike.- Vizaton skica të objekteve të thjeshta teknike. | <ul style="list-style-type: none">- Interpretton skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta teknike.- Përdor mënyra të thjeshta të komunikimit grafik për të prezantuar ide dhe objekte të thjeshta teknike. |
|---|--|

7. Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none">- Identifikon veprimtaritë dhe realizimin e tyre në shtëpi, komunitet dhe shkollë.- Demonstron nevojën për realizimin e veprimtarive në shtëpi, komunitet | <ul style="list-style-type: none">- Vlerëson veprimtarinë dhe produktin përfundimtar, duke iu referuar planit të veprimit, recetës. |
|--|---|



dhe shkollë.

- Identifikon dhe klasifikon materiale recikluese bazike nga ekonomia familjare duke i dalluar, krahasuar dhe renditur për përdorime të tjera.

- Kryen llogaritje të thjeshta të kostos së materialeve të produktit përfundimtar.
- Përpunon materiale recikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtjeje dhe për ruajtjen e mjedisit.

8. Etika dhe kushtet e sigurta në punë

- Zbaton udhëzimet gjatë aktiviteteve të matjes, të shënimit, të prerjes së sigurt dhe të formësimit të materialeve të ndryshme.
- Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri.
- Dallon rreziqet në jetën e përditshme.
- Njeh të drejtën e autorit dhe citon gjithnjë burimin e marrjes së informacionit.

- Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme në shtëpi, shkollë dhe mjedisin përreth.
- Është i vetëdijshëm për diversitetin individual në klasë, në shkollë dhe në jetë për të përmirësuar të kuptuarit dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore.
- Zbaton rregullat e dërgimit të e-mailit dhe përdor në mënyrë të përshtatshme gjuhën sipas dërguesve.

II. Qëndrimet dhe vlerat



- Është i përgjegjshëm gjatë përdorimit të mjeteve teknologjike.
- Tregohet tolerant dhe respekton diversitetin gjatë punës në grup.
- Merr iniciativa.
- Ruan etikën e komunikimit personal si dhe atë të grupit gjatë komunikimeve virtuale dhe komunikimit në klasë, shkollë dhe komunitet.
- Ruan sigurinë e identitetit virtual dhe privatësinë personale.
- Ka kurajë të kërkojë ndihmë kur e sheh të nevojshme.
- Fiton dhe krijon pavarësi në shprehjen e mendimeve personale si dhe gjatë përdorimit të teknologjive të reja.
- Respekton kodin e mirësjelljes.
- Zhvillon kuriozitetin nëpërmjet analizës së informacioneve digjitale.

III. Aftësitë dhe shkathtësitë në fushën e Teknologjisë dhe TIK-ut

- Përdor aftësitë e të menduarit kritik dhe krijues për të planifikuar dhe kryer hulumtime.
- Menaxhon projekte kurrikulare nëpërmjet përdorimit të duhur të burimeve digjitale.
- Përdor efektet vizive, auditive dhe animacionet për të krijuar materiale mësimore.
- Analizon probleme duke përdorur TIK-un.
- Arsyeton proceset dhe konceptet e thelluara të fushës.
- Zbaton dhe vlerëson konceptet e fushës për të thelluar njohuritë në fusha të ndryshme.
- Komunikues, transferues i informacionit, të menduarit kritik dhe krijues i zhvillimit të karakterit dhe të estetikës.
- Heton, planifikon, zbaton dhe vlerëson veprimtaritë konkrete teknologjike të realizuara prej tij ose në grup.
- Përdor materialet, mjetet dhe veglat e thjeshta të punës, në lidhje me interpretimin e skicave, udhëzuesve të përdorimit, interpretimin e simboleve, si dhe aftësive për të përgatitur produkte të ndryshme.
- Shpalos aftësi organizative gjatë punës në grup, si dhe gjatë punës individuale.
- Mirëmban mjedisin dhe e mjetet e punës, duke ndjekur rregullat e sigurisë teknike.

IV. Konceptet kyç të fushës

- Gjuha e programimit



- Excel
- Krijim i posterave dhe broshurave nëpërmjet teknologjive
- Roli i pajisjeve Input/Output të kompjuterit
- Përpunimi në mënyrë të avancuar i informacionit nëpër TIK-ut
- Paraqitje grafike
- Material teknologjik
- Strukturë teknologjike
- Sistem teknologjik
- Prodhim industrial
- Prodhim artizanal
- Prodhim bujqësor
- Teknologji ekologjike

3.7.6 Ndarja e kohës

Fusha kurrikulare “Teknologjia dhe TIK-u” në kurrikulën bërthamë përfshin aktivitete që mundësojnë zhvillimin e aftësive, qëndrimeve dhe vlerave për të kërkuar, mbledhur e përpunuar informacionin, për ta përdorur atë në mënyrë kritike dhe sistematike dhe përdorimin e teknologjive me qëllim zgjidhjen e problemeve të ndryshme apo zhvillimit të njohurive të reja. Kjo fushë kërkon gjithashtu një qëndrim kritik dhe reflektues ndaj përdorimit të teknologjive të ndryshme duke vlerësuar përkatësinë dhe rolin e tyre në jetën e përditshme. Kjo fushë përfshin lëndët: *Teknologji dhe Tik*. Numri i orëve për fushë dhe për shkallë është i përcaktuar në planin mësimor të prezantuar në kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar.

Fusha e të nxënit		
	Shkalla 3	Shkalla 4
Teknologji dhe TIK (% dhe në orë)	5.4% 3 orë	3.2% 2 orë



TIK (orë mësimore/javë)	2 orë	2 orë
Teknologji (orë mësimore/javë)	1orë	-

3.7.7 Udhëzime metodologjike

Teknologjia dhe TIK-u i ofron shkollës potenciale të shumëfishta, si për shembull: me ndihmën e kompjuterit dhe të internetit zhvillohet të nxënit bashkëpunues, autonom dhe problemzgjdhës. Kjo kërkon përdorimin e duhur të mjeteve teknologjike, si dhe njihjen specifike të tyre. Në përgjithësi njeriu mëson nëpërmjet fitimit ose shkëmbimit të informacionit, vëzhgimit, iniciativës vetjake për gjetjen e zgjidhjes së problemit ose duke u motivuar nga strategjitë e të nxënit. Potencialet e mjeteve teknologjike sot përfshijnë edhe afrimin e shërbimeve në këto drejtime, duke bërë të mundur të nxënit. P.sh.: *kompjuteri me programet dhe mundësitë e tij mund të kthehet në mjet burimor informacioni dhe komunikimi, gjithashtu ai është mbështetës, ilustrues, prezantues, ndihmës, plotësues i materialeve mësimore.* Në këtë formë, mësuesi/ja gjatë lëndës së TIK-ut nuk ndihmon vetëm nxënësit të përvetësojnë njohuritë e reja, por i ndihmon ata t'i përdorin këto njohuri edhe në lëndët e tjera. Mbarëvajtja e orës së mësimit arrihet me sukses gjatë gërshetimit të këtyre komponentëve: njohurive, aftësive dhe qëndrimeve.

Njëra nga metodat më të sakta të përvetësimit të njohurive të TIK-ut do të ishte realizimi *iprojekteve kurrikulare*, në mënyrë që nxënësit të vënë në praktikë njohuritë e marra, si edhe t'i gërshetojnë këto njohuri me njohuritë e lëndëve të tjera. Në arsimin fillor nxënësit nuk duhet të mbingarkohen gjatë orës së TIK-ut, por përkundrazi të mësojnë nëpërmjet lojës dhe praktikës. Ora e mësimit duhet të bazohet në një tematikë të përshtatur për moshën e nxënësit. Kompjuteri përdoret si mjet për të luajtur me programet, qoftë lojëra zbavitëse mësimore, qoftë programe për shkrim, prerje, prezantime, kërkim në internet ose komunikim. Në këtë mënyrë nxitet kreativiteti, zhvillohet motorika dhe nxitet të menduarit për zgjidhjen e problemeve. Suksesi i kësaj ore mësimore pasqyrohet sidomos në lirinë e fituar të nxënësit për t'i përdorur mjetet e TIK-ut. Nëpërmjet punës në grupe nxënësi vlerëson bashkëpunimin me shokët e shoqet e klasës, krijon lirshmërinë e vendimmarrjes dhe të përgjegjësisë ndaj komunitetit. Njohuritë e përfutuara gjatë orës mësimore bëhen më konkrete dhe më të realizueshme nëse detyrat lidhen edhe me veprimtaritë në shkollë dhe me veprimtaritë që nxënësit mund të realizojnë jashtë shkollës. *Puna në grup ose në dyshe jep mundësi për debat*



ose konsultim. Kështu zhvillohet përgjegjësia ndaj komunitetit ose komunikimi me të tjerë, duke fituar siguri vetjake, aftësi në përdorimin e saktë të mjeteve të TIK-ut me një synim të caktuar.

Për nxënësit do të ishin të përshtatshme edhe *metodat gjysmëkërkimore* për një problem të caktuar. Këto metoda i nxisin nxënësit të kërkojnë vetë në fillim zgjidhjen e problemit dhe, më pas, të punojnë në grup për zgjidhjen e plotë të tij. Gjatë këtyre hapave mësuesi/ja ka rolin e lehtësuesit dhe i ndihmon ata të shkojnë drejt zgjidhjes së duhur.

Për zhvillimin sa më të mirë të kompetencës digjitale tek nxënësit po dhe të kompetencave të tjera kyçe është rëndësishme që gjithë ora e mësimit të jetë e bazuar në situata konkrete të cilat e kërkojnë zgjidhjen e problemit nëpërmjet të mësuarit duke bërë.

3.7.8 Udhëzime për vlerësimin

Vlerësimi si proces lidhet me tërësinë e metodave, praktikave dhe teknikave që përdorin mësuesit për të testuar, për të kontrolluar, analizuar dhe për të matur nivelin e njohurive, aftësive dhe të performancës së nxënësve. Vlerësimi duhet të jetë i realizueshëm, i vlefshëm, korrekt, i besueshëm dhe i saktë.

Vlerësimi duhet të japë një pasqyrë për arritjet e nxënësit, si edhe vështirësitë që mund të kenë nxënësit gjatë realizimit të detyrave ose projekteve kurrikulare. Të vlerësosh nxënësit nuk do të thotë vetëm t'i vendosësh atij një notë, por edhe ta ndihmosh atë të kalojë vështirësitë gjatë arritjes së kompetencave. Vlerësimi në klasë luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si mësojnë nxënësit, në motivimin e tyre për të nxënë dhe në mënyrën e shpjegimit të mësuesit. Pyetjet që lidhen me cilësinë (besueshmërinë, burimet e referencës, vlefshmërinë) janë të rëndësishme për të gjitha llojet e vlerësimit në klasë.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të ndihmohen nxënësit të bëhen të pavarur dhe të jenë në gjendje të vetëvlerësojnë progresin e tyre.

Vlerësimi bëhet në atë çfarë kanë përvetësuar nxënësit dhe çfarë janë të aftë të bëjnë. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Mësuesit nuk e kanë të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore. Në paragrafin në vijim do të gjeni disa forma vlerësimi të cilat ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë vështirësitë e tyre.



a. Vlerësimi formues

Ky lloj vlerësimi duhet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga mësuesi/ja, në mënyrë që të kuptohen vështirësitë e nxënësve, më pas të shihet ecuria e tyre dhe në fund të kapitullit të shihet nëse janë arritur kompetencat e kërkuara. Për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët, ky vlerësim është shumë i rëndësishëm pasi ata fillojnë të analizojnë në mënyrë të thelluar çfarë janë në gjendje të arrijnë dhe këtë ta përdorin si pikën e tyre të fortë. Gjatë këtij vlerësimi, mësuesi/ja duhet të vëzhgojë herë pas here nxënësit, të realizojë bashkëbisedime me ta, të realizojë produkte të ndërmjetme para produkteve finale. Ky lloj vlerësimi i ndihmon nxënësit të gjejnë mënyrën e duhur për të mësuarin efektiv.

b. Vlerësimi nëpërmjet portofolit

Një formë tjetër vlerësimi, që e ndihmon nxënësin të shohë se si ai avancohet hap pas hapi, është edhe *vlerësimi nëpërmjet portofolit*. Portofoli i nxënësit është një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, i cili përmban një koleksion punimesh të organizuara prej tij gjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra shtëpie me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi/ja është në rolin e atij që drejton dhe rekomandon. Qëllimi kryesor i portofolit është që nxënësi/ja të koleksionojë ato dokumente që atij mund t'i shërbejnë në vitet në vijim. Gjithashtu, në portofol, nxënësi/ja mund të shohë se si ai/ajo përparon nga muaji në muaj ose nga semestri në semestër.

c. Vetëvlerësimi

Ky lloj vlerësimi është vetëgjykim i nxënësit për arritjet e tij. Vetëvlerësimi shpesh shërben si një plotësues i domosdoshëm i teknikave të vlerësimit, të bëra nga mësuesi/ja dhe nga provimet. Pika e fortë e vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është një faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi. Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxëniet e tyre. Duhet theksuar që vetëvlerësimi është më i vlefshëm dhe më objektiv nëse nxënësit i japin kritere të sakta mbi të cilat ai/ajo bën vetëvlerësimin e punës së tij/saj. *P.sh.: mund t'i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetëkorrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta dhe, më pas, ai/ajo ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar.*



3.7.9 Materialet dhe burimet mësimore

Për arritjen me sukses të kompetencave në fushën e TIK-ut dhe Teknologjisë është e rëndësishme të përdoren materiale dhe burime mësimore që japin një informacion të kuptueshëm për moshën e nxënësit dhe që e ndihmojnë atë të zhvillojë aftësi, shkathtësi, njohuri dhe qëndrime të nevojshme për të mësuarin gjatë gjithë jetës. Njëri nga burimet e thjeshta mësimore, që përdoret shpesh nga nxënësit dhe mësuesit, është teksti mësimor. Mirëpo me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe të shtimit të informacionit digjital, mësuesi duhet ta shohë tekstin më tepër si një burim nxitës por jo të mjaftueshëm për të zhvilluar kompetencat kyçe të nxënësit.

Mësuesit mund të bashkëpunojnë online me mësues të shkollave të tjera për të gjetur burime të besueshme informacioni, që u vijnë në ndihmë jo vetëm nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre, por edhe mësuesve për të zhvilluar një qasje të re metodike. Nëpërmjet rritjes së shumë llojshmërisë së burimeve në nxësim më shumë nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik, krijues dhe problemzgjdhës gjatë procesit mësimor.

Disa nga burimet që mund të përdoren nga mësuesit për zhvillimin e orës mësimore mund të jenë: bibliotekat elektronike, broshurat informuese apo ndërgjegjësuese, enciklopeditë, software elektronike në funksion të mësimdhënies/mësimnxënies, studimet shkencore me fokus tek Teknologjia dhe TIK-u etj.

Gjithashtu në bashkëpunim me nxënësit dhe shkollat mund të organizohen seminare të ndryshme mësimore dhe punimet më të mira të publikohen dhe t'u vihen në dispozicion të gjitha shkollave. Në ditët e sotme, ndodh shpesh që nxënësi të jetë një hap përpara mësuesit për sa u përket informacioneve elektronike, prandaj mësuesit mund të krijojnë forume mësimore bashkë me nxënësit për të krijuar materiale në ndihmë të procesit mësimor.



PLANI MËSIMOR

4.1 Përshkrimi i planit mësimor

Plani mësimor i arsimit bazë (përfshirë edhe klasën përgatitore) është dokument i rëndësishëm që përcakton strukturën dhe organizimin e kurrikulës si dhe organizimin e procesit mësimor, në nivel shkolle, shkalle dhe klase.

Plani mësimor përcakton:

- Fushat e të nxënit dhe lëndët për secilën shkallë.
- Kohën mësimore (Numri i orëve javore për secilën shkallë dhe klasë).

Viti shkollor zgjat 35 javë mësimore.

Plani mësimor është konceptuar mbi bazën e **fushave të tënxënit** dhe lëndëve përbërëse.

Plani është i organizuar sipas 7 fushave të tënxënit: Gjuhët dhe komunikimi, matematikë, shkencat e natyrës, shoqëria dhe mjedisi, arte, edukimi fizik, sportet dhe shëndetësia, teknologjia dhe TIK-u. Në planin mësimor paraqitet edhe shpërndarja e orëve të kurrikulës me zgjedhje.

Tabela : Plani mësimor për arsimin parauniversitar në përqindje (%)

Fushat e tënxënit	KNSA 0		KNSA 1		KNSA 2	
	Shkalla 1		Shkalla 2		Shkalla 3	
	Klasa përgatitore	Klasa I – II	Klasa III – V	Klasa VI – VII	Klasa VIII – IX	Klasa X – XI
1. Gjuhët dhe komunikimi	26.3%	39.6%	34.1%	28.6%	25.8%	25.8%
2. Matematika	21.1%	19.8%	16.3%	14.3%	12.9%	12.9%
3. Shkencat e natyrës	10.5%	4.9%	6.8%	10.7%	19.3%	19.3%
4. Shoqëria dhe mjedisi	10.5%	4.9%	6.8%	14.3%	16.1%	16.1%
5. Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti	10.5%	14.8%	12.2%	10.7%	9.7%	9.7%
6. Artet	15.8%	11.1%	10.2%	8.9%	6.5%	6.5%



7. Teknologjia dhe TIK-u³	5.3%	0%	5.4%	5.4%	3.2%
Kurrikula me zgjedhje	0%	4.9%	8.2%	7.1%	6.5%

Tabela : Plani mësimor për arsimin bazë (në orë)

Fushat e të nxënit	KNSA 0		KNSA 1		KNSA 2	
	Shkalla 1		Shkalla 2	Shkalla 3	Shkalla 4	
	Klasa përgatitore	Klasa I – II	Klasa III – V	Klasa VI – VII	Klasa VIII – IX	
Gjuhët dhe komunikimi	5	16	25	16	16	
Gjuhë shqipe	5	16	16	10	10	
Gjuhë e huaj e parë	0	0	9	6	6	
Matematika	4	8	12	8	8	
Shkencat e natyrës	2	2	5	6	12	
Dituri Natyre	2	2	5			
Fizikë				3	4	
Kimi					4	
Biologji				3	4	
Gjeografi						
Shoqëria dhe mjedisi	2	2	5	8	10	
Edukim për shoqërinë	2	2	5			
Qytetari				2	2	
Histori				3	4	
Gjeografi				3	4	
Artet	3	4.5	7.5	5	4	

³Koha mësimore në këtë fushë, në klasën përgatitore, është vetëm për Teknologjinë.



Muzikë		2	3	2	2
Art pamor		2	3	2	2
Kërcim		0.5	1		
Teatër			0.5	1	
Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti	2	6	9	6	6
TEKNOLOGJIA DHE TIK-u ⁴	1	0	4	3	2
TIK			2	2	2
Aftësim teknologjik praktik			2	1	
Kurrikula me zgjedhje	0	2	6	4	4

Përshkrimi i shpërndarjes së orëve për secilën fushë si më poshtë:

- Në **klasën përgatitore** ora mësimore zgjat **25-30** minuta. Në një ditë mund të zhvillohen 3-4 orë mësimore.
- **Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”** zhvillohet nga shkalla 1-4. Gjuha shqipe zhvillohet nga shkalla 1 – 4 dhe Gjuha e huaj e parë klasa 2 – 4.
- **Fusha “Shkencat e natyrës”** zhvillohet nga shkalla 1-4. Në shkallët 1 – 2 zhvillohet lëndë dituri natyre, e cila integron lëndët fizikë, kimi, biologji, gjeografi. Më pas, lëndët përbërëse të kësaj fushe zhvillohen të veçanta: fizikë shkalla 3-4 ,kimi shkalla 4 dhe biologji shkalla 3-4.
- **Fusha “Shoqëria dhe mjedisi”** zhvillohet nga shkall 1-4. Në shkallët 1 – 2 zhvillohet lëndë *edukim për shoqërinë*, e cila integron lëndët qytetari dhe histori. Më pas, lëndët përbërëse të kësaj fushe ,zhvillohen të veçanta qytetaria në shkallët 3-4, historianë shkallët 3-4 dhe gjeografianë shkallët 3-4.
- **Fusha “Teknologjia dhe TIK-u”** zhvillohet nga shkalla 2 deri 4. Lëndët përbërëse të kësaj fushe zhvillohen të veçanta: TIK në klasat 4 - 9 dhe aftësim teknologjik praktik në klasat 4-6.

Edukimi për sipërmarrje zhvillohet i integruar në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” dhe si

⁴Koha mësimore në këtë fushë, në klasën përgatitore, është vetëm për Teknologjinë.



linjë e veçantë në lëndën “Edukim për shoqërinë”.

Kurrikula me zgjedhje zë 7% të orëve mësimore në planin mësimor. Ajo mbështet nevojat dhe interesat e nxënësve dhe komunitetit shkollor.

4.2 Menaxhimi dhe zbatimi i planit mësimor nga shkolla

Për zbatimin e planit mësimor, në përshtatje me kushtet dhe nevojat konkrete, që ka shkolla, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave duhet të kenë parasysh:

- Numrin total të orëve mësimore javore për secilën fushë, për një shkallë kurrikulare.
- Numrin e orëve mësimore javore për një klasë.
- Rezultatet e të nxënësve për fushë të nxënësve, për shkallë kurrikulare.
- Veçoritë psikologjike të nxënësve.
- Nevojat e tyre për realizimin e veprimtarive në përmbushje të qëllimeve që ka shkolla.

4.3 Autonomia e shkollës

Autonomia e shkollës përfshin delegimin e një pjese të lirisë apo të lirisë së veprimit autoriteteve shkollore për vendimmarrje mbi pjesë të caktuara të planit mësimor. Transferimi i kompetencave nga autoritetet qendrore shkollës është parakusht i zhvillimit të kurrikulës në bazë shkollë. Ai mund të përshpejtojë zhvillimin e kurrikulës në bazë shkollë por në vetvete nuk është kusht i mjaftueshëm, pasi duhet që shkolla të identifikojë nevojat dhe mundësitë e saj për zhvillimin e kurrikulës në bazë shkollë.

Partnerë të fuqishëm në zhvillimin e kurrikulës në bazë shkollë janë mësuesit, prindërit dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.

Zhvillimi i kurrikulës në bazë shkollë bëhet në përputhje me kërkesat e nxënësve, kushtet e shkollës, specifikat rajonale, kërkesat e aktualitetit dhe domosdoshmërisht nënkupton njohje të mirë të të gjithë dokumentacionit kurrikular.

Kurrikula në bazë shkollë mund të përfshijë:

- Përforcimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në fusha të caktuara të nxënësve.
- Veprimtari shtesë që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave si: projekte, shërbim komunitar, orientim për karrierë, veprimtari sportive, artistike, etj.
- Përzgjedhjen dhe përshtatjen e lëndëve me zgjedhje, moduleve etj.



KURRIKULA ME ZGJEDHJE

Organizimi i kurrikulës në kurrikul bërthamë dhe kurrikul me zgjedhje plotëson më mirë nevojat e shoqërisë dhe ato të individit dhe siguron shanse të barabarta për të gjithë.

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës së përgjithshme e cila, në dallim nga kurrikula bërthamë, zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar në planin mësimor në përputhje me interesat, potencialet, mundësitë, informacionet paraprake të nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.

5.1 Qëllimi

Kurrikula me zgjedhje ka si qëllim:

- Të zgjerojë dhe të thellojë lëndët e kurrikulës bërthamë.
- Të afrojë lëndë dhemodule të reja të cilat nuk trajtohen në kurrikulën bërthamë.
- Të trajtojë module me bazë temash që kanë lidhje me problematikat shoqërore, kulturore dhe natyrore.
- Të krijojë mundësi përzhvillimin e kurrikulës lokale.
- Të nxitë të mësuarin me projekte.

5.2 Përmbajtja

Kurrikulame zgjedhje përmban:

- lëndë të veçanta
- module
- projekte
- veprimtari të ndryshme nga kurrikula bërthamë dhe çështjet ndërkurrikulare

Si lëndë me zgjedhje në bërthamë, afrohet një pjesë e lëndëve me nivele të ndryshme programesh. Programet mësimore për këtë zgjedhje hartohen në nivel qendror (p.sh. gjuha e huaj e dytë).



Lëndë/module të tjera jo të bërthamës janë lëndë/module që lidhen me zhvillimet rajonale, prirjet dhe interesat e veçanta të nxënësve, modulet profesionale etj. Programet mësimore për këto lëndë/module përgatiten apo përshtaten nga shkolla.

Përnxënësit që kanë vështirësi në të nxënë në disa lëndë dhe që dëshirojnë të përmirësojnë arritjet e tyre në lëndë të veçanta, afrohet përforsimi.

Veprimtaritë shkollore janë angazhime komunitare, klube shkencore/arstistike/sportive, ekspozita, ekskursione etj. Nxënësi zgjedh të marrë pjesë në një numër të paracaktuar veprimtarish shkollore.

Kurrikulamezgjedhje në shkallët 1-2 mund të përdoret përveprimtarinë përmbushje të nevojave dhe interesave të nxënësve; për përforsim njohurish në lëndë të veçanta apo veprimtari të tjera shkollore në funksion të përmbushjes së kompetencave kyç.

Kurrikulamezgjedhjenë shkallët 3-4 mund të përdoret për gjuhën e huaj të dytë (gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë italiane, gjuhë angleze), në përmbushje të interesave të nxënësve për llojin e gjuhës, në varësi të mundësive që afron shkolla ose për veprimtari të tjera shkollore në funksion të përmbushjes së kompetencave kyç.

Dokumenti i kurrikulësme zgjedhje ka strukturëtënjëjtëme atë të kurrikulës bërthamë. Në të përfshihen:

- Rezultatet e të nxënit të kurrikulës me zgjedhje.
- Udhëzimet metodike për realizimin e saj.
- Ndarja e orëve për kurrikulën me zgjedhje.
- Materialet mësimore dhe burimet e mjetet ndihmëse.
- Vlerësimi i nxënësve.

5.3 Realizimi i kurrikulësme zgjedhje

Procedurat për hartimin e kurrikulës me zgjedhje, bazohen në udhëzuesit e hartuar nga MAS.

Përprocedurën e zgjedhjes së kurrikulës me zgjedhje, është i domosdoshëm respektimi i hapave të përcaktuara në udhëzimet administrative të kurrikulës me zgjedhje të hartuar nga



MAS-i.

Kurrikula me zgjedhje përbëhet nga lëndë, module dhe veprimtari krijuese.

Për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje kërkohet bashkëpunimi i mësuesve, nxënësve, koordinatorëve përkatës në drejtorinë e arsimit në nivel qendror, ndërsa zbatimi mbështetet nga specialistët e arsimit në nivel lokal.

Lënda me zgjedhje, prej momentit kur zgjidhet nga ana e nxënësve dhe aprovohet nga organet përkatëse, ka status të njëjtë me lëndët e kurrikulës bërthamë, d.m.th., **është e detyrueshme për të gjithë nxënësit që e për zgjedhin.**

Kurrikula me zgjedhje monitorohet, vlerësohet (me status të veçantë) dhe evidentohet me kritere dhe parime të njëjta me ato të kurrikulës bërthamë.



UDHËZIME METODOLOGJIKE

6.1 Hyrje

Metodologjitë mësimore zbatojnë parimet e mësimdhënies që janë përcaktuar në kornizën kurrikulare. Ato synojnë një mësimdhënie efektive që siguron kompetencat për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Përrarritjen e kompetencave tëkurrikulës bërthamë, çdofushë të nxënioselëndë mësimore ka veçantitë e saj për realizimin e rezultateve të të nxënësit. Pavarësisht nga specifikat e tyre, gjithë procesi i mësimdhënies në lëndë të ndryshme ka disa karakteristika të përbashkëta në rrafshin metodologjik. Ai përqendohet në aspektet e mëposhtme:

1. Lidhja e rezultateve të të nxënësit të kompetencave kyçe me rezultatet e të nxënësit për kompetencat e fushës.
2. Mësimdhënia dhe të nxënësit bazuar në kompetenca.
3. Mësimdhënia me në qendër nxënësin.
4. Mësimdhënia dhe të nxënësit e integruar.
5. Zhvillimi i temave ndërkurrikulare.
6. Zhvillimi i veprimtarive ndërkurrikulare.
7. Zhvillimi i veprimtarive ekstrakurrikulare.

6.2 Lidhja e rezultateve të të nxënësit të kompetencave kyçe me rezultatet e të nxënësit të kompetencave për fushë

Arritja e rezultateve të të nxënësit për kompetencat kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesit të lidhin rezultatet e të nxënësit të kompetencave kyçe, me rezultatet e të nxënësit për kompetencat e fushës për secilën shkallë.

Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënësit.

Me qëllim që të lidhë rezultatet e të nxënësit të kompetencave kyçe, me rezultatet e të nxënësit për kompetencat për fushë, për secilën shkallë, mësuesi:

- përzgjedhë rezultatet e të nxënësit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxënësit për kompetenca kyçe për vit mësimor rezultatet e të nxënësit



- nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e fushës së të nxënit që synon të arrijë nxënësi;
 - zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e fushës për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë për fushë të nxëni;
 - përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave për fushë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;
 - planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
 - kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për fushë të nxëni dhe shkallë.

6.3 Mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca

Jeta dhe puna në shoqërinë bashkëkohore, ndryshimet e shpejta dhe konkurrenca gjithnjë në rritje kërkojnë nga individi njohuri të reja, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime, pra kompetenca të reja që e vënë theksin te novatorizmi, shpirti krijues, komunikimi në mënyrë efektive, aftësia për të zgjidhur probleme dhe për të menduar në mënyrë kritike etj. Një sistem arsimor tradicional, i cili theksin e vë te njohuritë, e ka të pamundur zhvillimin e kompetencave, ndaj është e nevojshme një qasje e re në hartimin e kurrikulës dhe në procesin e mësimdhënies.

Mësimdhënia e bazuar në kompetenca kërkon që mësuesit të përzgjedhin strategji, metoda, teknika dhe forma të ndryshme pune, si dhe të organizojnë përvojat mësimore të nxënësve që integrojnë njohuritë përkatëse me shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet.

Mësimdhënia dhe të nxënit, bazuar në kompetenca janë të lidhura ngushtë edhe me procesin e vlerësimit. Për të vlerësuar kompetencat e nxënësve është e rëndësishme që secili mësues të përzgjedhë teknika dhe instrumente vlerësimi, të cilat u mundësojnë nxënësve demonstrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, e jo vetëm njohuritë faktike. Në këtë mënyrë mësuesit sigurojnë informacion për cilësinë e mësimdhënies, arritjet e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave.



6.4 Mësimdhënia dhe të nxëniet me në qendër nxënësin

Korniza Kurrikulare promovon mësimdhënien me në qendër nxënësin. Kjo nënkupton që:

- metodat e mësimdhënies duhen përshtatur me nevojat individuale, interesat dhe veçoritë e nxënësve, me qëllim që të sigurohet sukcesi i secilit prej tyre;
- duhet pranuar nga mësuesit që stilet e të nxëniet ndryshojnë nga një nxënës te tjetri;
- duhen përzgjedhur metoda, teknika dhe strategji të mësimdhënies që nxitin përfshirjen aktive të nxënësve në orën e mësimit;
- duhen përdorur burime të ndryshme të nxëniet që nxitin pjesëmarrjen, vëzhgimin, pavarësinë, kërkimin dhe kureshtjete nxënësve;
- duhet krijuar një mjedis i këndshëm e miqësor në klasë me qëllim që të nxitet interesi dhe motivimi i nxënësve për të nxënë;
- duhen njohur dhe trajtuar në mënyrën e duhur nxënësit e talentuar dhe ata që kanë vështirësi në të nxënë.

Qasja e re kurrikulare që përqendrohet në zhvillimin e kompetencave të nxënësit, kërkon ndryshime dhe në metodat dhe format e punës. Mësuesit dhe nxënësit duhet të jenë të lirë të përzgjedhin përmbajtjen, metodat, format dhe kushtet për të arritur rezultatet e të nxëniet. Disa nga këto metoda dhe forma mund të jenë: mësimdhënia e bazuar në projekte, përdorimi i TIK-ut dhe mediave të ndryshme, mësimdhënia e bazuar te kërkimi, integrimi ndërlëndor, punë në grup, punë në çift, nxënie individuale etj.

Realizimi i mësimdhënies me në qendër nxënësin kërkon bashkëpunim të përhershëm mes mësuesve për metodat dhe mjetet mësimore, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave pozitive mes tyre.

Po kështu, puna edukative cilësore e shkollave nënkupton bashkëpunim të rregullt dhe të vazhdueshëm me prindërit për të mundësuar një ndarje të qartë të përgjegjësisë për arritjen e rezultateve të të nxëniet dhe kompetencave kyçe të nxënësit.

6.5 Mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar

Të nxëniet e nxënësve varet shumë nga ajo që shkolla u mëson. Nëse u mësojmë nxënësve lidhjen dhe integrimin, ata do t'i shohin gjërat në këtë këndvështrim. Nëse u mësojmë ndarjen dhe mungesën e vazhdimësisë në kohë të gjërave, ata do të marrin njohuri, shkathtësi, qëndrime të fragmentuara (të shkëputura). Me qëllim që të integrohen këto aspekte, kurrikula bërthamë realizohet përmes lëndëve të integruara në fusha të nxëniet dhe përmes mësimdhënies së integruar.



Mësimdhënia e integruar lidh përmbajtjet e veçanta të lëndëve mësimore me qëllim arritjen e rezultateve të të nxënit të kompetencave për fushë me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për secilën shkallë.

Për t'i përmbushur kërkesat e Kornizës Kurrikulare dhe kurrikulës bërthamë, mësuesit duhet të kryejnë:

- lidhjen ndërmjet fushave të të nxënit, ku përmbajtjet e veçanta mësimore kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kyçe;
- lidhjen midis rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushave të të nxënit me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallë, me qëllim që zbatimi i njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të jetë i lidhur me situata konkrete nga jeta e përditshme;
- integrimin në mësimdhënie të karakteristikave të përbashkëta të lëndëve të fushës përkatëse (p.sh. fizikës dhe biologjisë) apo karakteristikave të përbashkëta të fushave të të nxënit (p.sh. fushës “Shoqëria dhe mjedisi” me fushën e “Shkencave të natyrës”);
- aktivitete me nxënës që zhvillojnë kompetencat për të gjetur dhe përpunuar informacione në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme si dhe duke përdorur TIK-un;
- aktivitete me nxënës që promovojnë perspektivën e edukimit global, të cilat i ndihmojnë nxënësit që të zhvillojnë kompetencat e tyre për t'u përballur me sfidat dhe mundësitë brenda zhvillimeve të shoqërisë dhe ekonomisë së sotme dhe të ardhshme.

6.6 Zhvillimi i temave ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Trajtimi i tyre synon përvetësimin e disa njohurive specifike, kultivimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara të nxënësit. Temat ndërkurrikulare integrojnë fushat kurrikulare të të nxënit, ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj. Temat ndërkurrikulare përcaktohen sipas politikave kombëtare afatmesme e afatgjata dhe konkretizohen e zërthehen në nivel vendor e në bazë shkolle. Temat ndërkurrikulare janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.



- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

6.7 Zhvillimi i veprimtarive ndërkurrikulare

Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Të gjitha fushat shërbejnë në zhvillimin e kompetencave kyçe, të cilat nga ana e tyre mundësojnë integrimin e përmbajtjeve të vetë fushave. Kështu, për zhvillimin e kompetencës së të menduarit, kontribuojnë të gjitha fushat e të nxënësit, si matematika, shkencat, shoqëria dhe mjedisi etj. Duke mësuar në mënyrë të integruar, nxënësit jo vetëm përvetësojnë kompetencat, por fitojnë një këndvështrim holistik të botës, dukurive dhe marrëdhënieve që i hasin në jetën e përditshme.

Veprimtaritë ndërkurrikulare integrojnë fushat e të nxënësit, ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Kurrikula bërthamë përfshin edhe hapësirën përtej kufijve lëndorë në mënyrë që nxënësit të ndërtojnë lidhje mes fushave të të nxënësit. Veprimtaritë ndërkurrikulare duhet të ofrojnë përvoja të përshtatshme dhe sfiduese që sjellin kënaqësi në kontekstin e përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të ndryshme të nxënësve.

Krijimi i lidhjeve ndërmjet fushave të të nxënësit krijon mundësi për progres në zhvillimin e shkathtësive të nxënësve, për njohjen dhe të kuptuarit e koncepteve të reja, rishikimin dhe përforcimin e këtyre koncepteve dhe shkathtësive nga perspektiva të ndryshme. Gjithashtu, kjo qasje ndihmon që kurrikula të jetë koherente dhe më kuptimplotë nga pikëpamja e nxënësit.

Integrimi i veprimtarive ndërkurrikulare në kurrikulën bërthamë mund të realizohet përmes:

- Gjetjes së lidhjeve midis lëndëve/temave apo njësive mësimore me qëllim realizimin/arritjen e ndonjë kompetence kyçe (p.sh.nëse tema mësimore është nga mbrojtja e mjedisit, atë e lidhim edhe me çështjet gjuhësore).
- Projekteve kurrikulare, të cilat lidhen duke ndihmuar njëra-tjetrën në tema apo fusha të ndryshme, (p.sh.projekte në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” me fokus edukimin për karrierë etj.), të cilat gjithashtu mundësojnë realizimin e kompetencave të veçanta.

Trajtimi i tyre synon përvetësimin e disa njohurive specifike, kultivimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara të nxënësit.



6.8 Zhvillimi i veprimtarive ekstrakurrikulare

Veprimtaritë ekstrakurrikulare janë veprimtari të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të fushave dhe lëndëve mësimore formale, por që ndihmojnë arritjen e kompetencave për shkallët e kurrikulës dhe ciklet e arsimit. Për secilën nga veprimtaritë e mundshme, shkolla duhet të përgatisë një plan dhe program të qëllimshëm, të orientuar e jo aktivitetet të rastit.

Mësimdhënia në fushat e ndryshme të të nxëniet do të mbështetet me anë të veprimtarive ekstrakurrikulare të organizuara, si:

- vizita në muze, parqe, vende historike, institucione, galeri, teatër etj.;
- veprimtari me raste festash të ndryshme;
- pjesëmarrje në grupet mësimore, në aktivitete të lira dhe në shoqata;
- diskutime me të ftuar (p.sh. me drejtues të bashkisë, prindër, përfaqësues të bizneseve lokale, politikanë, njerëz të medias etj.);
- punë me projekte që fokusohet në tema dhe çështje specifike të karakterit shumë dimensional që përkojnë me moshën e nxënësve;
- organizime ekspozitash (p.sh. artet e bukura, fotografia);
- shërbime komunitare (p.sh. ndihma për njerëzit në nevojë; mbrojtja e mjedisit; forcimi i lidhjeve midis brezave);
- lojëra sportive, aktivitete artistike, revista ose gazeta e shkollës etj.

Rekomandohet që të gjithë nxënësit të përfshihen në veprimtari ekstrakurrikulare. Sipas preferencave dhe talentit personal, ata mund të jenë pjesë e një grupi në aktivitete të ndryshme: ekipe sporti, grup muzikor, grup vallëzimi, kor, grup teatri etj.



UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

7 Vlerësimi

7.1 Kuptimi për vlerësimin. Parimet themelore

Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati arsimor, mbi bazën e një kriteri të caktuar.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është marrja e vendimeve, që synojnë përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe vetë procesin e tij. Marrja e vendimeve kërkon grumbullimin e vazhdueshëm të informacionit për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit. Praktikrat e vlerësimit kanë ndikim vendimtar në procesin e të nxënit.

Vlerësimi për të nxënit (VpN). Synimi kryesor i këtij vlerësimi është të mbikëqyrë përparimin e nxënësit gjatë procesit të të nxënit dhe të mbledhë informacion për të lehtësuar dhe për të ndihmuar marrjen e vendimeve për të përmirësuar këtë proces.

Vlerësimi i të nxënit (ViN). Synimi kryesor i këtij vlerësimi është të përcaktojë arritjet në përfundim të një detyre të caktuar, të kapitullit, të semestri etj., për të vendosur notat dhe për të certifikuar nxënësit për nxënie të mëtejshme. Ai përdoret edhe për të gjykuar efektivitetin e të nxënit ose të programit mësimor.

Vlerësimi bazohet në parime të caktuara, si:

Vlefshmëria

Vlerësimi duhet të sigurojë informacion të vlefshëm për proceset, për rezultatet dhe për vlerat që zhvillohen nga nxënësit gjatë procesit të arsimimit në nivele të ndryshme.

Transparenca

Nxënësit kanë të drejtë dhe nevojë të njihen me kriteret dhe metodat me të cilat do të vlerësohen. Kjo garanton paanshmërinë e vlerësimit dhe ndihmon të nxënit. Kriteret e qarta dhe të hapura ndihmojnë gjykimet profesionale, sigurojnë që vendimet të shqyrtohen nga të gjithë dhe të jenë të qëndrueshme.



Paanshmëria

Vlerësimi i paanshëm nënkupton vlerësimin e një rezultati të nxënësve, duke mos u ndikuar nga karakteristikat dhe rrethanat e çdo nxënësi, që përfshijnë: gjininë, etninë, gjuhën, racën, rrethanat ekonomike e shoqërore, vendndodhjen, si dhe personalitetin, talentin, aftësitë e kufizuara etj.

Vlerësimi tërësor

Gjykimet për përparimin e nxënësve duhet të bazohen në lloje dhe burime të ndryshme informacioni. Informacioni i marrë nga vlerësimi duhet të tregojë në mënyrë të besueshme, nëse nxënësi është në gjendje të realizojë atë çfarë përshkruhet në rezultatet e të nxënësve. Integrimi i llojeve dhe burimeve të ndryshme të të dhënave të mbledhura gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe në situata të ndryshme është kusht i domosdoshëm për të siguruar gjykimet të qëndrueshme dhe të paanshme për arritjet e nxënësve.

7.2 Llojet e vlerësimit

Gjatë vlerësimit gjykohet dhe merren vendime për përparimin e vazhdueshëm dhe për nivelin e arritjes së rezultateve të nxënësve, të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë dhe në planet e programet mësimore. Përmes vlerësimit merret informacion sa më i plotë dhe tërësor për shkallën e zotërimit dhe të demonstrimit të kompetencave nga nxënësit.

Llojet kryesore të vlerësimit arsimor janë:

- Vlerësimi i brendshëm.
- Vlerësimi i jashtëm.

7.2.1 Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm realizohet nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollës, në veprimtarinë e përditshme mësimore dhe edukative.

Ky vlerësim përdor mjete të ndryshme që mundësojnë nxjerrjen në pah të nivelit të zotërimit të kompetencave, konkretisht:

- gjerësinë dhe thellësinë e të nxënësve të përvetësuar;



- gatishmërinë për t'iu përgjigjur sfidave të nivelit dhe për të përparuar drejt të nxënësve edhe më sfidues;
- zbatimin e të nxënësve në situata dhe rrethana të reja.

Vlerësimi i nxënësve, përveç formave të ndryshme joformale gjatë gjithë procesit të të nxënësve, bëhet nëpërmjet shkallës së vlerësimit që përfshin notat nga 4- 10.

Nota 4: Një arritje që tregon performim të pamjaftueshëm të njohurive dhe kompetencave.

Nota 5: Një arritje që tregon performim minimal të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 6: Një arritje që tregon performim të mjaftueshëm të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 7: Një arritje që tregon performim të kënaqshëm të shumicës të njohurive të reja dhe të kompetencave.

Nota 8: Një arritje që tregon performim të mirë të njohurive dhe të kompetencave.

Nota 9: Një arritje që tregon performim shumë mirë të njohurive dhe të kompetencave.

Nota 10: Një arritje që tregon performim të shkëlqyer dhe origjinal të njohurive dhe të kompetencave.

Vlerësimi i arritjes së rezultateve të të nxënësve bëhet gjatë dhe në fund të çdo viti shkollor dhe dëshmon nivelin e arritjeve të tyre nga nxënësve. Në përfundimin e një shkalle të kurrikulës (klasa II, V, VII, IX, XI dhe XII) bëhet vlerësimi i nivelit të zotërimit dhe të demonstrimit të të kompetencave nga nxënësi, sipas përcaktimit të tyre në kurrikulën bërthamë.

7.2.2 Vlerësimi i jashtëm

Me vlerësim të jashtëm do të kuptohet vlerësimi i realizuar nga autoritetet qendrore, rajonale e vendore të arsimit (MAS, AKP, ISHA, DAR/ZA).

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet për qëllime:

- Inspektimi dhe verifikimi të cilësisë së vlerësimit në nivel klase, shkolle apo bashkie.
- Vlerësimi të standardizuar në nivel arsimorë



- Hulumtimi.
- Vendimmarrjeje në arsim në nivele, fusha, aspekte të ndryshme.

Vlerësimet e standardizuara shtetërore organizohen në përfundim të nivelit arsimor. Këto vlerësime janë të përqendruara në matjen e nivelit të demonstrimit të kompetencave kyçe të parashkuara për secilin nivel.

SHËNIM

Procedurat e vlerësimit dhe dokumentacioni përkatës rregullohen me udhëzime të veçanta të MAS.



FJALORTH I TERMINOLOGJISË KURRIKULARE

TERMAT	SHpjegimi
Aftësi	Kapacitet i lindur ose i fituar që e lejon personin të ndërtojë njohuri, për të vepruar me sukses në situata të caktuara.
Arsim	Veprimtari themelore e institucioneve arsimore që siguron krijimin dhe shndërrimin e njohurive; përsosjen e kompetencave gjatë gjithë jetës; zhvillimin vetjak; zhvillimin dhe shndërrimin e kulturës. Rezultat i nxënies së qëllimshme, të planifikuar dhe të organizuar në mënyrë formale dhe joformale.
Arsimformal	Arsim i qëllimshëm, i institucionalizuar, i planifikuar, i strukturuar në mënyrë hierarkike, që fillon me arsimin parashkollor dhe vazhdon deri në arsimin pasuniversitar. Rezultatet dhe kualifikimet e fituara në arsimin formal njihen nëpërmjet certifikatave dhe diplomave.
Arsim joformal	Arsim i qëllimshëm, i planifikuar, i institucionalizuar, alternativ dhe plotësues i arsimit formal, në kuadër të të nxënies gjatë gjithë jetës. Arsimi joformal mund zhvillohet brenda ose jashtë institucioneve arsimore dhe iu shërben personave të të gjithamohave. Për programet e arsimit joformal mund të jepet ose jo certifikatë, e cila nuk është ebarasvlershme me kualifikimet formale.
Arsim i detyrueshëm	(shih: <i>Arsim bazë</i>)
Arsim bazë	Tërësia e njohurive dhe kompetencave që duhet të zotërojë nxënësi deri në fund të klasës së nëntë. Kohëzgjatje e shkollimit që konsiderohet si e detyrueshme me ligj. Arsimi bazë në Shqipëri përfshin arsimin fillor dhe të mesëm të ulët (KSNA 1 dhe 2).
Arsim parashkollor	Nivel i arsimit me kodin 0 (KSNA 0).
Arsim fillor	Nivel i parë i arsimit me kohëzgjatje prej pesë vitesh (KSNA 1).
Arsim i mesëm	Nivel i dytë dhe i tretë i arsimit me kohëzgjatje prej shtatë vitesh (KSNA 2, 3).
Arsim i mesëm i ulët	Nivel i dytë i arsimit me kohëzgjatje prej katër vitesh (KSNA 2).
Arsim i mesëm i lartë	Nivel i arsimit me kohëzgjatje prej tri vitesh (KSNA 3).



Arsim profesional	Arsim që iu mundëson nxënësve zhvillimin e kompetencave për punë dhe kualifikime profesionale për profesione të caktuara.
Autonomi e shkollës	E drejtë e garantuar që i jepet shkollës për të vendosur për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës në bazë shkollë, për menaxhimin e burimeve njerëzore në dispozicion të saj dhe në disa raste, edhe për menaxhimin e burimeve financiare.
Burimi të nxënësve	Çdo burim i cilmbështet drejtpërdrejt ose tërthorazi, të nxënësve. Burimet janë të brendshme (njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera, qëndrime etj.) dhe të jashtme (dijet e kodifikuara në tekste, mjetet didaktike, mësuesit, shoqëria etj.).
Ciklet/nivelet /shkallët e kurrikulës	Një mënyrë e organizimit të kurrikulës në blloqe vitesh shkollë. Ciklet/nivelet/shkallët e kurrikulës përcaktojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe rezultatet e të nxënësve brenda çdo cikli, në përshatje me moshën e nxënësve. Ciklet/ nivelet/shkallët e kurrikulës, jo domosdoshmërisht përkojnë me nivelet arsimore formale.
Dija	E vërtetë e arsyetuar dhe e provuar sipas kritereve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet akademike e ato shkollë apo në vepra të specializuara si produkt i një ose disa dijetarëve apo praktikienëve. Dija është shoqërore.
Ekonomi dhe shoqëria e dijes	Ekonomi dhe shoqëria në të cilën dija bëhet burimi kryesor i zhvillimit dhe përparimit.
Fushë e të nxënësve	Një bashkësi lëndësh që kanë qëllime dhe detyra të përbashkëta për formimin e njohurive të reja dhe kompetencave.
Integrim kurrikular	Proces i ndërthurjes së përmbajtjeve mësimore dhe metodave, me qëllim që të sigurohet të nxënësve sistemik dhe tërësor.
Njohuri	Ndërtim mendor i realizuar nga personi gjatë bashkëveprimit me mjedisin ose nga vetëreflektimi për t'u bërë pjesë e trashëgimisë njohëse të tij. Njohuria është vetjake.
Kompetencë	Harmonizimi njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.
Kompetenca kyçe	Kompetenca për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje sociale dhe për punësim.
Kornizë kurrikulare	Kornizë kurrikulare është dokumenti themelor në të cilin përshkruhen orientimet dhe udhëzimet kryesore për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar (qëllimet e arsimit, kompetencat kyçe, rezultatet e të nxënësve sipas niveleve etj.).



Kurrikula	Sistemi i përbërë nga disa elemente me synime arsimore që, të lidhura mes tyre, lejojnë të orientohej dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula bazohet në realitete historike, shoqërore, gjuhësore, politike, fetare, gjeografike dhe kulturore të një vendi. Me anë të saj sigurohet arsimim cilësor dhe i barabar për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësiaetnike, seksi, pozita shoqërore dhe ndryshime të tjera.
Kurrikul bërthamë	Kurrikul e përbashkët për të gjithë nxënësit e një niveli në sistemin arsimor.
Kurrikul e përvetësuar	Tërësi e rezultateve të të nxëniet që zotëron nxënësi.
Kurrikul e zbatuar	Kurrikul e analizuar, interpretuar dhe zhvilluar në institucionet arsimore dhe e mbartur te nxënësi, sipas udhëzimeve themelore të kurrikulës.
Kurrikul formale/ e planifikuar	Kurrikul që përmban udhëzimet themelorekurrikulare, të përcaktuara në nivelin qendror të vendimmarrjes arsimore(kornizë kurrikulare, programe mësimore, tekste etj.). Kurrikula formale shërben si bazë për dhënien e dëftesave, diplomave dhe certifikatave të njohura me ligj.
Kurrikul në bazë shkolle	Kurrikul që përgatitet dhe zbatohet në nivel shkolle.
Kurrikul me zgjedhje	Pjesë e kurrikulës që përfaqëson lëndë dhe veprimtari kurrikulare që përmbushin nevojat dhe interesat e nxënësve,të vendosura në nivel shkollë.
Kurrikul me bazë kompetencat	Kurrikul që siguron zhvendosjen e fokusit të nxënies nga përmbajtjet lëndore (mësuesi në qendër)në atë që nxënësit kanë nevojë të dinë dhe të bëjnë me efikasitet në situata të ndryshme (nxënësi në qendër).
Koherencë e kurrikulës	Karakteristikë ekurrikulësqë tregonse në ç'masë synimete kurrikulës, përmbajtjet mësimore, strategjitë e të nxëniet dhe vlerësimit janë të integruara dhe përforcojnënjëra-tjetrën.
Konstruktivizëm	Teori e të nxëniet që bazohet në pariminsepersoni e ndërtonnjohurinë në mënyrë aktive duke ndërvepruar me mjedisin dhe shoqërinë.
Lëndë	Degë e dijes e organizuar në mënyrë të qëllimshme, si një disiplinë e veçantë e të nxëniet që mësohet në një ose disa nivele arsimore dhe krijon kushte për ndërtimin e njohurive të reja dhe kompetencave kyçe nga nxënësit.
Llogaridhënie dhepërgjegjshmëri	Proces në të cilin aktorët njohin, marrin përgjegjësi dhe japin llogari për vendimet, veprimet dhe pasojat e tyre. Llogaridhënia është e rëndësishme sidomos në kontekstin e decentralizimit të sistemit arsimor, i cili nxit autonominë shkollore, duke përfshirë edhe vendimet në lidhje me kurrikulën.



Metodologji e vlerësimit	Strategji dhe veprimtari të zbatuara për të matur arritjet e nxënësve.
Mësimdhënie	Proces i planifikimit, i organizimit dhe i udhëheqjes së situatave të të nxënësve (formale ose joformale) nga mësuesi.
Mësimdhënie dhe nxënie ndërvepruese	Filozofia dhe praktika e përfshirjes së nxënësve në procesin mësimor, duke i inkurajuar ata të sjellin përvojën dhe njohuritë e tyre në këtë proces (duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e tyre), me qëllim zhvillimin e kompetencave.
Mësimdhënie e diferencuar	Mësimdhënie që plotëson nevojat e nxënësve nëpërmjet përvojave të ndryshme të të nxënësve.
Mësimdhënie për njëri-tjetrin	Një praktikë në të cilën mësuesit dhe nxënësit ndajnë njohuritë e shkathtësitë e tyre dhe mbështesin të nxënësve e njëri-tjetrit.
Mjedis miqësor për fëmijët	Një mjedis arsimor i sigurt, gjithëpërfshirës, i shëndetshëm që bazohet në të drejtat e fëmijëve.
Mundësi për të nxënë	Situata dhe procese që sigurojnë kushtet dhe mjedisin për nxitjen e të mësuarit tek nxënësit .
Nivel arritjeje	Një deklaratë që përcakton masën në të cilën është arritur rezultati i të nxënësve ose niveli i njohurive dhe kompetencave kyçe.
Orientim për karrierë	Shërbime dhe veprimtari që mbështesin individët e çdo moshe dhe në çdo moment përgjatë jetës së tyre, për të bërë zgjedhje në lidhje me arsimin, trajnimin, profesionin dhe për të menaxhuar karrierën e tyre.
Përmbajtje mësimore	Tërësia e dijeve, informacionit, fakteve, situatave, veprimtarive etj., të grupuara në një lëndë ose fushë të nxënësve, që shërbejnë si bazë për formimin dhe zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave kyçe.
Përvojat e të nxënësve	Kushtet dhe situatat e të nxënësve që u ofrohen nxënësve për ndërtimin e njohurive të reja dhe kompetencave kyçe.
Politikë kurrikulare	Vendime, udhëzime dhe orientime formale, të marra nga qeveria apo autoritetet arsimore për hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës.
Program mësimor	Dokument që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënësve, metodologjitë e të nxënësve dhe vlerësimit për një lëndë të caktuar.
Qasje me në qendër fëmijën / Qasje e bazuar në kompetenca	Qasje që synon dhe krijon kushte që përmbajtja e nxënësve dhe veprimtaritë mësimore të shërbejnë formimit dhe zhvillimit të njohurive të reja dhe kompetencave kyçetë personit (grupit të personave), nëpërmjet ndërveprimit me situatat në kontekst.
Qëndrim	Përgatitje ose gatishmëri për të përballuar e për të trajtuar sfidat dhe detyrat në një mënyrë të caktuar. Qëndrimet ndikohen nga njohuritë dhe vlerat dhe janë zakonisht shkaktoare të sjelljeve (edhe pse lidhjet mes qëndrimeve dhe sjelljeve nuk janë drejtvizore).
	Termi ka kuptim të dyfishtë.



Rezultat i të nxënit	<p>Së pari, është deklarata që përshkruan atë se çfarë duhet të dinë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë si duhet nxënësit.</p> <p>Së dyti, u referohet njohurive të reja, kompetencave etj., që ndërton dhe përsospersoni/grupi, pasi përmbyll nivelin arsimor.</p> <p>Rezultati i të nxënit është koncept kyç për hartimin e mjeteve që mundësojnë transparencën, krahasimin, transferimin dhe njohjen e kualifikimeve në mes vendeve të ndryshme, në nivele të ndryshme.</p>
Stile të nxëni	<p>Një grup i sjelljeve dhe qëndrimeve që ndikojnë në mënyrën se si nxënësit mësojnë dhe bashkëveprojnë me mësuesit dhe shokët. Stilet e të mësuarit janë njohëse, emocionale dhe sjellje fiziologjike që shërbejnë si tregues se si nxënësit perceptojnë, ndërveprojnë dhe i përgjigjen mjedisit të të nxënit. Një individ mund të ketë disa stile të nxëni të cilat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në përputhje me detyrën.</p>
Standard	<p>Nivel i arritjes apo suksesit që pritet të arrihet prej nxënësve.</p>
Strukturë e kurrikulës	<p><i>Struktura e kurrikulës shprehet në Kornizën Kurrikulare.</i></p>
Shpërndarja e kohës mësimore	<p>Kohëte caktuara për nxënie, lëndë të veçanta, fusha të nxëni apo veprimtari të tjera plotësuese, gjatë një intervali të caktuar kohor (ore mësimi, javë shkollore, vit mësimor) sipas rregulloreve, kërkesave dhe rekomandimeve zyrtare.</p>
Shkathtësi	<p>Kapacitet (mendor/fizik) i fituar për të arritur rezultatet e parashikuara, shpesh me shpenzim minimal të kohës ose energjisë, ose të të dyjave. Shkathtësia mund të jetë e përgjithshme ose e veçantë.</p>
Tema ndërkurrikulare	<p>Tema madhore me të cilat përballet shoqëria dhe zhvillohen nëfushat e të nxënit. Të tilla janë: identiteti kombëtar, qytetaria aktive, çështje gjinore, siguria dhe shëndeti mendor e fizik, zhvillimi i qëndrueshëm etj.</p>
Të nxënit	<p>Proces i motivuar dhe i qëllimshëm me karakter vetjak ose shoqëror, i ndërtimit të njohurive të reja, kompetencave etj., nga personi nëpërmjet reflektimit vetjak, rindërtimit dhe ndërveprimit shoqëror. Zhvillohet në mjedise formale, joformale dhe informale.</p>
Të nxënite nxënësve nga njëri-tjetri	<p>Proces i të nxënit që bazohet në shkëmbimin e informacionit dhe përvojave ndërmjet nxënësve dhe që pasuron të nxënit.</p>
Tënxënit sistemik	<p>Një qasje që synon të aktivizojë të gjitha aspektet e vetjake të nxënësve (intelektin, emocionet, imagjinatën, trupin) për një të nxënë tërësor efektiv.</p>
Të nxënit ndërveprues	<p>Proces nëpërmjet të cilit nxënësit me nivele të ndryshme arrijteje punojnë së bashku në grupe të vogla, për një qëllim të përbashkët.</p>



Të nxënit nëpërmjet TIK-ut	Forma të të nxënit formal dhe joformal nëpërmjet përdorimit të TIK-ut, tërëndësishme për të nxënit gjatë gjithë jetës, si dhe për edukimin në distancë.
Të nxënit gjatë gjithë jetës	Të nxënit që realizohet gjatë gjithë jetës mbi bazë njohurive, kompetencave kyçedhe kualifikimeve, dhe që i zhvillon ato më tej për qëllime vetjake, profesionale dhe shoqërore.
Teknologjitë e informimit dhe komunikimit (TIK)	Një tërësi mjesh dhe burimesh teknologjike cilat përdoren për të transmetuar, mbledhur, krijuar dhe shkëmbyer informacion. Këto mjesh dhe burimet teknologjike përfshijnë kompjuterët, internetin apo pajisje të tjera digjitale.
Vlerë	Bindje që ruhet thellë lidhur me çfarë është e rëndësishmeose e dëshirueshme. Ajo shprehet nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave.
Veprimtari plotësuese kurrikulare	Veprimtari të strukturuarra mësimore, të qëllimshme që ndodhin jashtë kontekstit të lëndëve dhe fushave të nxënit. Këto veprimtari mund të përfshijnë projektet, sportet, punënvullnetare, fotografinë, dramën, muzikënetj.
Veprimtari përmirësuese	Veprimtari ose programe që synojnë të ndihmojnë nxënësit me vështirësi në të nxënë. Nëpërmjet tyre nxënësit tejkalojnë vështirësitë në të nxënë në mënyrë efektive.
Vetëvlerësim i të nxënit	Vlerësim nga i cili nxënësi mbledh informacion dhe reflekton rreth të nxënit e tij; gjykon për të në raport me objektivat dhe kriteret e vendosura; identifikon përparësitë e dobësitë dhe i përmirëson në përputhje me rrethanat. Është vlerësimi që bën nxënësi për progresin e tij bazuar në njohuritë e reja dhe kompetencat kyçe.
Vlerësim në arsim	Proces nëpërmjet të cilit matet ose gjykohet përparimi (progresi) dhe nivelet e arritjeve të nxënësve, në përputhje me kriteret specifikë të cilësisë.
Vlerësim diagnostikues	Vlerësim që identifikon nivelet e arritjeve të nxënësve, për të orientuar mësimin drejt plotësimit nevojave të tyre për nxënie.
Vlerësimi gjatë nxënies	Vlerësim i kryer gjatë gjithë procesit mësimor me qëllim nxitjen e procesit të të nxënit. Ky vlerësim formues eshë të nxënit si proces e jo vetëm si rezultat.
Vlerësim i jashtëm	Një proces dhe metodë vlerësimiqë e zhvillon dhe e përdor një agjenci apo organ vlerësues (jo shkolla). Ky proces zakonisht përfshin testimine standardizuar, dhe shpeshshërben për të klasifikuar kandidatët për mundësitë e mëtejshme arsimore dhe për qëllime certifikimi.
Vlerësim i të nxënit	Vlerësim i arritjeve të nxënësve për të siguruar informacion në lidhje me progresin e tyre (arritjet e tyre në fusha të ndryshme të kurrikulës / lëndëve mësimore dhe zotërimin e kompetencave kryesore). Ky proces shpesh përfshin përdorimin e testeve të standardizuara dhe përdoret për qëllime promovimiose diplomimi.



Vlerësim përmbledhës	Vlerësim që përmbledh përparimin dhe arritjet e nxënësit në fund të një viti mësimor apo të një cikli.
Vlerësim i nxënësve për njëri-tjetrin	Vlerësim i punës ose i detyrës së një nxënësi nga nxënës të tjerë.
Vlerësim i portofolit të nxënësit	Vlerësim i koleksionit të detyrave të nxënësit (detyra ose punë me shkrim, drafte, punë artistike, prezantime) të cilat pasqyrojnë njohuritë e reja dhe kompetencat e nxënësit.
Zbatim i kurrikulës formale	Procesi përdorimit të kurrikulës formale në shkollë që përfshin zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulës në shkollë, udhëheqjen e shkollës, trajnimin e mësuesve në shërbim, përgatitjen e teksteve të reja, materialeve dhe burimeve të të nxënësit, si dhe të udhëzuesve.
Zhvillim i kurrikulës	Cikli plotë i planifikimit, i hartimit, i zbatimit, i vlerësimit dhe rishikimit për të siguruar që kurrikula është e përshtatshme dhe e përditësuar.



REFERENCA

Rubrika të përgjithshme të dokumentit

MAS, “Korniza Kurrikulare e Shqipërisë”, Tiranë, 2014

MASHT (2012). *Kurrikula bërthamë klasën parafilllore dhe arsimin fillor (klasa parafilllore, I, II, III, IV, V)*. Prishtinë.

MASHT (2012). *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (klasa VI, VII, VIII, IX)*. Prishtinë.

Gjuhët dhe komunikimi

MASHT (2012). *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (klasa VI, VII, VIII, IX)*. Prishtinë.

MASH (2012). *Programet lëndore të arsimit bazë..*

MASH (2012). *Standardet e të nxënit të arsimit bazë.*

Këshilli i Europës. (2003). *Kuadri i përbashkët europian i referencave për gjuhët.*

Orstein, C. A., Hunkins P. F. (2003). *Kurrikula - bazat , parimet dhe problemet*. Instituti i Studimeve Pedagogjike. Tiranë.

National Curriculum Framework of Croatia. (2010), *For pre-school education and general compulsory and secondary education*. Kroaci

Québec Education Program. (2001). Kebek

Framework Education Programme for Basic Education. (2007). Çeki

Ministry of Education. (2006). *The Ontario Curriculum, Grades 1-8, Language*. Ontario

Ministry of Education, Singapore (2010). *English Language Syllabus*. Singapor

Matematika



MAS (2014). *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Shqipëri*
http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/index_en.php Eurydice, European Comision

Mathematics Education in Europe: Common Challenges and national policies- European Comision

EACEA: National System of Education. (të gjitha shtetet Europiane)

MASHT (2011). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës.*

MASHT (2012). *Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (klasa I –V dhe VI- IX).*

MASH (2012). *Programet lëndore të arsimit bazë.* www.izha.edu.al

MASH (2012). *Standardet e të nxënit të arsimit bazë.* www.izha.edu.al

National Core Curriculum for basic education (2004). Finlanda

Common core state standards for Mathematics in America

K -12 Learning Standards (2008) Washington State.

Orstein, C. A., Hunkins P. F. (2003). *Kurrikula - bazat , parimet dhe problemet.* Instituti i Studimeve Pedagogjike.

Québec Education Program. (2001). Kebek

Ministry of Education. (2006). *The Ontario Curriculum, Grades 1-8, Language.* Ontario

Ministry of Education, Singapore (2010). *Mathematics Syllabus.* Singapor

Shkencat e natyrës

MASHT, “Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët”, Prishtinë, 2012

MASH “Programet lëndore të arsimit bazë”. Tiranë, 2012

MASH “Standardet e të nxënit të arsimit bazë.”, Tiranë, 2012

Ministry of Education of Singapore “Science syllabus primary

2014”<http://www.moe.gov.sg/education/syllabuses/sciences/files/science-primary-2014.pdf>



Ministry of Education of Singapore “*Science syllabus Lower and Upper Secondary*”

<http://www.moe.gov.sg/education/syllabuses/sciences/files/science-lower-secondary-2013.pdf>

Quebec Education Program, Preschool Education, Elementary Education, Secondary Education

http://www1.mels.gouv.qc.ca/sections/programmeFormation/primaire/index_en.asp

Australian Curriculum, Science F-10 Curriculum

<http://www.australiancurriculum.edu.au/science/Rationale>

<http://www.acara.edu.au/default.asp>

Eurydice: *Developing key competences at schools in Europe, Challenges and Opportunities for Policy,*

2013 http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/documents/thematic_reports/145EN.pdf

Eurydice: *Science Education in Europe: National Policies, Practices and Research,* 2011

http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/thematic_reports_en.php#2013

OECD: *PISA Programme for international student*

assessment <http://www.oecd.org/education/>

Shoqëria dhe mjedisi

MASHT (2012). *Kurrikula bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor (klasa parafillore, I, II, III, IV, V).* Prishtinë.

MASH (2012). *Programet lëndore të arsimit bazë.*

MAS (2012). *Standardet e të nxëniet të arsimit bazë.*

Karta e Këshillit të Europës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut

Konceptet bazë dhe aftësitë-kyçe për edukimin me qytetari demokratike, Këshilli i Bashkëpunimit Kulturor (KBK/CDCC), Strasbourg 2000, DGIV/EDU/CIT (2000) 23

How all teachers can support citizenship and human rights education: a framework for the development of competences, Council of Europe Publishing, Council of Europe, March 2009

Artet



MASHT, *Korniza e Kurrikulës e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011;

MASHT, *Kurrikulabërthamë për arsimin e mesëm të ulët të Kosovës (klasat 6, 8 dhe 9)*, 2012

Road map for Arts Education, The World Conference on Arts Education, Building Creative Capacities for the 21 st Century Lisbon, 6-9 March, 2006;

Music, drama, visual art compulsory program, optional program, music and multimedia, Quebec

Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti

Bardhyl MISJA “*Drejtimet metodike të pasurimit të përvojës lëvizore të fëmijëve parashkollorë 5-6 vjeç*” (Dizertacion për kërkim grade shkencore “Doktor Shkencash”) ILKF “Vojo Kushi”, Tiranë 1988.

Edvin Dashi dhe Teuta Dashi “*Edukimi fizik në shkolla*”, Shtëpia Botuese “Ora”, Tiranë 2007.

Guido Subashi dhe Jani Daci “*Didaktika e Edukimit fizik*”, Shtëpia botuese e Librit Unversitar, Tiranë 2004

Instituti i Studimeve Pedagogjike “*Programe të lëndës së edukimit fizik për ciklin fillor*” Tiranë 2004.

MASHT, “*Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët të Kosovës*”, Prishtinë 2012.

Rae PICA “*Physical Education for Young Children*” (Human Kinetics 2008).

Teknologjia dhe TIK-u

ISTE: *International Society for Technology in Education* (U.S. & Canada), 2007, <http://www.iste.org>.

Ferrari, A.(2013). *DIGCOMP: A Framework for Developing and Understanding Digital Competence in Europe*. Luxembourg:Office of the European Union.

Janssen, J., & Stoyanov, S. (2012). Online Consultation on Experts’ *Views on Digital Competence*. Seville: JRC-IPTS. Marre, 2 shkurt 2014, nga: <http://ipts.jrc.ec.europa.eu/publications/pub.cfm?id=5339>.